Ana M. Llazarevska
Ivana Biliq
Jagoda Risteska
Irena Bojmalieva
Raul Kevriq
Daniella Stojanovska – Xhingovska
Jerko Markovina
Jasmina Risteska
Aneta Llambevska
Biljana Manevska

DORACAK PËR RAPORTIN E DREJTË NDAJ PERSONAVA ME INVALIDITET OSE KUFIZIME TË AFTËSIVE NË ARSIMIN SIPËROR

Redaktorë:

Ana M. Llazarevska
Risto Petrov
Vlladimir Trajkovski

Shkup, 2012

Ana M. Llazarevska **Daniella Stojanovska – Xhingovska**
Ivana Biliq **Jerko Markovina**
Jagoda Risteska **Jasmina Risteska**
Irena Bojmalieva **Aneta Llambevska**
Raul Kevriq **Biljana Manevska**

DORACAK PËR RAPORTIN E DREJTË NDAJ PERSONAVA ME INVALIDITET OSE KUFIZIME TË AFTËSIVE NË ARSIMIN SIPËROR

Redaktorë:

Ana M. Llazarevska
Risto Petrov
Vlladimir Trajkovski

Shkup, 2012

Përkthimi nga gjuha angleze në gjuhën maqedonase dhe anasjelltas
Biljana Manevska
Ana M. Llazarevska

Përkthimi në shqip
Gramoz Shabani

Kontrollimi i tekstit (lektura)
Biljana Manevska (versioni në gjuhën maqedonase dhe angleze)
Rozita Petrinska - Llabudoviq (versioni në gjuhën angleze)
Verka Llazarevska (versioni në gjuhën maqedonase)

Dizajni i ballinës:
Aleksandar Arsov

Përpunimi teknik:
Ana M. Llazarevska
Aleksandar Arsov

CIP - Каталогизација во публикација
Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

378-056.26/.3(497.7)
378-056.26/.3(497.5)

DORACAK për raportin e drejtë ndaj personave me invaliditet ose kufizime të aftësive në arsimin sipror / Ana Lazarevska ... [и др.]. - Текст. - Shkup : Makedonsko amerikanska alumni asocijacija, 2012

Начин на пристап (URL): http://www.equalaccess4pwds.org. - Наслов превземен од екранот. - Фусноти кон текстот

ISBN 978-608-4700-05-0
1. Lazarevska, Ana M. [автор] [уредник]
а) Лица со посебни потреби - Високо образование - Македонија - Собири б) Лица со посебни потреби - Високо образование - Хрватска - Собири
COBISS.MK-ID 92696330

Ky publikim u përkushtohet të gjithë atyre plot me pasion dhe entuziazëm, të cilët i janë përkushtuar vetes në realizimin e kauzave fisnike dhe me vlerë, të gjithë atyre "kryengritësve të heshtur" të cilët nuk frikësohen të ballafaqohen me sfidat dhe të përballen me frikët dhe dyshimet e tyre, në bazën e përditshme, të cilët gjithnjë janë të gatshëm për arritje të reja dhe të cilët synojnë drejt madhështisë! Publikimi u përkushtohet mentorëve tanë dhe këshilltarëve akademik të cilët na frymëzojnë, të cilët mes nesh e kultivojnë mrekullinë dhe të cilët na japin kurajë t'i ndjekim ambiciet tona dhe të kontribuojmë me sukses, jo vetëm në mjedisin dhe punën akademike, por edhe në çdo pikëpamje të jetës. Më në fund, u përkushtohet prindërve tanë të cilët i edukuan personalitetet tona dhe na mësuan të jemi qytetarë të mirë të Botës – personalitete me vështrime të hapura, të gatshëm për ndihmë dhe zemra mjaft të gjera që ta pranojmë çdo krijesë njerëzore! Të gjithë ju na tregoni se si vetëm një jetë njeriu mund të prek në shumë të tjera. Këtë e bëtë me aktin e thjeshtë të besimit tek ne gjatë çdo hapi në rrugën tonë. Pa durimin Tuaj, orientimin, inkurajimin e përhershëm dhe kritikën konstruktive, nuk do ta përmbushnim, bile edhe me heshtje, "Premtimin" tonë personal!

Premtimi (Kënga e delfinëve)
(Promise (Dolphin Song)[1][2]

nga: Olivia Njutën – Xhon (Olivia Newton – John) -

Shiko si luajnë në dritën e hënës
Vëzhgoi derisa luajnë nën Diellin
Ata janë fëmijë të lirisë – të gjithë prej tyre
Ashtu si kujdesen mes veti
Pa pyetje dhe arsyetim
Meritojnë të ruhen si burim i dashurisë

Në vetëdijen e tyre ekzistojnë përgjigje
të cilët me kohë edhe ne do ti njohim
Çfarë është e vërteta për atë që ne nuk e kemi të njohur
te ata nuk ka vend për urrejtje
Edhe pse ata kanë përjetuar shumë dhimbje
Nga raca e quajtur Njerëzore – por e cila trembet të dashurojë

Dhe ku me këngën time delfinit
Do të kisha mundur t'i ndihmoj të ndreqet e gabuara
Do ta kisha plotësuar atë që e kam hartuar para vetes
Dhe kur do të kisha mundur të arrij që të paktën një njeri të jetë i vetëdijshëm
Të paktën një njeri të kujdeset
Atëherë e kam arritur atë që Juve ua kam premtuar!

Të shpresojmë se nuk është vonë
Dhe do të mund ta shërojmë
Të gjithë dhimbjen që ia kemi shkaktuar ndonjë miku
Si të lindur me lirinë tonë
Si të lindur me të vërtetën tonë
Pse atëherë e keqpërdorim
Kur vetë do të mund të zgjedhim – dashuri dhe të dashurojmë.

[1] http://www.youtube.com/watch?v=fEtwsTfBzLc. Teksti i këngës është përkthim i lirë nga Ana M. Llazarevska.
[2] Teksti në origjinal në gjuhën angleze mund të merret nga http://www.metrolyrics.com/promise-dolphin-song-lyrics-olivia-newtonjohn.html.

PARATHËNIE E KRYEREDAKTORIT

E kujtoj atë pasdite të vonë në shkurt të vitit 2011 kur dr. Aida Koçi dhe unë ishim ulur në një lokal që të bisedonim për pikat kryesore të paraqitjes sonë potenciale për projektin, i cili duhej të financohet nga Fondi për angazhimin inovativ të alumnive (Alumni Engagement Innovation Fund) të programeve të ndryshme për shkëmbim, të financuara nga US Department of State. Kjo ishte hera e parë që shpallej thirrje për paraqitje të projekteve të këtij lloji dhe ne aspak nuk e dinim se me kë të konsultohemi që të fitojmë njohuri rreth procesit të aplikimit. Edhe më shumë, unë dhe nuk kisha ndonjë përvojë të madhe me paraqitje të projekteve – ky ishte aplikimi im i dytë që vijoi pas projektit të përfunduar me sukses, me të cilin u organizua Konferencë rajonale të alumnive nga Programi për zhvillim të kuadrit të ri mësimor (Junior Faculty Development Program – JFDP) me titull "Avancimi i qasjes të arsimit sipëror për personat me nevoja të veçanta", që u mbajt nga 22 deri 24 nëntor të vitit 2010 në Shkup dhe Ohër, ndërsa u financua me grant nga JFDP.

Të jem e sinqertë, në momentin e parë aplikacioni na u duk si kafshatë e madhe. Nga njëra anë, shumë mirë e dinim çfarë rëndësie ka tema me të cilën dëshironim të aplikojmë (inicimi i aplikimit të metodologjisë të mësuarit shërbyes në institucionet e arsimit sipëror në Maqedoni dhe Kroaci), nga njëra anë, duhej të mbajmë llogari edhe për rëndësinë e madhe të bashkësive, për nevojat e të cilave dëshironim të ndihmojmë me propozimin tonë – projekti (personat me handikap, për të drejtat e të cilëve me qasje të barabartë ndaj arsimit dhe sferat tjera të jetës akoma bëhet betejë e hapur në shoqëritë tona). Megjithatë, unë besoj se pikërisht ky bashkim ishte me rëndësi të madhe kur e përpilonim versionin final të propozim-projektit tonë me titull "Sigurimi i qasjes së barabartë përmes të mësuarit shërbyes për personat me nevoja të veçanta"[†]. Nga ne, propozuesit e projektit, të cilët punojmë në institucionet sipërore arsimore dhe të cilat në të njëjtën kohë e kemi nderin të jemi alumni të njërës nga programet e financuara nga State Departament, pritej t'i identifikojmë dhe t'i përkufizojmë qartë problemet/çështjet sociale për të cilat është e domosdoshme që menjëherë dhe me shumë punë dhe entuziazëm t'u qaset, që të mund të paktën bashkëqytetarëve tanë – personave me handikap – t'u lehtësohet, nëse jo tërësisht t'u mundësohet jetë modeste, ku ata do të kenë mundësi të barabarta, si edhe qytetarët tjerë. Ajo që e bën projektin tonë të veçantë, është fakti se nuk i përmbledhin angazhimet dhe përpjekjet tona më shumë se sa *sigurimi i qasjes së barabartë dhe të drejtave të barabarta për personat me handikap,* por në mënyrë paralele dhe de facto, kjo është edhe lufta për të drejtat tona dhe për vetë ne, pasiqë të gjithë ne në një periudhë të caktuar nga jeta jonë kemi qenë, jemi ose do të jemi persona me ndonjë lloj të nevojave individuale me të cilat personat me handikap ballafaqohen çdo ditë.

Energjia dhe nxitja për të shkruar në propozim-projektin i merrja nga përvojat, të cilat i fitova gjatë vizitave të mëparshme të mia të studimit në SHBA, Japoni, Gjermani dhe në disa vende të tjera evropiane. Derisa punoja dhe përkohësisht qëndroja në këto vende, fillova të vetëdijesohem dhe t'i perceptoj personat me handikap të ndryshëm – në rrugë, në institucionet arsimore, në teatër, operë, në kinema, në vetëshërbim, tregje, në ngjarje sportive – dhe fillova të shoh se si ata kënaqen në gëzimet e përditshme që i sjell jeta. Do të isha më e lumtur nëse edhe në vendin tonë do të kishte kushte të tilla për bashkëqytetarët tanë – personat me ndonjë invaliditet. Prandaj mendoj se ky projekt është vetëm një gur – themelet e rrugës drejt mençurisë dhe magjisë, që do të na ndihmoje të arrijmë deri te pjesët më të thella dhe më të sinqerta të zemrave dhe mendjes sonë dhe në këtë mënyrë t'i pranojmë personat me nevoja të veçanta.

Sa i përket këtij publikimi, ky është **vetëm një nga rezultatet** e projektit AEIF, me të cilin të gjithë ne u përpoqëm të kontribuojmë ndaj fillimit dhe sigurimit të qasjes së barabartë për grupe të caktuara të qytetarëve/shfrytëzuesve/konsumuesve, të cilët në këtë rast në të vërtetë janë personat me nevoja të veçanta. Në bazë informatës së kthyeshme që e morëm gjatë fazës së planifikimit për këtë projekt, por

[†] http://www.equalaccess4pwds.org

edhe më shumë, gjatë punëtorive nga Projekti të cilat u realizuan gjatë shkurtit të vitit 2012, dhe të cilat kishin për qëllim të sigurojnë informata më të hollësishme rreth nevojave të personave me invaliditet/handikap/pengesa, përfunduam se ekziston numër i madh i studentëve dhe kuadrit mësimor, që pothuaj asnjëherë nuk kanë pasur mundësi të komunikojnë me person me ndonjë handikap. Parimisht, ata nuk kanë bile edhe informata më themelore për disa tipa të handikapit/pengesës, e as nuk i dinë karakteristikat e tyre themelore. Prandaj, **qëllimi kryesor i këtij Doracaku,** është që studentëve dhe kuadrit mësimor (në mënyrë primare, por jo edhe në mënyrë ekskluzive vetëm për këto grupe) në institucionet e arsimit të lartë, t'i sigurojë informatë më të afërt për atë se çfarë paraqet mënyra e drejt, mjetet, raporti dhe sjellja ndaj personave me pengesa/handikap/invaliditet. Aq më shumë, qëllimi i këtij Doracaku është që te kuadri mësimor të iniciojë jo vetëm zgjerimin e imagjinatës në gjetjen e mënyrave dhe metodave të reja të ligjërimit dhe të mësuarit, por në kuadër të kampusit, t'i nxisë t'i shfrytëzojnë aktivitetet jashtë procesit mësimor si mjet për inkorporimin e personave me handikap/invaliditet/pengesa. Nga ana tjetër, në shtigje më të gjata, qasja e këtillë paraqet mjet për mundësimin e inkluzionit horizontal të personave me handikap/invaliditet/pengesa në të gjitha sferat e jetës shoqërore. Kjo qasje është mënyra e vetme si ne mund të kontribuojmë drejt forcimit të vetëdijes se të gjithë ne duhet t'i bashkojmë forcat tona në luftën për nevoja të barabarta dhe jetë më thelbësore, ndërsa elanin tonë ta përcjellim dhe ta zgjerojmë në garantimin, sigurimin, promovimin dhe luftën për të drejta të barabarta, në përgjithësi të gjitha personave me handikap/individualitet/pengesa.

Në rend të parë, do të kisha dashur, në emër të gjithë ekipit të projektit ta shpreh falënderimin deri te **Zyra e alumnive të State Departamentit, Këshillit drejtues të AEIF,** si dhe të **Bordit pranë AEIF të cilët i kanë vlerësuar propozim-projektet,** për vendimin e tyre që të seleksionohet propozim-projekti ynë. Në konkurrencën e 683 projekteve prej të cilave 137 ishin zgjedhur si finalistë, projekti ynë ishte në vendin e tretë pas votimit transparent në nivel global dhe në fund ishte mes 38 projekteve të cilët fituan mbështetje financiare. Besoj se suksesi ynë nuk do të ishte i mundur nëse nuk e kishim mbështetjen e vazhdueshme të ekipit që punoi në **Zyrën për marrëdhënie me opinion pranë Ambasadës së SHBA-ve në Republikën e Maqedonisë.** Falënderim të veçantë dëshiroj t'i shpreh z. **John Surface,** ish Atasheu për kulturë dhe arsimit pranë Ambasadës së SHBA-ve në Republikën e Maqedonisë, që e njohu rëndësinë e idesë sonë, besoi tek ne dhe me ekipin e vet na ofroi mbështetje morale dhe në logjistikë gjatë procesit të aplikimit. Ai e "shtroi rrugën" për punën e sjellshme të z. **Brian P. Bauer**, i cili pastaj u caktua për kryes të detyrës së njëjtë dhe të cilit i kemi borxh shumë për gjithë mbështetjen morale dhe në logjistikë gjatë implementimit të projektit.

E shfrytëzoj këtë rast t'i falënderohem gjithë ekipit të ko-autorëve, për përgjigjen e tyre momentale dhe gatishmërinë që ta pranojnë këtë sfidë – duke u kapur për detyrën që të përpilohet ky doracak i shumë qëllimshëm dhe me shumë aspekte. Kontributi i tyre – secili në fushën e vet të punës dhe ekspertiza ose përvoja – i jep peshë shumë të rëndësishme drejt arritjes së qëllimit kryesor.

Pa dyshim, barrën më të madhe e mori **znj. Daniella Stojanovska – Xhingovska** nga Shoqata e studentëve dhe të rinjve me handikap – Shkup (ZSMH). Nga pikëpamja profesionale, si defektolog, duke i përdorur resurset e saja shumëvjeçare, Daniella na ndihmoi në të gjitha mënyrat e mundshme t'i plotësojmë përmbajtjet, të cilat gjatë të shkruarit mungonin dhe para të cilëve ishim të gatshëm t'i plotësojmë. Por ajo që është më e rëndësishme, me faktin se Daniella edhe vetë është person me handikap të caktuar, kjo ndihmë shtrihet edhe më larg. Përvoja e saj personale, energjia e saj e pakufishme, si dhe ndarja e përvojave të miqve të saj, ata që i njeh, kolegëve dhe bashkëpunëtorëve, të cilët gjithashtu janë persona me tip të caktuar të handikapit, na siguruan vështrim të ri ndaj punëve dhe sugjerime të cilat kanë aplikim praktik shumë të gjerë dhe peshë. Përvoja e saj më shumë se dhjetë vjet në sferën e institucionalizimit të çështjeve për raport të drejt dhe inkluzion të personave me handikap/pengesa/invaliditet, paraqet pasuri të vërtetë për këtë Doracak. Por edhe kjo nuk ishte e mjaftueshme, e kështu ajo u kap me detyrën që ta koordinojë punën edhe të tre zonjave shumë të mrekullueshme **znj. Irena Bojmaliev, znj. Aneta Llambevska, znj. Biljana Manevska,** të cilat edhe krahas tipave të ndryshëm të handikapit/invaliditetit kanë arritur suksese të dukshme, të cilat janë mbi disa personalitete të cilët janë "kushtimisht" pa handikap. Duhet të theksoj se, Biljana na ndihmoi edhe përmes detyrës së komplikuar edhe me përkthimin e këtij Doracaku në gjuhën maqedonase, por çfarë

është më me rëndësi, u ballafaqua me shumë sukses në rregullimin e teksteve tona si edhe të tekstit në gjuhën maqedonase-angleze dhe kroate-angleze, duke e bërë Doracakun të lexohet më lehtë.

Falënderimi im i madh shkon edhe drejt ko-liderit tim nga Kroacia **dr. Ivana Biliq,** nga Universiteti i Splitit, si dhe deri te doc. **dr. Jerko Markovina** nga Universiteti në Zagreb, kontributi i tij ndaj këtij Doracaku është me shumë vlerë.

Edhe dy zonja jashtëzakonisht magjike ishin të obliguara që të sigurojnë informata të hollësishme për angazhimin e aktiviteteve jashtë-shkollore dhe më gjerë. Ju falënderoj nga zemra **znj. Jagoda Risteska** dhe **znj. Jasmina Risteska** nga "Mobiliteti sfidë!" për atë që gjithnjë ishin: të sakta, frymëzuese, të zhdërvjellëta, plot me resurse dhe me numër të madh të ideve dhe energji pa kufi! Të gjitha këto veçori të tyre, si dhe përvoja e tyre ndërkombëtare, në mënyrë jo egoiste i ndanë me të gjithë ne.

Mes anëtarëve të ekipit tonë mbisundon pajtueshmëri e njëzëshme se ky publikim nuk do të ishte me cilësi të tillë, nëse nuk ishte angazhimi i ko-redaktorëve **prof. dr. Risto Petrov** dhe **prof. dr. Vlladimir Trajkovski** nga Univerziteti "Shën Qirili dhe Metodi", Shkup, Fakulteti Filozofik, Instituti për defektologji. Atyre të dyve i falënderohem për gatishmërinë e tyre t'i përgjigjej thirrjes sonë për bashkëpunim, e me atë ta bëjnë këtë tekst më të vlefshëm.

Dhe më në fund, por jo më pak e rëndësishme, do të kisha dashur ta shpreh falënderimin tim **gjithë ekipit të angazhuar në këtë projekt, i cili përbëhet nga individë plot me entuziazëm dhe gatishmëri ta ndjekin tempin e punës të cilin e diktonte renditja e aktiviteteve të parapara në projektin tonë.** Bashkë me të gjithë personat me handikap të cilët u bënë pjesë e jetëve tona dhe i prekën zemrat tona, ata janë "skeleti" i këtij dhe ndonjë projekti tjetër në këtë fushë dhe e paraqesin thelbin moral, prej të cilit i shtjerrim idetë dhe energjinë tonë. Duhet të theksoj se, personalisht isha e uruar me një ekip të këtillë të bashkëpunëtorëve. Më mbetet vetëm të shpresoj se me punën tonë të gjithë bashkë e arsyetuam dhe e plotësuam gjithë atë që e planifikuam dhe që pritej nga ne.

Shkup,
gusht 2012

Kryeredaktor dhe Udhëheqës i Projektit AEIF

doc. dr. Ana Llazarevska

Fakulteti i Makinerisë – Shkup,
Universiteti "Shën Qirili dhe Metodi",
Shkup, R. Maqedonisë

Pasqyrë e shkurtesave të përdorura

AEIF	Fondi për angazhim inovativ të alumnive, i administruar nga State Departamenti (U. S. Department of State Alumni Engagement Innovation Fund)
PNV	Persona me nevoja të veçanta
JFDP	Programi për zhvillimin e kuadrit të ri mësimor (Junior Faculty Development Program)
OJQ	Organizatë joqeveritare
SL	Të mësuarit shërbyes
ADHD	Çrregullim hiperaktiv me deficit të vëmendjes (Attention Deficit Hyperactivity Disorder)

Pasqyrë e termeve të përdorura gjatë përkthimit nga gjuha angleze në gjuhën shqipe

Anglisht	**Shqip**
Mobility and Physical Impairments	invaliditet trupor dhe pengesa në lëvizje
Spinal Cord Disability	sëmundje të boshtit kurrizor
Head Injuries – Brain Disability	invaliditet për shkak të lëndimeve të kokës –trurit
Vision Disability	të parët e dëmtuar
Hearing Disability	të dëgjuarit e dëmtuar
Cognitive or Learning Disabilities	pengesa kognitive ose pengesa gjatë të mësuarit
Psychological Disorders	çrregullime psikike

PËRMBAJTJA

PARATHËNIE E KRYEREDAKTORIT iii

Pasqyrë e shkurtesave të përdorura vi

Pasqyrë e termeve të përdorura gjatë përkthimit nga gjuha angleze në gjuhën shqipe vi

PËRMBAJTJA vii

Kapitulli 1: Hyrje;
Autor: Ana M. Llazarevska 1

Ky Publikim përkundër Projektit tonë 1

Përmbajtja e këtij Doracaku 3

Terminologjia e pranuar në këtë Doracak 5

Kapitulli 2: Klasifikimi i llojeve të invaliditetit dhe karakteristikat e tyre themelore,
Autorë: Ivana Biliq, Daniella Stojanovska – Xhingovska 7

Termi dhe karakteristikat e personave me të parët e dëmtuar 9

1) Klasifikimi dhe definicioni i termit "të parët e dëmtuar" *9*

2) Karakteristikat kryesore të personave me të parët e dëmtuar *10*

Termi dhe karakteristikat kryesore të personave me të dëgjuarit e dëmtuar 11

1) Personat gjysmë të shurdhër *11*

2) Personat e shurdhër *12*

3) Personat me dëmtime të kombinuara, te të cilët dëmtimi i dëgjimit është primar *12*

4) Karakteristikat e personave me të dëgjuarit e dëmtuar *12*

Termi dhe karakteristikat kryesore të personave me pengesa në zërin, të folurit dhe gjuhë .. 13

Termi dhe karakteristikat kryesore të personave me invaliditet trupor dhe sëmundje kronike/sindrome 13

Termi dhe karakteristikat e personave me pengesa në zhvillimin intelektual (mental) 14

Termi dhe karakteristikat kryesore të personave me disleksi, disgrafi dhe diskalkuli 15

Termi dhe karakteristikat kryesore të personave/studentëve me autizëm 16

1) Sindromi Asperger *18*

2) Spektri autisit *18*

3) Çrregullimi hiper aktiv me deficit të kujdesit (Attention deficit hyperactivity disorder – ADHD) *18*

Termi dhe karakteristikat e personave me pengesa të kombinuara në zhvillim 19

Kapitulli 3: Cila është qasja e drejtë? Bontoni ndaj personave me invaliditet: Etika në arsimin e studentëve me invaliditet, Autorë: Daniella Stojanovska – Xhingovska, Ivana Biliq 20

Kontakti i parë me person/student me të dëgjuarit e dëmtuar 22

Kontakti i parë me person/student me të parët e dëmtuar 24

Kontakti i parë me person/student me invaliditet trupor 26

Kontakti i parë me persona/studentë me pengesa në zhvillimin intelektual (mental) dhe personat me autizëm 29

Kontakti i parë me persona/studentë me çrregullim hiper kinetik me deficit të vëmendjes (Attention deficit hyperactivity disorder – ADHD) 30

Kontakti i parë me persona/studentë me pengesa në të folurit 31

Kontakti i parë me studentë/personat të cilët kanë probleme emocionale dhe persona me vështirësi në të mësuarit 31

1) Kontakti me studentë me probleme emocionale 32

2) Kontakti me persona/studentë me vështirësi gjatë të mësuarit 32

Kapitulli 4 Nga pikë vështrimi i ekspertëve Autorë: Daniella Stojanovska – Xhingovska, Jerko Markovina 35

Nga perspektiva e defektologut 35

1) Përshkrimi i punës dhe detyrave të defektologut 35

2) Kompetencat specifike të defektologut 36

Nga perspektiva e psikologut: nevojat psikologjike të studentëve 37

1) Parimet psikologjike dhe puna e psikologut 37

2) Përshkrimi i punës dhe detyrave të psikologut 37

3) Kompetencat specifike të psikologut 38

Nga perspektiva e punëtorit social: Puna dhe kompetencat e punëtorit social 38

Roli i psikologut, punëtorit social dhe defektologut në përcaktimin e orientimit profesional të nxënësve/studentëve 39

Si ta dimë nëse ndonjë person/student ka nevojë për ndihmë profesionale dhe/ose ka tip të caktuar të vështirësive gjatë mësimit 41

1) Pyetësor si ta njohim disleksinë 41

2) Indikacionet specifike, d.m.th vështirësitë lidhur me leximin 42

3) Indikacione specifike, d.m.th. vështirësi lidhur me të shkruarit 42

4) Simptoma të disleksisë te të rriturit: Simptomat e përgjithshme 42

5) Simptoma lidhur me vështirësitë gjatë të mësuarit dhe edukimit 43

Kapitulli 5 Përvojat personale të personave/studentëve me invaliditet Autorë: Irena Bojmalieva, Aneta Llambevska, Biljana Manevska, Raull Kevriq,, Koordinuar nga: Daniella Stojanovska – Xhngovska dhe Ivana Biliq 45

Përvoja personale, perspektiva dhe sugjerimet e personit/studentit me të parët e dëmtuar .. 45

1) Qasja në fakultet 45

2) Arritja në fakultet dhe prapa 47

3) Vendosja dhe qasja në konvikt *47*

Përvoja personale, perspektiva dhe sugjerimet e personit/studentit me të dëgjuarit e dëmtuar **47**

Përvoja personale, perspektiva dhe sugjerimet e personit/studenti me invaliditet trupor **49**

Përvoja persona dhe sugjerimet e personit/studentit me pengesa të kombinuara:: "Tung, si jeni?" **53**

Kapitulli 6: Shërbimi administrativ për studentët me handikap:
Qasja deri te informatat dhe shërbimet,
Autore: Daniella Stojanovska - Xhingovska **55**

Serviset për mbështetje (support services): **55**

Shembuj pozitiv të trajtimit të drejt të studentëve përmes sigurimit të Shërbimit administrativ për studentët me handikap **57**

1) Shembuj nga jashtë vendit *57*

2) Shembuj në kuadër të R. Maqedonisë *58*

a) Servisi informativ-shërbyes për studentët me handikap në Shkup si shembull i praktikës së mirë 58
b) Servisi – asistenca personale për studentët dhe të rinjtë me invaliditet 60

Kapitulli 7: Mundësi plotësuese për studentët/personat me invaliditet/pengesa:
Aktivitete jashtë shkollore,
Autorë: Jagoda Risteska, Jasmina Risteska, Ana M. Llazarevska **63**

Studimi jashtë vendit **64**

Programi për të mësuarit e përjetshëm **65**

Mundësi për mbështetje me bursa të personave me invaliditet/pengesa/handikap **66**

Mundësi për praktikum **67**

Mundësi për vullnetarizëm të personave me invaliditet/pengesa **68**

Pjesëmarrja në seminare, punëtori dhe shkëmbime nga vendi dhe jashtë **71**

Webinar - online edukimi **71**

Udhëtimi me invaliditet/pengesë/handikap **71**

1) Organizimi i transportit ajror *72*

2) Strehimi me qasje *72*

3) Transport lokal me qasje *73*

Invaliditeti/pengesa dhe sporti **73**

Arti dhe artizanati përballë invaliditetit/pengesës **75**

Kapitulli 8: Përfundime dhe drejtime për aktivitete të mundshme të ardhshme:
Autore: Ana M. Llazarevska **77**

Literatura e shfrytëzuar **81**

Online resurse **82**

Kapitulli 1

Hyrje

Autor: Ana M. Llazarevska [1]

Ky Publikim përkundër Projektit tonë

Përqindja e personave me tipa të ndryshëm të invaliditetit/handikapit/pengesave në kuadër të popullatës, në disa shtete arrin edhe deri më 15 – 20%[2,3]. Kjo përqindje e madhe na obligon të mendohemi rreth pyetjes për integrimin e këtyre personave në rrjedhën e rregullt të jetës shoqërore, duke i përfshirë të gjitha nivelet dhe sferat e tija dhe sigurimin e të drejtave dhe mundësive të barabarta, të cilat janë hartuar në Kushtetutën e shteteve tona[4], por edhe në Konventën e Kombeve të Bashkuara për të drejtat e personave me handikap/pengesa/invaliditet[5].

Dy sfera jashtëzakonisht kryesore nga jeta shoqërore kanë ndikim të madh në shtrimin e rrugës së jetës të çdo njeriu, d.m.th. arsimit, e më vonë edhe punësimi. Pa mundësi të siguruar për realizimin e të drejtës themelore të arsimit, çdo individ vështirë që do ta gjente vendin e vet në shoqëri. Edhe më me rëndësi, vështirë do të ishte shmangia e rrezikut që i njëjti të keqtrajtohet, mashtrohet ose keqpërdoret nga/për qëllime individuale të huaja. Nga ana tjetër, pa mundësi për realizimin e të drejtës themelore për punësimin dhe fitimin e kompensimit adekuat/shpërblim për punën e vet, çdo personalitet do të ballafaqohej me vështirësi në realizimin e të drejtës themelore të jetës. Këtyre dy të drejtave ndërlidhen TË GJITHA të drejtat e njeriut, që çdo qytetari duhet ti garantohen dhe të sigurohen.

Për fat të keq, në shoqëritë tona, këto dy të drejta të çdo qytetari, ende nuk janë plotësuar dhe garantuar tërësisht. Projekti "Sigurimi i qasjes së barabartë për personat me invaliditet/handikap/pengesa përmes të mësuarit shërbyes" (Ensuring Equal Access through Service Learning for Persons with Disabilities), që është financuar nga ana e Fondit për angazhim inovativ të alumnive (Alumni Engagement Innovation Fund – AEIF[6]), ndërsa i administruar nga State Departamenti i SHBA-ve[7], paraqet hap të rëndësishëm në promovimin e të drejtave të personave me handikap/invaliditet/pengesa përmes afrimit të nevojave të kësaj popullate ndaj atyre të cilët do të duhej të jenë bartës-pionierë në realizimin e ideve të reja, kuptimeve, trajtimit dhe metodave – d.m.th. studentëve.

---

[1] dr. Ana Llazarevska, docente pranë Fakultetit të makinerisë – Shkup, Universiteti "Shën Qirili dhe Metodi", Shkup, Maqedoni. E-mail: ana.lazarevska@gmail.com and ana.lazarevska@mf.edu.mk.
[2] http://www.un.org/disabilities/default.asp?id=18.
[3] http://www.rollingrains.com/readings/2010/03/the-number-of-people-with-disabilities-worldwide.html.
[4] Ky publikim është rezultat i projektit "Sigurimi i qasjes së barabartë të personave me invaliditet/handikap përmes aplikimit të metodologjisë së të mësuarit shërbyes", që është bilateral mes Maqedonisë dhe Kroacisë. Megjithatë, kur thuhet "shtetet tona", mendohet për cilindo shtet nga i cili do ta kishte prejardhjen lexuesi ynë i çmuar, ku të drejtat e të gjithë qytetarëve janë rregulluar në kuadër të Kushtetutës së atij shteti adekuat, ndërsa në pajtim me konventat dhe marrëveshjet ndërkombëtare.
[5] http://www.un.org/disabilities/convention/conventionfull.shtml
[6] https://alumni.state.gov/aeif/funded.
[7] Përshkrimi i shkurtër i aplikacionit të projektit mund të merret në: http://www.equalaccess4pwds.org/sites/default/files/resources/AEIFproposal_MK_CR_finalists_narrative_new.pdf.

Projekti ka për qëllim:

(1) të ngrihet vetëdija për nevojën nga raporti korrekt ndaj personave me invaliditet/handikap/pengesa, dhe
(2) të mundësohet, avancohen dhe garantohen të drejtat e barabarta për këta persona.

Si vegël për realizimin e qëllimit kryesor të Projektit tonë AEIF, vendosëm ta aplikojmë metodologjinë, konceptin, praktikën e të ashtuquajturit "të mësuarit shërbyes" (në gj. angleze service learning). Edhe pse në nivel global kjo metodologji është relativisht mirë e njohur dhe e aplikuar, në institucionet e arsimit sipëror në Republikën e Maqedonisë kjo akoma është në fillim[8]. Në vitin 2010, në kuadër të **Konferencës rajonale të alumnive të JFDP,** në fokus ishte çështja se si personave me invaliditet/handikap/pengesa t'u mundësohet qasja e barabartë)veçanërisht ndaj arsimit) dhe si në mënyrë konsekuente t'u sigurohen edhe në vepër të zbatohen të drejtat e barabarta.[9] Kjo konferencë, si dhe **Propozim plani i veprimit** që doli nga e njëjta, të cilët tregojnë se një nga metodat më të mira për zgjidhjen e kësaj pyetje komplekse është koncepti i të mësuarit shërbyes, i paraqesin hapat e parë drejt inicimit të vendosjes së institucionalizuar të "mësuarit shërbyes" në vendin tonë. Në të vërtetë, koncepti i të mësuarit shërbyes mundëson inkuadrimin e drejtpërdrejtë të palëve më të goditura dhe të prekura derisa ata në mënyrë paralele punojnë jo vetëm për dobinë e tyre dhe për dobinë e të afërmve të tyre, por mundëson edhe: emancipimin e tyre, promovimin dhe inkuadrimin në shoqëri; ngritjen e vetëdijes dhe inicimin e implementimit real të aktiviteteve të cilat shpijnë drejt zbutjes së barrierave për qasjen e përgjithshme për personat me invaliditet/handikap/pengesa. Qëllimi i këtyre përvojave sistematikisht të organizuara të ofrimit të shërbimit të bashkësisë është: [10]

- të ndihmojë në plotësimin e nevojave të vërteta të bashkësisë;
- të shërbejnë si instrument për arritjen e qëllimeve shoqërore dhe qëllimeve të bashkësisë, si dhe
- të avancohet ajo që mësohet në shkolla, në atë mënyrë që procesi të zgjerohet jashtë nga klasat, d.m.th. në bashkësi.[11]

Projekti AEIF realizohet përmes këtyre aktiviteteve të projektit:[12]

1. **Status-quo analiza** fokusohet në:
   - Nevojat individuale të personave me invaliditet/handikap/pengesa, veçanërisht gjatë arsimit, metodologjitë ekzistuese/të zbatuara të cilat përdoren në universitetet e zgjedhura në Maqedoni dhe Kroaci.

   - (Mos)ekzistimi i programeve të specializuara arsimore për personat me invaliditet/handikap/pengesa.

[8] Ristovska, Milena, 2012: „*Guidelines for effective introduction and implementation of service-learning in higher education*", A. M. Lazarevska, M. Stankosky, A. Koçi. (Eds.): Makedonsko amerikanska alumni asocijacija p. 11-13.
[9] http://www.maaa.com.mk/jfdp-conference-2010.
[10] Lazarevska, Ana and Atanasko Atanasovski, 2010, *Draft Action Plan resulting from the regional JFDP Alumni Conference "Enhancing Accessibility of the Higher Education to the Disabled"*, November 22-24, 2010 in Skopje/ Ohrid, Republic of Macedonia, Skopje, Macedonia: Friedrich Ebert Stiftung. Gjendet në: http://www.maaa.com.mk/sites/default/files/Action%20Plan_eng.pdf.
[11] Corporation for National and Community Service, *Learn and Serve America: Using Service as a Vehicle for Learning—A Most Valuable and Powerful Lesson*, Available from: http://www.nationalservice.gov/about/programs/learnandserve.asp
[12] http://www.equalaccess4pwds.org/project-activities.

2. Organizimi i një seri të **punëtorive** të cilat përfshijnë aktorë të ndryshëm:
   - Punëtoritë 1 dhe 2 *(kuadri mësimor/studentët)*
     - Identifikimi i nevojave të veçanta të personave me invaliditet/handikap/pengesa. Analiza e prapavijës psikologjike, qasja dhe raporti korrekt. Nxitja dhe promovimi i bashkëpunimit mes studentëve me dhe/ose pa nevoja individuale. Analiza e nevojave dhe dizajni i programit mësimor.

   - Punëtoritë 3 dhe 4 *(kuadri mësimor/studentët)*
     - Kuptimi dhe zbatimi i konceptit për të mësuarin shërbyes përmes zbatimit të analizave të rasteve në Maqedoni dhe Kroaci, me qëllim që të shqyrtohen çështjet për qasjen teknike, fizike/arkitektonike, informative, mësimore dhe të drejtë.

   - Punëtoria 5 (të gjitha palët e prekura)
     - Adaptimi i metodologjisë ekzistuese dhe inkorporimi i prapavijës psikologjike kur në praktikë qaset ndaj/punohet me personat me invaliditet/handikap/pengesa.

   - Punëtoria 6 (të gjitha palët e prekura) – **do të *mbahet së shpejti***
     - Prezantimi i përvojave praktike dhe rezultateve nga puna në terren.

3. Zbatimi i **punës në terren** (analiza e studimeve të rastit) në Maqedoni dhe në Kroaci
4. **Fushatë për forcimin e vetëdijes publike – *në rrjedhë.***
5. Shtypi dhe distribuomi i **publikimeve** nga projekti – ***në rrjedhë.***
6. Vendosja e **ueb-faqes** për komunikim mes të gjithë aktorëve të inkuadruar.

Përshkrimi i hollësishëm i rezultateve nga këto aktivitete mund të gjendet në ueb-faqen nën kategorinë "Aktivitete dhe rezultate".[13]

Përmbajtja e këtij Doracaku

Fryt i aktivitetit të pestë të projektit është *ky publikim.* Në bazë të informatës kthyese që e morëm gjatë fazës së planifikimit për këtë projekt, por edhe më shumë, gjatë punëtorive nga Projekti, të cilat u realizuan gjatë shkurtit të vitit 2012, dhe të cilat kishin për qëllim të sigurojnë informata më të hollësishme rreth nevojave të personave me invaliditet/handikap/pengesa, përfunduam se ekziston një numër i madh i studentëve dhe kuadrit mësimor që pothuaj asnjëherë nuk kanë pasur mundësi të komunikojnë me person me ndonjë handikap. Sipas kësaj, ata nuk kanë as informata më themelore për disa tipa të handikapit/pengesës, e as nuk i dinë karakteristikat e tyre themelore.

Prandaj, **qëllimi kryesor i këtij Doracaku** është që studentëve dhe kuadrit mësimor në institucionet e arsimit sipëror (kryesisht, por jo edhe në mënyrë ekskluzive vetëm për këto grupe), t'u sigurojë informata të afërta për atë se çka paraqet mënyra, mjetet, raporti dhe sjellja e drejtë ndaj personave me pengesa/handikap/invaliditet. Edhe më shumë, qëllimi i Doracakut është që te kuadri mësimor të iniciojë jo vetëm zgjerimin e imagjinatës së tyre në gjetjen e mënyrave dhe metodave të reja të ligjërimit dhe të mësuarit, por në kuadër të kampusit, t'i nxitë që t'i përdorin aktivitetet jashtë mësimit të rregullt si mjet për inkorporimin e personave me handikap/invaliditet/pengesa. Nga ana tjetër, në shtigje më të gjata, qasja e këtillë paraqet mjet për mundësimin e inkluzionit horizontal të personave me handikap/invaliditet/pengesa në të gjitha sferat e jetës shoqërore. Kjo qasje është mënyra e vetme se si ne mund të kontribuojmë ndaj ngritjes së vetëdijes se të gjithë duhet t'i bashkojmë forcat tona në luftën për nevoja të barabarta dhe jetë më të mirë dhe më thelbësore, ndërsa elanin tonë ta transferojmë dhe ta zgjerojmë në garantimin, sigurimin, promovimin dhe luftën për të drejta të barabarta, në përgjithësi për të gjitha personat me handikap/invaliditet/pengesa.

[13] http://www.equalaccess4pwds.org/activity-list

Ky "DORACAK PËR RAPORTIN E DREJTË NDAJ PERSONAVE ME INVALIDITET OSE ME KUFIZIME NË AFTËSITË NË ARSIMIN SIPËROR", përbëhet nga 8 Kapituj, të cilët bashkë në atë mënyrë përbëjnë një tërësi, për të cilin, ne pamë se nevojitet dhe t'u prezantohet Juve si lexues në këtë tekst, d.m.th.:

- **KAPITULLI 1**: **Hyrje**, ku sqarohet qëllimi kryesor dhe qëllimi i këtij Doracaku dhe ku definohet terminologjia që është marrë vesh të shfrytëzohet në kuadër të këtij Doracaku.
- **KAPITULLI 2**: **Klasifikimi i llojeve të invaliditetit dhe karakteristikat e tyre themelore**, ku është dhënë vështrim i shkurtër, sqarim i grupeve kryesore dhe llojeve të handikapit/pengesës/invaliditetit. Këtu i sqaruam lexuesit potencial se në rast se nevojiten informata plotësuese për lloje të caktuara të handikapit/pengesës, nevojitet që ai të kërkojë literaturë profesionale dhe të përqendrohet ndaj resurseve tjera, për shkak se qëllimi i këtij Doracaku është të sigurojë VETËM informata themelore sipas shembullit "set për ndihmën e parë".
- **KAPITULLI 3**: **Cila është qasja e drejtë: Bonton ndaj personave me invaliditet ose si të lehtësohet komunikimi me personat me invaliditet: Etika në arsimin e studentëve me invaliditet**, ku është dhënë pasqyrë e shkurtër e qasjeve të drejta – pa frika, tabu, paragjykime – ndaj personit/ave që ka/në ndonjë lloj të handikapit. Përsëri, nëse lexuesi ka dëshirë për njohuri më të thelluara për raportin e drejtë ndaj personave me handikap, u rekomandojmë resurse plotësuese.
- **KAPITULLI 4**: **Nga pikë vështrimi i ekspertëve,** ku janë dhënë informatat themelore për rolin e tre grupeve të kuadrit profesional, që është përfshirë në jetën e personave me handikap, d.m.th. defektologu, psikologu dhe punëtori social. Përsëri, nëse lexuesi është ballafaquar me situatë komplekse nga ajo që është prezantuar në këtë doracak, ju rekomandojmë që të kërkoni ndihmë profesionale.
- **KAPITULLI 5**: **Përvojat personale të personave/studentëve me invaliditet**. Gjatë përpilimit të këtij Doracaku mendonim se ai nuk do t'i shërbente mirë qëllimit të vet nëse nuk i inkuadronim edhe përvojat e disa nga kolegëve, miqve, qytetarëve tanë, të cilët janë persona me handikap. Vetëm na vjen keq që për shkak të hapësirës së kufizuar, nuk patëm mundësi të ndajmë më shumë rrëfime si këto që gjenden këtu, sepse ne jemi të vetëdijshëm se çdo njeri është individ vetëm për vete, d.m.th. se çdo rrëfim është një dhe i vetëm. Megjithatë, shpresojmë se puna jonë do të shërbejë si impuls që të fillohet me grumbullimin e rrëfimeve të ngjashme PERSONALE dhe këshillave të drejtpërdrejta për atë se si të sillemi ndaj personave me handikap nga ata vetë.
- **KAPITULLI 6**: **Shërbimi administrativ për studentët me handikap,** ku janë prezantuar rrëfimet pozitive për mënyrat e drejta se si institucionet arsimore do të duhej ta ndihmojnë studimin e numrit sa më të madh të studentëve me handikap në kuadër të kampusit të tyre.
- **KAPITULLI 7**: **Mundësi plotësuese për personat/studentët me handikap: aktivitetet jashtë mësimit,** ku folëm rreth faktit se të jesh person me handikap nuk do të thotë se automatikisht ky person duhet të privohet nga gëzimi i gëzimeve të përditshme të jetës. Përkundrazi, shoqëritë moderne dhe të zhvilluara i tejkalojnë kufijtë lidhur me inkuadrimin e personave me handikap në të gjitha sferat e jetës shoqërore. Vendet e pazhvilluara dhe vendet në zhvillim vetëm do të duhej të mbështeten në shembullin e tyre.
- **KAPITULLI 8**: **Përfundime dhe kahe për hapat e mëtejshëm të ardhshëm.**

Shpresojmë se me zgjedhjen e këtyre temave, arritëm që të ofrojmë mbikëqyrje nga shumë aspekte dhe shtresa në problemin me sigurimin e të drejtave të barabarta të personave me handikap/pengesa/invaliditet dhe se dhamë kontribut drejt luftës së përhershme për qasjen e tyre të barabartë dhe inkluzionin në shoqëritë tona. Me zgjedhjen e këtyre temave, shpresojmë se arritëm t'u

përgjigjemi pyetjeve më themelore, të cilat secili prej neve i shtron gjatë kontaktit të parë me personat me ndonjë handikap/pengesë/invaliditet.

Terminologjia e pranuar në këtë Doracak[14]

Në teori dhe në praktikë në Republikën e Maqedonisë nuk ekziston term i vetëm i harmonizuar për termin "persona me invaliditet". Shembull për këtë jo harmonizim janë dokumentet në vijim, të cilat janë në përdorim në Republikën e Maqedonisë:

1. Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë në nenin 35 alineja 3 thotë se: "Republika u siguron mbrojtje të veçantë personave invalidë dhe kushte për inkuadrimin e tyre në jetën shoqërore".
2. Në Ligjin për mbrojtje sociale përdoren termet "persona me pengesa trupore dhe persona me pengesa në zhvillimin intelektual".
3. Në "Ligjin për punësim të personave invalidëve" që në titull përdoret termi "persona invalidë".
4. Në "Ligjin për sigurim pensional dhe invalidor" përdoren teret "person invalid", "pension invalidor" dhe "sigurim invalidor".
5. Në "Ligjin për marrëdhënie pune" nga viti 2005 theksohet se "punëdhënësi nuk guxon kërkuesin "në tekstin e mëposhtëm: kandidatin për punësim) ose punëtorin ta vë në pozitë jo të barabartë për shkak të racës, ngjyrës së lëkurës, gjinisë, moshës, gjendjes shëndetësore gjegjësisht invaliditetit..." (neni 6, alineja 1). Në nenin 177 i cili mban titullin Mbrojtja e invalidëve dhe nëntitulli "punësimi, aftësimi ose riaftësimi invalidëve" vërtetohet se "punëdhënësi siguron mbrojtje të invalidëve gjatë punësimit, aftësimit ose riaftësimit në pajtim me ligjin". Në nenin 178 me titull "të drejtat e invalidëve të punës" thuhet se "punëtorit – invalid me aftësi pune të mbetur ose të ndryshuar... punëdhënësi është i obliguar t'i sigurojë..." Në Ligjin e njëjtë në nenin 169 flitet për "orarin e shkurtuar të punës, për prindin e fëmijës me probleme zhvillimore dhe nevoja të veçanta arsimore".
6. Në Rregulloren për vlerësimin e nevojave specifike të personave me pengesa në zhvillimin fizik ose psikik thuhet se "personat me pengesa në zhvillimin fizik ose psikik të cilët kanë nevoja specifike janë:
   1. Persona me të parët e dëmtuar (me të parët e dobët dhe të verbër);
   2. Persona me pengesa në zërin, të folurit dhe gjuhën;
   3. Persona me invaliditet trupor;
   4. Persona me çrregullime mendore (të lehtë, të matur, të rëndë dhe të thellë);
   5. Persona autistë;
   6. Persona me sëmundje kronike;

[14] Falënderim deri te Daniella Stojanovska – Xhingovska për sigurimin e kësaj pjese të vështrimit. Ky është segment nga pjesa për kapitullin TERMINOLOGJIA nga "Raporti për personat me invaliditet në Republikën e Maqedonisë", ku morën pjesë të gjitha organizatat e njohura lidhur me personat me handikap në Republikën e Maqedonisë, dhe atë:

- Lidhja e të verbërve të Republikës së Maqedonisë
- Lidhja e gjysmë të shurdhërve dhe të shurdhërve të Republikës së Maqedonisë
- Lidhja e personave me invaliditet trupor të Maqedonisë
- Qendra Republikane për mbështetje të personave me pengesa intelektuale – "Poraka"
- Lidhja e invalidëve nga lufta të Maqedonisë
- Federata për sport dhe rekrijim të invalidëve të Maqedonisë
- Lidhja e invalidëve të punës të Maqedonisë
- Polio Plus
- Shoqata e invalidëve "Shpresa"
- Shoqata e studentëve dhe të rinjve me handikap
- Forumi evropian i invalidëve (EDF)

7. Persona me më shumë lloje të pengesave (persona me pengesa të kombinuara në zhvillim).

7. Në "Ligjin për ndërtim" flitet se "ndërtimi për qëllime publike dhe afariste, duhet të jetë pro aktive dhe e ndërtuar ashtu që persona me invaliditet t'u sigurojë qasje të papenguar, lëvizje, qëndrim dhe punë në ndërtesën" (neni 11, alineja 1).
8. Në "Ligjin për planifikim hapësinor dhe urbanistik" flitet se "barrierat janë pengesa ndërtimi në qytete dhe vendbanimet tjera, të cilat nuk e mundësojnë lëvizjen e papenguar të personave me invaliditet".
9. Në vitin 2001 Qeveria e Republikës së Maqedonisë e miratoi "Strategjinë nacionale për barazimin e të drejtave të personave me handikap në Republikën e Maqedonisë". Në tekstin e kësaj strategjie përdoren termet persona me handikap, fëmijë me pengesa në zhvillim, i ri i invalidizuar, persona me pengesa fizike, intelektuale, psikologjike ose të shqisave.
10. Kuvendi i Republikës së Maqedonisë në vitin 2003 e miratoi Deklaratën për mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave të personave me nevoja të veçanta, ku flitet për "persona me nevoja të veçanta", "nevoja specifike të personave me handikap" dhe "persona me handikap".

Edhe në praktikë nuk ekziston term i unifikuar, kështu që më shpesh përdoren termet: persona me invaliditet, person me invaliditet, persona invalidë, invalidë, persona me handikap, persona të handikapuar, persona me pengesa në zhvillimin intelektual, persona me nevoja të veçanta dhe më rrallë persona me pengesa ose persona me nevoja specifike. Për fëmijët më shpesh përdoret termi fëmijë me pengesa në zhvillim ose fëmijë me nevoja të veçanta, gjegjësisht fëmijë me nevoja të veçanta arsimore, kur dëshirohet të theksohet segmenti arsimor nga zhvillimi i tij.

Organizatat invalidore, (me përjashtim të Qendrës për mbështetje të personave me pengesa intelektuale "Poraka"), Këshilli nacional i organizatave invalidore, Trupi koordinues për mundësi të barabarta të personave me invaliditet e kanë pranuar termin persona me invaliditet. Pjesa më e madhe e punëtorëve shkencor e preferojnë termin "persona me invaliditet". Organizata të tjera, grupi qëllimor i të cilëve janë personat me invaliditet e preferojnë termin "persona me handikap". Mjetet e informimit publik, krahas termeve persona me invaliditet ose persona me handikap, gjegjësisht persona me handikap, shumë shpesh e përdorin termin "persona me nevoja të veçanta".

Në versionin anglez të Konventës së Kombeve të Bashkuara për të drejtat e barabarta të personave me handikap/pengesa/invaliditet, përdoret termi „**Persons with Disabilities**". Qëndron argumenti se kjo mund të ketë më shumë variante në përkthimin tonë, por fakt është se shumë shpesh përkthehet si persona me invaliditet. Kështu është përkthyer edhe në përkthimin serb dhe kroat të Konventës.

Nga e tëra që u tha më sipër, mund të përfundohet se në Republikën e Maqedonisë nuk ka term të gjerësisht të pranuar për termin "persona me invaliditet". Mbisundon termi persona me invaliditet, por përdoren edhe termet persona me handikap, persona me nevoja të veçanta dhe persona me pengesa intelektuale. Për këto shkaqe, ndërsa në pajtim me të gjithë autorët dhe redaktorët, përkthyesin dhe anëtarët e projektit, u vendos që në këtë doracak paralelisht dhe në mënyrë të barabartë të përdoren të gjitha termet paraprakisht të përmendura, d.m.th. **persona me handikap, persona me nevoja të veçanta** dhe **persona me pengesa (intelektuale)**, ndërsa lexuesit i lihet të vendos cilin nga termet e përmendura në mënyrë më adekuate e përshkruan termin e një shmangie ë caktuar të aftësive fizike dhe psikike të ndonjë personi nga ato të përfaqësuesit mesatar të popullatës së përgjithshme.

Kapitulli 2:

Klasifikimi i llojeve të invaliditetit[1] dhe karakteristikat e tyre themelore

Autorë: Ivana Biliq[2], Daniella Stojanovska – Xhingovska[3]

Me Rregulloren për vlerësim të nevojave specifike të personave me pengesa në zhvillimin fizik ose psikik (Gazeta zyrtare e R.M. numër 30/2000)[4], si dhe botimi i ngjashëm nga Kroacia[5], vërtetohet lloji dhe shkalla e pengesave në zhvillimin fizik ose psikik; profilet profesionale të anëtarëve të organit i cili jep gjetje dhe mendim për vlerësim të nevojave specifike të organit të shkallës së parë dhe të dytë për personat me pengesa në zhvillimin fizik ose psikik, mënyrën e vlerësimit të nevojave specifike dhe të mbajtjes së evidencës dhe institucioni që do të japë gjetje dhe mendim.

Para se të vendosim nëse e pranojmë këtë klasifikim realizuam një hulumtim gjithëpërfshirës të literaturës botërore, si do të siguroheshim se klasifikimi ynë është i pranueshëm dhe reprezentues. Disabled World Community paraqet organizatë, qëllimi i së cilës është përmes Servisit të vet për risi, artikuj, materiale të shtypura dhe video, t'i furnizojë me të dhëna dhe risi, bashkësitë dhe organizatat invalidore, publike, si dhe përfaqësuesit për të drejtat e personave me invaliditet/pengesa. Në internet faqen e Disabled World Community e gjetëm klasifikimin për personat me invaliditet[6]: invaliditet trupor dhe pengesa në lëvizje; sëmundje të boshtit kurrizor; invaliditet për shkak të lëndimit të kokës – trurit; të parët e dëmtuar; të dëgjuarit e dëmtuar; pengesa konjiktive ose pengesa gjatë të mësuarit; çrregullime psikike dhe pengesa që nuk vërehen. Qendrat për kontroll dhe parandalim të sëmundjeve[7] i klasifikojnë llojet e pengesave si: të dëgjuarit; të parët; lloji; lëvizshmëria; të menduarit; memoria; të mësuarit; komunikimi; shëndeti mental dhe lidhja sociale.

Kati Henderson (Cathy Henderson[8]) në hulumtimin e saj për profilin e kolegëve me invaliditet të sapo regjistruar përfshinë: pengesa gjatë të mësuarit, lloji, ato lidhur me shëndetin, ortopedike, dëgjimi, të folurit dhe lloje të tjera të invaliditetit. Në pajtim me Servisin për studentë me invaliditet pranë Universitetit Xhon Hopkins (John Hopkins University[9]) ekziston klasifikimi si vijon i invaliditetit/pengesës: çrregullim hiper aktiv me deficit të vëmendjes (Attention deficit hyperactivity disorder – ADHD); verbësia ose të parët e dobët; lëndime të kokës; të qenit shurdh /gjysmë shurdh; pengesa gjatë të mësuarit; gjendje mjekësore; invaliditet trupor; sëmundje psikiatrike dhe pengesa në të folurit dhe gjuha.

---

[1] Në pajtim me Kushtetutën e R. Maqedonisë, përdoret termi "invaliditet". Megjithatë, duke pasur parasysh sugjerimet nga personat profesional dhe vetë personat me handikap, në këtë publikim në mënyrë të barabartë do të përdoren edhe termet "pengesa" dhe "handikap". Sqarimi për arsyetimin e kësaj qasjeje më hollësisht është përpunuar në Kapitullin 1: Hyrja në këtë publikim. (Vërejtje e redaktorëve)

[2] Dr. Ivana Biliq, D.Sc. e shkencave ekonomike, është docent pranë Fakultetit Ekonomik, Universiteti në Split, e-mail: ibilic@efst.hr, ivanab13@yahoo.com.

[3] Daniella Stojanovska – Xhingovska, B. Sc. E defektologjisë, kryetare e Shoqatës së studentëve dhe të rinjve me handikap – Shkup, Maqedoni, e-mail: stojanovskad@gmail.com.

[4] Rregullorja për vlerësimin e nevojave specifike të personave me pengesa në zhvillimin fizik ose psikik (Gazeta zyrtare nr. 30/2000).

[5] "Gazeta zyrtare" kroate nr. 41/2001 & 55/2001.

[6] http://www.disabled-world.com/disability/types/

[7] http://www.cdc.gov/ncbddd/disabilityandhealth/types.html

[8] Henderson, C. (1995), 'College Freshman with Disabilities A Triennial Statistical Profile', American Council on Education, HEATH Resource Center: http://www.perceptions4people.org/component/content/article/56-general/134-heath-resource-center.html.

[9] http://web.jhu.edu/disabilities/faculty/types_of_disabilities/.

Fakti se në literaturë ndonjëherë përdoren edhe terme/shprehje të tjera na solli deri te përfundimi se klasifikimi ynë i llojeve të invaliditetit/pengesave është i drejt dhe kaluam në hapin tjetër, gjegjësisht të japim sqarim për invaliditetin/pengesa dhe llojet specifike të invaliditetit/pengesave. Qëllimi i këtij elaborati tonë është të japim hyrje të shkurtër në botën e invaliditetit/pengesave, si për kuadrin mësimor, ashtu edhe për atë jo mësimor në vendet tona[10,11,12]. Gjithashtu, jemi të bindur se ky doracak do t'i mbështes përpjekjet e tyre dhe tonat në sigurimin e qasjes së barabartë të personave me invaliditet/pengesa në arsimin sipëror.

Për nevojat e këtij doracaku do ta përdorim definicionin që vijon për invaliditetin/pengesat: '**Invaliditeti/pengesa paraqet gjendje ose funksion që llogaritet si mjaft e keqe lidhur me standardet e rëndomta për individët ose grup.** Termi që përdoret ka të bëjë me funksionimin e individit, ndërsa kjo përfshin invaliditet/pengesë trupore, pengesa sendore, pengesë konjiktive, pengesë intelektuale, sëmundje mentale dhe lloje të ndryshme të sëmundjeve kronike.`[13,14]

Sipas klasifikimit në R. Maqedonisë, me rregulloren për vlerësim të nevojave specifike të personave me pengesa në zhvillimin fizik ose psikik[15], në Nenin 4, dhe sipas klasifikimit të ngjashëm në R. Kroacisë[16], mund të ndahen tipat e ndryshëm që vijojnë të personave me handikap, d.m.th. kanë nevoja specifike:

1. Persona me të parët e dëmtuar (të parët e dobët dhe të verbër);
2. Persona me të dëgjuarit e dëmtuar (të shurdhër dhe gjysmë të shurdhër);
3. Persona me pengesa në zë, të folurit dhe gjuhën
4. Persona me invaliditet trupor;
5. Persona me çrregullime mentale (të lehtë, të matur, të rëndë dhe të thellë);
6. Persona me autizëm;
7. Studentë me disleksi;
8. Studentë me çrregullime hiper aktive me deficit të vëmendjes (këtu do t përdoret shkurtesa ADHD);
9. Personat me sëmundje kronike;
10. Personat me më shumë lloje të pengesave (persona me pengesa të kombinuara në zhvillim).

[10] Bilić, I. (2010), 'Access to Higher Education for Disabled in Croatia', Book of Abstracts of the Regional JFDP Alumni Conference: 'Enhancing Accessibility of the Higher Education to the disabled', November 22-24, 2010, Skopje/Ohrid, Macedonia. p. 25.

[11] Risteska, J. (2010), 'Inclusive Higher Education', Book of Abstracts of the Regional JFDP Alumni Conference: 'Enhancing Accessibility of the Higher Education to the disabled', November 22-24, 2010, Skopje/Ohrid, Macedonia. p. 20.

[12] http://www.iro.hr/hr/javne-politike-visokog-obrazovanja/kolumna/studirati-s-invaliditetom/ (retrieved October 29, 2010.)

[13] http://www.disabled-world.com/disability/types/.

[14] http://www.apt.gc.ca/wat/wb12200E.asp?Lt=D

[15] Rregullorja për vlerësim të nevojave specifike me pengesa në zhvillimin fizik ose psikik (Gazeta zyrtare e R.M., nr. 30/2000).

[16] Kis-Glavas, L., urednik (2012), Zbirka priručnika 'Studenti s invaliditetom', Sveučilište u Zagrebu, Zagreb (përkth. Kis – Glavas, L. Redaktor (2012), Përmbledhje doracakësh `Studentë me invaliditet`, Universiteti i Zagrebit, Zagreb).

Termi dhe karakteristikat e personave me të parët e dëmtuar

1) Klasifikimi dhe definicioni i termit "të parët e dëmtuar"

Në pajtim me klasifikimin e Disabled World[17], që e ndjek definicionin e Organizatës Shëndetësore Botërore (World Health Organization), dallohen këto katër tipa që vijojnë të personave me pengesa në të parët: **verbësia, të parët e dëmtuar, daltonizmi** (çrregullim gjatë njohjes së ngjyrave) dhe **të parët e dobët.**

Verbësia – person me të parët tërësisht të dëmtuar përcakton se personi ka mprehtësi të parit më të vogël se 20/200[18] në syrin më të shëndoshë ose ka fushë shikimi shumë të kufizuar (20 shkallë fusha më e gjerë); persona tërësisht të verbër nuk mund të shohin aspak. Për shkak të kësaj nuk mund të shihet monitori i kompjuterit dhe nuk mund të përdoret kompjuteri pa përshtatjen e të njëjtit, si dhe aparate tjera për të cilat nevojitet të parët.

Të parët e dëmtuar – Verbësia përcakton humbjen e tërësishme ose pothuaj të tërësishme të aftësisë që të perceptohet forma. Të parët e dobët përcakton humbjen e aftësisë që të përdoret një pjesë e caktuar nga perceptimi pamor, por me varësi të madhe nga informata që merret nga një burim tjetër.

Daltonizmi – pamundësia që të perceptohen ngjyrat në mënyrë të zakonshme. Shpesh, çrregullimi paraqitet gjatë ngatërrimit të ngjyrës së kuqe/të gjelbër. Çrregullimi tjetër i zakonshëm është edhe ngatërrimi i ngjyrës së kaltër gjegjësisht ngjyrës së verdhë. Daltonizmi jashtëzakonisht paraqitet te meshkujt 1 në 10. Në mënyrë primare gjatë punës me kompjuter duhet të bëhet zgjedhje adekuate e ngjyrave në ekran.

Të parët e dobët – ekziston te personat me dëmtim serioz të parët pas korrigjimit të intervenuar, por nuk mund të kenë funksion të përmirësuar të parët me ndihmën e ndihmesës korrigjuese. Sipas Organizatës Shëndetësore Botërore personat me të parët e dobët kanë mprehtësi të parët prej 6/18 (0.3), por njëlloj ose më mirë prej 3/60 në syrin më të shëndoshë gjatë korrigjimit më të mirë. Kur me syze të rëndomta, thjerrat kontakte ose implantantë syri nuk mund të arrihet mprehtësia e të parët për personin thuhet se është me të parët e dobët. Edhe pse është e zakonshme dukuria e të parët të zvogëluar qendror ose të parët për lexim, të parët e dobët gjithashtu mund të jetë rezultat i të parët të zvogëluar anësor (periferik), të parët e zvogëluar ose pamundësia e syrit t'i përshtatet dritës, kontrastit ose reflektimit.

Nga ana tjetër, sipas Rregullores për vlerësim të nevojave specifike të personave me pengesa në zhvillimin fizik ose psikik, si persona me pengesa në të parët llogariten **të verbrit** dhe personat **me të parët e dobët**.[19]

Me të parët e dobët llogaritet personi që në syrin më të shëndoshë me qelqe korrigjues ka mprehtësi të parët më pak se 40% (0,4) dhe personi i cili në syrin më të shëndoshë me qelq korrigjues ka mprehtësi të parët më të madh se 40% (0,4), por ku parashihet keqësim i dukshëm i të parët.

I verbër llogaritet personi që në syrin më të shëndoshë me qelq korrigjues ka mprehtësi të parët deri 10% (0,10) dhe personi me të parët qendror në syrin më të shëndoshë me qelq korrigjues deri 25% (0,25), ku fusha e shikimit i është ngushtuar deri 20 shkallë.

Sipas shkallës së pengesës personat e verbër renditen në tre grupe dhe atë:

- Personi i cili tërësisht e ka humbur ndjenjën për dritë (amauroza).

[17] http://www.apt.gc.ca/wat/wb12200E.asp?Lt=D.
[18] Defincionet për nivelet e ndryshme të parët, mund të gjenden në: http://www.eyecaretyler.com/2020.htm.
[19] Rregullorja për vlerësim të nevojave specifike të personave me pengesa në zhvillimin fizik ose psikik (Gazeta zyrtare e RM, nr. 30/2000).

- Personi i cili në syrin më të shëndoshë me qelq korrigjues ka të parët e mbetur deri 5% (0,05) ose personi i cili në syrin më të shëndoshë me qelq korrigjues ka të parët e mbetur më pak se 10% (0,10) ose ka fushë të shikimit të ngushtuar deri 20 shkallë.
- Personi i cili në syrin më të shëndoshë me qelq korrigjues ka të parët e mbetur më pak se 10% (0,10) dhe personi me të parët qendror në syrin më të shëndoshë me qelq korrigjues deri 25% (0,25) dhe ka fushë shikimi më të ngushtë deri 20 shkallë.

Person i verbër praktik llogaritet personi me aftësi aq të zvogëluar funksionale të organit për të parë që nuk i mundëson edukim dhe arsimim kryesisht përmes mënyrës vizuale.

2) Karakteristikat kryesore të personave me të parët e dëmtuar

Imazhi që fitohet në kushte të abstenimit të parët, ndërsa në bazë të shqisave tjera kontaktuese (të prekurit, aroma, shija dhe vibracioni) në vend të informatës objektive, në vetëdije formojnë një botë të imagjinuar, informatë, pasqyrë. Me fjalë të tjera personi i verbër, ndjenjat i fiton me atë të shqisës të dëgjimit (fotografia auditive), shqisa për prekje (fotografia haptike), të lëvizjes (fotografia kinestetike), më shumë i ndërlidh sendet dhe ndjenjat sipas asaj si e ka përjetuar (çfarë ka qenë e para, çfarë ka qenë e dyta, e çfarë pastaj), që do të thotë sipas rendit kohor, e jo sipas asaj hapësinore. Kjo është e kuptueshme, pasiqë orientimi në hapësirë është një nga sekuencat dominuese të shqisës. Kështu vijmë deri te konsekuenca tjetër psikologjike të verbësisë, e kjo është se te lëvizja në hapësirë, orientimi në hapësirë te të verbrit ekzistojnë dallime të mëdha.

Personat që e kanë humbur më vonë të parët, bile edhe disa persona me dëmtim të parët që nga lindja, pas fitimit të përvojës së parë, lëvizin, nuk e humbin orientimin, nuk ndeshen dhe nuk pengohen. Kjo aftësi për të vërejtur dhe shmangia e pengesave i ka sjellë disa autorë të krijojnë teorinë e shqisës së gjashtë. Së shpejti është vërtetuar se shqisa e tillë nuk ekziston por se bëhet fjalë për shqisë të stërholluar të dëgjimit dhe të prekurit, që i ndihmon personit në mënyrë të lehtë t'i mbisundojë pengesat në të cilat hasën. Kjo arrihet me ushtrime, sepse humbja e të parët kërkon që i verbri, vazhdimisht ta dëgjojë dhe ta vërejë jehonën e hapave të tija ose jehonën nga shkopi në dysheme, që e informojnë për pengesat.

Shqisat për të dëgjuar dhe për të prekur janë pikërisht shqisat me të cilat të verbrit e shohin botën, e kështu Monte thotë: "Me shqisën e të parët ne hymë në jetën dhe botën, por përmes shqisës për të dëgjuar dhe për të prekur bota dhe jeta hynë në vetëdijen tonë". Prej këtu, kur të verbrit dëshirojnë diçka të njohin thjesht do të thonë "më jep të shoh" që praktikisht do të thotë "më jep ta prek" [20].

Kur bëhet fjalë për inteligjencën te të verbrit, nëse ata trajtohen në mënyrë identike dhe nëse u mundësohen kushte të barabarta për zhvillim dhe arsim, mund të thuhet se nuk ekzistojnë dallime të mëdha lidhur me personat që nuk kanë pengesa në të parët. Në të vërtetë, verbësia si pasojë e dëmtimit të syve nuk e zvogëlon aftësinë për zhvillim intelektual, sepse nuk e dëmton koren e trurit. Përkundrazi, njihen raste të shumta ku pikërisht për shkak të inteligjencës së madhe natyrore dhe mungesës së të parët, i verbri ose personi me të parët e dëmtuar arrin rezultatet të jashtëzakonshme si në arsim, ashtu edhe në punë.

Vetëm në kushte **të mospërfilljes edukative dhe sociale** vjen deri te mospërfillja dhe mbetja prapa, që në të vërtetë ekziston edhe te personat te të cilët është ruajtur shqisa për të parët, ndërsa për shkak se të gjithë nuk kanë inteligjencë të barabartë.

Të folurit te fëmija/personi i verbër zhvillohet më vonë. Kjo vjen nga ajo që për zhvillimin e të folurit nuk nevojitet vetëm komponenti akustik, por edhe vizual, d.m.th. sepse komponenti vizual ndikon mbi orientimin e drejt të lëvizjeve të artikuluar të burimit të zërave të caktuar, e jo vetëm të mbrehje kthyese akustike. Bile edhe kur të verbrit do t'i mësojnë fjalët – të folurit, në procesin e edukimit

[20] Prof. dr. Risto Petrov, Laura Gjurçinovska, Natasha Stojanovska – Trajkovska "Mbrojtja dhe rehabilitimi i personave me invaliditet", Shkup 2008, Fakulteti Filozofik – Instituti i defektologjisë.

vërehet një zbrazëtirë e caktuar në pikëpamjen semantike, fjalët sikur janë boshe dhe pa përmbajtje. Krejtësisht ndryshe është karakteristika psikologjike e fëmijëve/personave të cilët dikur kanë parë, e pastaj e kanë humbur të parët. Te ata ekziston fotografi vizuale, termet janë shumë më komplekse dhe më të gjera.

Kur bëhet fjalë për karakteristikat themelore të personave me të parët e dëmtuar dhe të personave me të parët e dobët, para së gjithash, duhet të përmendet se këta persona, si dhe të gjithë të tjerët të cilët nuk kanë pengesa në zhvillim, do të thotë se edhe ata zhvillohen sipas ligjeve të përgjithshme të zhvillimit njerëzor/fëmijëror/rinor. Është e mundur paraqitja të disa lëshimeve të cilat janë kushtëzuar nga dëmtimi i të parët dhe të cilat shihen në mënyrën në të cilën kjo ligjshmëri realizohet.

Këtyre personave duhet t'u mundësohet aplikimi i formave personale të stimulimit. Për shkak të dëmtimit të parët këta persona janë pasivë, më pak të lëvizshëm, shprehin jo interesim dhe nuk mund ta ndjekin sjelljen e njerëzve të tjerë.

Termi dhe karakteristikat kryesore të personave me të dëgjuarit e dëmtuar

Personat me të dëgjuarit e dëmtuar janë personat (d.m.th. studentët) të cilët tërësisht ose pjesërisht janë të shurdhër (gjysmë të shurdhër). Personat gjysmë të shurdhër përdorin ndihmesa dëgjimi që u ndihmojnë për të dëgjuar. Shurdhimi mund të paraqitet gjatë lindjes ose më vonë në jetë për më shumë shkaqe nga natyra biologjike. Personat e shurdhër mund të përdorin gjuhën e shenjave si mënyrë të komunikimit, ndërsa zakonisht përdorin komentues të gjuhës së shenjave. Në botë përdoren disa qindra gjuhë të shenjave dhe ato dallohen si edhe çdo gjuhë tjetër e huaj.

Sipas shkallës së dëmtimit personat me të dëgjuarit e dëmtuar ndahen në **të shurdhër dhe gjysmë të shurdhër**.

1) Personat gjysmë të shurdhër[21]

Për **gjysmë të shurdhër** llogariten personat te të cilët dëmtimi i të dëgjuarit në veshin më të shëndoshë është prej 25 deri 80 dB (decibelë) dhe të cilët tërësisht ose pjesërisht e kanë zhvilluar të folurit verbal.

Sipas **shkallës së dëmtimit të dëgjuarit, koha kur ka ndodhur** dhe **shkalla e zhvillimit të folurit, personat gjysmë të shurdhër ndahen** në:

- Personat me dëmtim të lehtë të dëgjuarit prej 25 deri 40 dB, të cilët spontanisht mund të zhvillojnë të folurit verbal;
- Personat me dëmtim mesatar të dëgjuarit prej 40 deri 60 dB, të cilët para dëmtimit spontanisht e kanë zhvilluar të folurit;
- Personat me dëmtim mesatar të dëgjuarit prej 40 deri 60 dB, te të cilët dëmtimi i të dëgjuarit ka ndodhur para se ta zhvillojnë të folurit, e si pasojë kanë të folur pjesërisht të zhvilluar;
- Personat me dëmtim të rëndë të dëgjuarit prej 60 deri 80 dB, të cilët spontanisht kanë zhvilluar të folurit para se të ndodhë dëmtimi;
- Personat me dëmtim të rëndë të dëgjuarit prej 60 deri 80 dB, te të cilët dëmtimi i të dëgjuarit ka ndodhur para se ta zhvillojnë të folurit, ndërsa në momentin e vlerësimit të nevojave specifike kanë të folurit e zhvilluar të pamjaftueshëm.

[21] Lidhja e defektologëve të Republikës së Maqedonisë, "Si deri te komuna inkluzive?" – Doracak për të punësuarit në njësitë e vetëqeverisjes lokale, Shkup 2012.

2) Personat e shurdhër

Për **të shurdhër** llogariten personat te të cilët dëmtimi i të dëgjuarit është më i madh se 80 dB dhe të cilët me amplifikator dëgjimi nuk mund ta perceptojnë tërësisht të folurit verbal.

Personat **e shurdhër** ndahen në të shurdhër **praktik**, të cilët me amplifikator dëgjimi mund të dëgjojnë super segmente të veçanta nga të folurit dhe të shurdhër **të plotë** të cilët kanë perceptim dëgjimi tërësisht të humbur.

Sipas **kohës kur ka ndodhur dëmtimi** i dëgjimit dhe **shkalla e zhvillimit të folurit, personat e shurdhër** ndahen në:

- Personat të cilët para dëmtimit të dëgjimit e kanë zhvilluar të folurit verbal dhe në kohën e vlerësimit të nevojave specifike flasin mirë;
- Personat të cilët para dëmtimit të dëgjimit nuk e kanë zhvilluar spontanisht të folurit verbal, e pastaj me trajtim surdo audiologjik intensiv dhe sistemor e kanë arritur këtë;
- Personat të cilët e kanë humbur të dëgjuarit para se ta zhvillojnë të folurit verbal, ndërsa në momentin e ndarjes kanë të folur të ndërtuar të pamjaftueshëm ose nuk mund të flasin.

3) Personat me dëmtime të kombinuara, te të cilët dëmtimi i dëgjimit është primar

Nevojat specifike të personave me dëmtime të kombinuara, te të cilët dëmtimi i dëgjimit është primar, ndahen varësisht nga lloji dh shkalla e dëmtimit.

4) Karakteristikat e personave me të dëgjuarit e dëmtuar[22]

Te personi me të dëgjuarit e dëmtuar paraqiten manifestime të caktuara karakteristike. Në të vërtetë, për shkak të faktit se gjatë fëmijërisë, personi nuk ka mundur ta dëgjojë zërin e nënës, të qeshurit e saj, të qarët, këndimi, para së gjithash, të folurit e saj, për çka këto mjete shërbejnë për përcjelljen e të kuptuarit dhe emocioneve, gjithsesi është i mundur zhvillimi i mëvonshëm i emocioneve te fëmija/personi me të dëgjuarit e dëmtuar. Në fazën e **zhvillimit më të hershëm,** pasiqë nuk ka nxitje akustike nga të qarët e vet, fëmija i shurdhër ka të qarët ndryshe nga fëmijët tjerë dhe këta fëmijë, në përgjithësi janë më nervozë. Në **periudhën e mëvonshme të zhvillimit** paraqiten disa manifestime evidente: të ecurit e pasigurt, që paraqitet si rezultat i dëmtimit të aparatit vestibular, ndërprerja e gugatjes, pasiqë nuk ka feedback fëmija nuk i kushton vëmendje cilitdo burim të zërit. Fëmijët të cilët kanë **dëmtim të pjesshëm të dëgjimit** dëgjojnë vetëm grupe të zërave me intensitet të lartë derisa zërat tjerë nuk i përsërisin. Ata trokasin fuqishëm me sendet me të cilat luajnë, pasiqë zëri i fuqishëm nuk i ngacmon mbetjet e dëgjimit. Reagojnë vetëm në bërtitje, por jo edhe në të folurit normal me intensitet të dobët.

Për shkak të karakteristikave të cekura më parë, fëmija i shurdhër, ndërsa më vonë si njeri i rritur nuk mund t'i shpreh ndjenjat, nevojat dhe idetë e veta në mënyrë verbale, të njëjtat nuk mund ose vështirë i kupton edhe te të tjerët. Në kushte të hipoakuzisë personale (mungesë e perceptimit të dëgjimit), do ta riprodhojë të folurit ashtu siç e dëgjon. Gjatë kësaj shumë zëra do t'i shqiptojë gabimisht, ndërsa fjalët do t'i njohë vështirë.

[22] Prof. dr. Risto Petrov, Laura Gjurçinovska, Natasha Stojanovska – Trajkovska "Mbrojtja dhe rehabilitimi i personave me invaliditet", Shkup 2008, Fakulteti Filozofik – Instituti i defektologjisë.

Te personat e shurdhër mendimet ngecin dhe shndërrohen në konkretizim të njohjes së fjalëve me gjeste. Mu për këtë, zhvillimi intelektual nuk e ka rrjedhën e tij normale, e pasiqë i mungojnë komponenti akustik dhe kauzaliteti, ai mbetet statik dhe jo i plotë.

Personat me dëmtime në të dëgjuarit, mund të jenë shumë të shkathtë në leximin nga goja, por për fat të keq, disa prej tyre nuk janë. Në të vërtetë, 30 deri 40 për qind nga gjuha amtare (qoftë anglishtja, maqedonishtja, kroatishtja ose ndonjë gjuhë tjetër) mund të kuptohet me leximin nga goja dhe atë gjatë kushteve shumë të mira të mundshme të folurit dhe gjatë përqendrimit maksimal prej rreth 20 minutave.

Gjithashtu personat me dëmtime të dëgjuarit kanë vështirësi në të folurit, leximin dhe shkrimin. Duke marrë parasysh lidhjen e afërt mes zhvillimit të folurit dhe dëgjimit, mosha kritike është mes vitit të dytë dhe të tretë, do të thotë koha kur fëmija fillon të mësojë të flasë.

Në komunikimin e tyre, ndërsa me qëllim të përmirësimit të cilësisë të njëjtit, personat me dëmtim të dëgjuarit shfrytëzohen me të folurit, leximin nga buzët, ndihmesat dëgjuese dhe aparatet për forcim.

Duhet të merret parasysh se për personat me dëmtim të dëgjuarit shpesh gjuha "amtare" është e shenjave, derisa gjuha zyrtare e shtetit ku jetojnë, për ata, është gjuhë e dytë.

Për shkak të specifikës së botës së tyre individuale, personat me dëmtim të dëgjuarit mund të trajtohen edhe si grup i veçantë linguistik, që i ka edhe përcaktimet e veta individuale kulturore, dhe si e tillë, ata ,und të kenë edhe normat, vlerat dhe traditat e veta individuale sociale.

Hulumtimet bashkëkohore flasin edhe për disa forma karakteristike të reagimit siç janë agresiviteti, impulsivja, egocentrizmi, mungesa e aftësisë empatike, mungesa e moralit dhe të imazhit për veten.

Termi dhe karakteristikat kryesore të personave me pengesa në zërin, të folurit dhe gjuhë

Me pengesa në të folurit dhe zërin janë personat të folurit e të cilëve nuk i përgjigjet moshës së tyre ose nuk është i kuptueshëm, nuk është i drejt dhe i pa ndërtuar në gramatikë dhe semantikë, me pengesa konvulsive (ngërçe) në mekanizmin dhe automatizmin e të folurit, për çka nevojitet trajtim logopedie dhe mjekim.

Sipas llojit dhe shkallës së çrregullimit të komunikimit verbal personat ndahen në grupet që vijojnë:

- persona me mungesë të plotë të folurit që quhet alali,
- persona ,e zhvillim patologjik të folurit,
- persona me nazalizim, rinologji të rëndë (të folurit me timbër hundor),
- persona me mungesë dhe dëmtim të rëndë të zërit – afoni dhe difoni,
- persona me të folurit rëndë të dëmtuar për shkak të paralizës cerebrale fëmijërore, autizëm,
- persona me të folurit e dëmtuar ose të folurit e humbur më parë të mësuar – afazia dhe difazia,
- persona me kombinim të pengesave të përmendura.

Termi dhe karakteristikat kryesore të personave me invaliditet trupor dhe sëmundje kronike/sindrome

Invaliditeti trupor është gjendje e zvogëlimit ose humbjes së aftësisë funksionale të një ose më shumë pjesëve të trupit, me çka në mënyrë të dukshme zvogëlohet aftësia e personit në plotësimin e nevojave themelore jetësore. Në këtë kategori janë përfshirë studentët me lëndime të boshtit kurrizor (paraplegia ose kuadriplegia), paraliza cerebrale, spina bifida, amputimet, distrofia muskulore, sëmundje të zemrës, fibroza cistike, paraliza, polio/post polio, skleroza amiotrofike laterale, sulmet, sëmundje të

sistemit periferik nervor (paraliza infantile), si dhe personat të cilët kanë sëmundje kronike (kancerogene, diabeti, astma, epilepsia, sëmundja e Kronit, alergjitë).

Këto pjesë të invaliditetit/pengesave te studentët paraqiten në forma të ndryshme dhe duhet të llogaritet çdo rast individualisht, që do të thotë diagnoza e njëjtë mund të manifestohet te studentët e ndryshëm në mënyra të ndryshme. Varësisht nga nevojat specifike që paraqiten si pasojë e zvogëlimit ose humbjes të aftësisë funksionale, invaliditeti trupor mund të jetë **i rëndë, më i rëndë** dhe **shumë i rëndë.**

- **Invaliditeti i rëndë** ekziston kur personi pavarësisht mund t'i plotësojë nevojat e tija me ndihmën e mjeteve ortopedike ose adaptimi i mjedisit fizik;
- **Invaliditeti më i rëndë trupor** ekziston kur personi mund t'i plotësojë nevojat e veta, por me ndihmën e personit tjetër;
- **Invaliditeti shumë i rëndë trupor** ekziston kur personi ka nevojë nga kujdesi dhe përkujdesja e përhershme në plotësimin e nevojave themelore biologjike dhe sociale.

Rëndësia psikologjike e invaliditetit trupor paraqet problem të madh. Nën të ashtuquajturin **"dimension psikologjik"** nga njëra anë, nënkuptohen të gjitha përjetimet subjektive dhe efektet sekondare të personalitetit, që është i goditur nga dëmtimi trupor, ndërsa nga ana tjetër, rëndësia e mjedisit, që përmes qëndrimeve, raporteve, reagimeve dhe paragjykimeve të veta ia shton dëmtimit. Pikërisht, nën ndikimin e faktorëve të ndryshëm në të gjitha fushat të funksionimit të personit me invaliditet trupor mund të paraqiten dëmtime në **fushën motorike, sociale** dhe **intelektuale.**

Çdo fëmijë/person me invaliditet trupor ka mundësi që të zhvillohet në personalitet adekuat dhe normal, me të gjitha aftësitë që i plotëson potencialet, kapacitetet e tija dhe me aq kufizime sa e imponon dëmtimi i tij trupor primar. Nëse kjo fëmijë/ky person do t zhvillohet në kufirin e potencialeve të tija reale, kryesisht varet nga kushtet psikologjike dhe sociale të zhvillimit.

Edhe pse në përditshmëri është praktikë që personat me invaliditet trupor të inkuadrohen në procesin e rregullt arsimor, problem paraqesin vështirësitë objektive: lëvizshmëria e zvogëluar, sundimi i barrierave arkitektonike brenda dhe jashtë shkollës, transporti nga shkolla në shtëpi, aftësitë manipuluese, komunikimi.

Përveç faktorëve objektiv, vështirësi plotësuese paraqet edhe rezistenca e arsimtarëve për pranimin e këtyre fëmijëve në shkollat e rregullta, si dhe raporti i tyre i pamjaftueshëm, joadekuat dhe jo stimulues ndaj tyre. Fëmijët me invaliditet nuk janë pranuar plotësisht në shkollë, nuk inkuadrohen në aktivitetet e orëve dhe gjatë pushimit, ndërsa rrallë shoqërohen edhe jashtë shkollës. Integrimi i vërtetë i këtyre fëmijëve/personave në mjedisin social arrihet vetëm me arsimimin e tyre në shkollat e rregullta, e kjo shumë shpesh është e pamundur për shkak të invaliditetit të tyre, si dhe për shkak të jo gatishmërisë për pranimin, mospasja eupatisë dhe inertja e mjedisit.

Termi dhe karakteristikat e personave me pengesa në zhvillimin intelektual (mental)[23]

Edhe pse, për fat të keq, për shkak të mënyrës se si është vendosur arsimi në mjediset tona, janë të rralla rastet ku disa nga personat me pengesa në zhvillimin intelektual (mental) të arrijnë nivel të arsimit sipëror, në këtë doracak japim një pasqyrë të shkurtër të karakteristikave kryesore të fëmijëve/personave me pengesa në zhvillimin intelektual (mental).

[23] Prof. dr. Risto Petrov, Laura Gjurçinovska, Natasha Stojanovska – Trajkovska "Mbrojtja dhe rehabilitimi i personave me invaliditet", Shkup 2008, Fakulteti Filozofik – Instituti i defektologjisë.

Çrregullimi mental paraqet gjendje të zhvillimit të ngadalshëm ose jo të plotë psikik, që veçanërisht karakterizohet me çrregullim të aftësive të cilat paraqiten gjatë periudhës zhvillimore dhe të cilat kontribuojnë drejt nivelit të përgjithshëm të inteligjencës , siç janë aftësitë konjunktive, të folurit, motorike dhe sociale.

Personat me çrregullim mental ndahen në 4 grupe dhe atë: persona me **çrregullim të lehtë, të matur, të rëndë** dhe **të thellë mental**.

- **Personat me çrregullim të lehtë mental** karakterizohen me zvogëlim të butë të nivelit të aftësive intelektuale, të folurit, motorik dhe social. Këto persona e përdorin të folurit në jetën e përditshme edhe krahas asaj se flasin me vonesë të caktuar. Sasia e tyre e inteligjencës lëvizë nga 50 deri 69.
- **Personat me çrregullim të matur mental** tregojnë zhvillim të ngadalshëm dhe arritje të kufizuara në përdorimin e të folurit dhe gjuhës, aftësive motorike dhe kujdesin për veten. Koeficienti i tyre lëvizë nga 35 deri 49.
- **Personat me çrregullim të rëndë mental** sipas fotografisë klinike, prezenca e etiologjisë organike dhe dëmtimeve shoqëruese janë të ngjashme me personat me çrregullim të matur mental. Te këta persona kemi kufizime të dukshme në arritjet në fushën e të folurit dhe gjuhës, aftësitë motorike dhe kujdesin për veten. Numri më i madh i këtyre personave kanë dëmtime të sistemit qendror nervor (CNS). Koeficienti i inteligjencës lëvizë nga 20 deri 34.
- **Personat me çrregullim të thellë mental** karakterizohen me aftësi të shprehur të kufizuar për kuptimin dhe pranimin e kërkesave ose udhëzimeve, kanë disa forma të rudimentuara të komunikimit verbal. Pjesa më e madhe prej tyre janë gjysmë të lëvizshëm ose të palëvizshëm dhe nuk mund t'i kontrollojnë nevojat fiziologjike. Këta persona nuk mund të kujdesen për veten, prandaj u nevojitet ndihmë dhe mbikëqyrje e përhershme. Koeficienti i tyre i inteligjencës është nën 20.

Fëmijët me çrregullim mental kanë nevoja të njëjta fiziologjike, sociale dhe emocionale si edhe fëmijët e tjerë. Zhvillimi i tyre i ndjek ligjshmëritë e njëjta, si dhe zhvillimi që vlen për fëmijët nga popullata e përgjithshme, por tempi i tyre është mjaft i ngadalshëm, ndërsa sipas shkallës së çrregullimit edhe kufizues.

Në disa raste, pengesat në zhvillim njihen menjëherë pas lindjes, por ndonjëherë vërehen edhe më vonë, do të thotë kur do të vërehet se fëmija nuk sillet në mënyrë të zakonshme/adekuate për moshën e tij.

Pengesat në zhvillim paraqiten në formë të[24]:

- mungesës së kontrollit motorik dhe koordinimit të dobët,
- pengesat sensorike me shkallë të ndryshme,
- zhvillimi i ngadalshëm i gjuhës dhe të folurit dhe
- dëmtime të funksioneve njohëse.

Termi dhe karakteristikat kryesore të personave me disleksi, disgrafi dhe diskalkuli

Disleksia është çrregullim që edhe krahas formës konvencionale të mësimit, nivelit adekuat të inteligjencës dhe kushteve socio-kulturore, manifestohet si vështirësi të mësohet të lexohet. Është prezent te 10% të popullatës shkollore dhe bile 30% nga studentët në sistemet e avancuara shkollore.[25]

[24] Ibid.

[25] E harmonizuar sipas http://web.jhu.edu/disabilities/faculty/types_of_disabilities/deafness.html и Kis-Glavas, L., urednik (2012), Zbirka priručnika 'Studenti s invaliditetom', Sveučilište u Zagrebu, Zagreb.

Disleksia është çrregullim specifik gjatë të mësuarit që manifestohet kryesisht si vështirësi me gjuhën e shkruar, veçanërisht me leximin dhe formimin e fjalëve. Edhe pse shkaku për disleksinë është çrregullimi neurologjik, kjo nuk është pengesë intelektuale. Disleksia paraqitet në të gjitha nivelet e inteligjencës – mesatare, mbi mesatare dhe shumë persona të talentuar. Disleksia mjaft shpesh karakterizohet me vështirësi gjatë të mësuarit si të kuptohet fjala, si të përpilohen fjalët dhe të lexohen saktë dhe rrjedhshëm. Nuk ekziston ilaç për disleksinë, por personat me disleksi mund të mësojnë të lexojnë dhe të shkruajnë me arsim dhe trajtim adekuat. Ekzistojnë hulumtime të shumta të cilat vërtetojnë se ushtrime të caktuara të specializuara fonike mund të ndihmojnë gjatë të mësuarit se si lexohet. Në SHBA-të, hulumtuesit mendojnë se dukuria e disleksisë lëvizë prej 5 – 9% te fëmijët e moshës shkollore, edhe pse disa mendojnë se numri shkon deri në 17%.[26]

Në praktikë disleksia shpesh është shoqëruar me **disgrafinë,** më saktë, i njëjti person mund të ketë vështirësi me gjuhën e shkruar dhe me numrat. Kjo pengesë/invaliditet kompleks mund të paraqesë problem të madh kur studenti duhet të lexojë, e pastaj edhe të zgjidh detyrë matematikore; studenti numrin 8 e lexon si 3 dhe rezultati përfundimtar nuk është i saktë.

Karakteristikat e disleksisë te personat e moshuar:[27]

- Vështirësi me leximin,
- Vështirësi kur lexon në zë,
- I nevojitet më gjatë të lexojë një faqe tekst se sa të tjerët,
- Humbet rresht ose lexohet përsëri i njëjti rresht,
- Vështirësi të kuptohet ajo që lexohet,
- Lexon përsëri që të kuptojë,
- Vështirësi gjatë leximit dhe kuptimit të renditjes,
- Probleme gjatë mbajtjes së shënimeve,
- Mungesë e kohës gjatë shkrimit të eseve, provimeve, etj.,
- Lëshimi i shkronjave, një pjesë të fjalëve ose fjalë të tëra kur shkruan, ndërsa fjalitë e shkruara janë të parregullta dhe gramatikisht të gabuara, shkrimi është i palexueshëm,
- Vështirësi në shprehjen e ideve gjatë shkrimit,
- Shumë gabime gjatë të shkruarit – shqiptimit dhe vështirësi që vetë ta ndreq gabimin,
- Vështirësi gjatë planifikimit dhe strukturës së detyrave me shkrim, e anulon shkrimin e këtyre detyrave deri në momentin e fundit,
- Mossukses në shkrimin ne provimeve me shkrim, si dhe plotësimi i formularëve ose përgjigja e pyetjeve në formular të specializuar,
- Pasiguri gjatë caktimit majtas/djathtas dhe nuk ka orientim në hartën gjeografike,
- Vështirësi me të folurit para publikut,
- Probleme me plotësimin e detyrave në një afat të caktuar kohor, në parim këto persona kanë probleme me të mbajturit mend të datës, respektimi i kohës dhe renditjes së aktiviteteve,
- Pamundësi të përgjigjet shpejt.

Termi dhe karakteristikat kryesore të personave/studentëve me autizëm[28]

Autizmi është një nga çrregullimet më të rënda, që paraqitet që në fëmijërinë e hershme, e kërcënon zhvillimin normal të fëmijës dhe aftësimin e tij të mëvonshëm për jetë të pavarur. Numri më i madh i fëmijëve/personave me autizëm nuk mund të inkuadrohen në mjedisin e hapur social dhe në lojën dhe mësimin me moshatarët e vet. Vetë fjala autizëm barazohet me termin sportiv AUT që do të thotë

[26] http://www.disabled-world.com/artman/publish/article_2130.shtml.
[27] Glavas, L., urednik (2012), Zbirka priručnika 'Studenti s invaliditetom', Sveučilište u Zagrebu, Zagreb.
[28] Prof. dr. Risto Petrov, Laura Gjurçinovska, Natasha Stojanovska – Trajkovska "Mbrojtja dhe rehabilitimi i personave me invaliditet", Shkup 2008, Fakulteti Filozofik – Instituti i defektologjisë.

jashtë lojës, jashtë nga ndodhitë rreth vetes, lidhja e ndërprerë me realitetin. Te fëmija me autizëm punohet për çrregullim psikik, që zakonisht nuk ka periudhë të zhvillimit normal (autizmi primar) ose çrregullimi që paraqitet gjatë vitit të dytë – të tretë (autizmi sekondar). Në çdo rast problemi evidentohet deri në moshën tre vjeçare, ngadalë dhe pothuaj në mënyrë të pavërejtur.

Për dallim nga autizmi tipik ekziston i ashtuquajturi autizëm i cili dallohet lidhur me moshën kur paraqitet (për herë të parë mund të paraqitet edhe pas vitit të tretë), çrregullimi patologjik nuk duhet patjetër të paraqitet në të gjitha tri nivelet – inteligjenca, të folurit dhe zhvillimi emocional – e më shpesh paraqitet te personat me pengesa të vështira intelektuale dhe te personat të cilët shprehin çrregullime të vështira zhvillimore në të folurit receptiv.

Te fëmijët/personat me autizëm janë prezent ndryshime të caktuara[29]:

- jeta emocionale paraqitet ngadalë ose nuk zhvillohet. Emocionet nuk janë ne gjendje të integrohen me përjetimin e plotë me realitetin dhe ato nuk mund të strukturoren sipas renditjes kohore;
- fëmija mezi ose aspak nuk e vëren realitetin, ndërsa në jetën e tij dimensioni për hapësirën dhe kohën sikur të mos ekzistojnë aspak;
- nëse autizmi paraqitet herët, atëherë të folurit nuk zhvillohet, por nëse ai tashmë është zhvilluar tregon tendencë të ngadalësimit ose humbjes. Ai nuk i shërben personit për komunikim me mjedisin;
- zhvillimi intelektual rregullisht pëson ndryshime serioze, veçanërisht te fëmijët/personat ku autizmi paraqitet herët, ndërsa fëmijët të cilët kanë arritur shkallë të caktuar të zhvillimit intelektual funksionojnë nën atë nivel, për shkak të pamundësisë së përgjithshme që fëmija me autizëm ta shfrytëzojë kapacitetin e tij për të njohur;
- perceptimet, veçanërisht ato të dëgjimit, janë ngadalësuar për shkak të njohjes së keqe, modulimit dhe integrimit të ndjenjave sensorike, e kështu fëmijët japin përshtypje se janë të shurdhër;
- loja e fëmijës/personit me autizëm është më e thjeshtë, pa përmbajtje dhe fantazi, e zbrazët dhe stereotipa. Ajo/ai tregon tendencë që t'i përmbajë rrethanat e njëjta (hapësirë, persona, sende) dhe çdo ndryshim i tyre shkakton frikë, shqetësim dhe agresivitet;
- personat me autizëm kanë perceptim të keq të realitetit dhe përjetimi i tij i keq emocional;
- për shkak të çrregullimit të dimensioneve hapësirë dhe kohë, është çrregulluar vetëdija për vete (pyetet çfarë/kush është ky?);
- në vend të zhvillohen raporte të ngrohta me prindërit, kryesisht janë angazhuar për sjellje vetë-stimuluese (lëvizja e trupit, lëkundja e kokës etj.);
- aspak nuk i interesojnë fëmijët të cilët luajnë afër tyre. Fëmija me autizëm është tërësisht i mbyllur në vete.

Edhe pse më herët mendohej se nuk mund të jepet diagnoza para vitit të tretë nga jeta sot dihet se disa karakteristika të cilat paraqiten te këta persona mund të flasin për autizmi që në moshën më të hershme. Kështu shembuj të tillë janë:

- mungesa e të qeshurit dhe gëzimit ndaj nënës në muajt e parë nga jeta;
- mungesa e reagimit të aftësimit;
- fëmija nuk e jep dorën dhe nuk shpreh gëzim kur merret në përqafim;
- mungesa e kujdesit të përbashkët, fëmija nuk reagon kur i tregohen lodrat ose sende interesante, gjegjësisht reagon me kthimin e shikimit në drejtim tjetër;
- nuk i përgjigjet thirrjes;
- nuk i përgjigjet pyetjes;
- sillet sikur është i shurdhër;
- nuk inkuadrohet në lojë.

[29] Trajkovski, B., 2004: "Autizmi", Fakulteti Filozofik, Instituti për defektologji, Shkup.

1) Sindromi Asperger[30, 31]

Ndaj Sindromit Asperger shihet ose si ndaj një forme më të butë të autizmit ose klasifikohet me gjendje e veçantë, por padyshim është pjesë e spektrit autist të çrregullimeve. Shenjat karakteristike të sjelljeve përfshijnë:

- Dëmtim që vërehet dhe i pandërprerë në interaksionin social;
- Skema restriktive dhe përsëritëse të sjelljes dhe preferenca e fuqishme e rutinës, si dhe shmangja ndaj ndryshimeve;
- Ngadalësime në zhvillimin motorik dhe plogështi.

Megjithatë, në krahasim me autizmin, individët me sindromin Asperger kanë gjuhë relativisht të mirë shprehëse dhe mund të kenë rezultatet konjunktive, të cilat bien në mesatare ose mbi mesataren, ndërsa rrallë kanë vështirësi plotësuese gjatë të mësuarit. Si rezultat i kësaj diagnoza mund të anulohet deri në momentin derisa lidhjet sociale dhe interaksioni nuk bëhen evidente. Mu për këtë, diagnoza zakonisht nuk është e mundur deri në moshën pesë vjeçare.

2) Spektri autisit

Koncepti i spektrit artist e cakton numrin e madh të simptomave të cilët individi mund t'i provojë. Nga njëra anë, disa fëmijë kërkojnë shumë kujdes të specializuar dhe mbikëqyrje që sigurisht do të vazhdojë edhe gjatë jetës madhore. Nga ana tjetër, si ekstremitet tjetër, ka fëmijë të cilët mund të inkuadrohen me sukses në shkollat e rregullta, bile edhe të arrijnë deri te arsimi sipëror. Ky fakt e potencon rëndësinë e vlerësimit individual dhe planifikimin e intervenimit, si dhe nevojën nga shmangia e bërjes së supozimeve ose përgjithësimeve lidhur me sjelljet, shkathtësitë dhe prognozat e individëve të cilët kanë diagnozë të Autizmit ose sindromit Asperger.

3) Çrregullimi hiper aktiv me deficit të kujdesit (Attention deficit hyperactivity disorder – ADHD)

Çrregullimi hiper aktiv me deficit të kujdesit (ADHD) paraqet një nga çrregullimet më të shpeshta në moshën fëmijërore, që shpesh mund të vazhdojë edhe në adoleshencë dhe moshën madhore. Personat me ADHF i shohim si persona me shkallë jo adekuate të zhvilluar të kujdesit, aktivitet shumë i madh dhe impulsivitet që krijon sjellje të vetëdijesuar, planifikim dhe organizim. Personat me ADHD kanë probleme me organizimin e kohës, shpesh vonohen gjatë kryerjes së detyrave, nevojitet të zgjedhin punë më dinamike dhe shpesh e ndërrojnë punën. Në botë, në suaza të studimeve deri në diplomim dhe pas diplomimit, 15% të studentëve janë me ADHD[32].

Ekzistojnë 3 lloje themelore të ADHD[33]:

- Deficit i vëmendjes/çrregullimi hiper aktiv, lloj i kombinuar – nëse ekzistojnë 6 ose më shumë simptoma të pakujdesisë dhe 6 ose më shumë simptoma të hiper aktivitetit,
- Deficit i vëmendjes/çrregullimi hiper aktiv, me pakujdesi dominuese – 6 ose më shumë simptoma të pakujdesisë dhe më pak se 6 simptoma të hiper aktivitetit,

[30] Trajkovski, V., 2011: "Autizmi dhe çrregullimet zhvillimore", Fakulteti Filozofik, Instituti për defektologji, Shkup.
[31] Lidhja e defektologëve të Republikës së Maqedonisë, "Si deri te komuna inkluzive?" – Doracak për të punësuarit në njësitë e vetëqeverisjes lokale, Shkup 2012.
[32] E përshtatur sipas: Glavas, L., urednik (2012), Zbirka priručnika 'Studenti s invaliditetom', Sveučilište u Zagrebu, Zagreb, fq. 174
[33] ibid, fq. 270- 306.

- Deficit i vëmendjes/çrregullim hiper aktiv, me tip dominues hiper aktiv-impulsiv – 6 ose më shumë simptoma të hiper aktivitetit dhe më pak se 6 simptoma të pakujdesisë.

Karakteristikat e personave me ADHD të diagnostifikuar mund të përfshijnë, por jo edhe të kufizohen në këto që vijojnë:[34]

- Paaftësi që të përqendrohet në detyrën;
- Lehtë i tërhiqet vëmendja;
- Manipulon keq me kohën;
- Vështirësi në përgatitjen e detyrave të shkollës, të vijë në takim të caktuar paraprakisht, të vijë në orë në kohë;
- Vështirësi në të kuptuarit e asaj që e lexon;
- Vështirësi me probleme matematikore ku nevojitet ndryshimi i aktivitetit, operacionit dhe renditjes;
- Pamundësia të dëgjojë në mënyrë seleksionuese gjatë orës, që sjell deri te problemi me kapjen e shënimeve;
- Nuk ka organizim në punë, veçanërisht punimi me shkrim dhe pyetjet e shtruara;
- Vështirësi të ndjek udhëzime, të dëgjojë dhe të përqendrohet;
- Në mënyrë impulsive i jep përgjigjet;
- Ka shkrim të dobët.

Termi dhe karakteristikat e personave me pengesa të kombinuara në zhvillim

Sipas nenit 12 nga rregullorja për vlerësim të nevojave specifike të personave me pengesa në zhvillimin psikik ose fizik, personi me më shumë lloje të pengesave – me pengesa të kombinuara në zhvillim llogaritet personi te i cili janë prezent dy ose më shumë pengesa në zhvillim të cekura në këtë Rregullore. Dëmtim të shumëfishtë mund ta quajmë atë dëmtim[35] që me kombinimin e tij sjell deri te deviacioni radikal të fushës sociale të personalitetit shumëfishtë të dëmtuar dhe si i tillë kërkon trajtim të aftësuar cilësor lidhur me vetë dëmtimin primar. Këta persona mund të ndahen në katër grupe:

- persona me dëmtime të shumëfishta me retardim dominues;
- dëmtim i shumëfishtë me dëmtim dominues të dëgjimit;
- dëmtim i shumëfishtë me dëmtim dominues të shikimit;
- dëmtim i shumëfishtë me dëmtim dominues trupor;
- dëmtim i shumëfishtë me dominim të pacaktuar.

[34] http://web.jhu.edu/disabilities/faculty/types_of_disabilities/adhd.html.

[35] Prof. dr. Risto Petrov, Laura Gjurqinovska, Natasha Stanojkovska – Trajkovska "Mbrojtja dhe rehabilitimi i personave me invaliditet", Shkup 2008, Fakulteti Filozofik – Instituti për defektologji.

Kapitulli 3:

Cila është qasja e drejtë? Bontoni ndaj personave me invaliditet: Etika në arsimin e studentëve me invaliditet [36]

Autorë: Daniella Stojanovska – Xhingovska[37], Ivana Biliq[38]

Prej Juve, si profesorë, punëtorë pedagogjik, veçanërisht nga Ju të cilët keni përvojë shumëvjeçare pune, para së gjithash, pritet të jeni njerëz në kuptimin e vërtetë të fjalës. Njerëz, duke analizuat thellë në vete, i absorboni dhe i tejkaloni paragjykimet, stereotipat dhe sjelljet stereotipi ndaj të gjitha TË NDRYSHMET DHE TË VEÇANTAVE. Duke u nisur nga ngjyra e lëkurës, racës, religjionit, orientimit seksual, DUKE PËRSHIRË EDHE HANDIKAPIN.

Aq më shumë, të liruar nga paragjykime të tilla, pritet që studentëve të vet t'u ofrojnë maksimumin e tyre, me qëllim që t'ua përcillni diturinë dhe përvojën e vet, por edhe nga ata të bëni në numër sa më të madh NJERËZ, PERSONALITETE NË KUPTIMIN E VËRTETË TË FJALËS.

Megjithatë, në këtë doracak do të guxojmë T'ju pyesim:

- **Në praktikën e deritanishme Tuaj, keni takuar person me cilindo lloj dhe shkallë të lartpërmendura të handikapit?**
- **Në praktikën Tuaj të deritanishme, keni pasur fat të takoheni ose të keni student me cilindo nga llojet dhe shkallët e lartpërmendura të handikapit?**
- **Nëse në praktikën Tuaj të deritanishme, keni pasur fat dhe nder të punoni me student, i cili ka ndonjë nga llojet dhe shkallët e lartpërmendur të handikapit, nëse Ju është dashur ndihmë plotësuese dhe informatë që t'i ndihmoni studentit?**

Qëllimi i këtij doracaku është t'u jap përgjigje çështjeve më të rëndësishme të atyre të cilët janë "kushtimisht pa" ndonjë invaliditet, për atë se si duhet të jetë qasja ndaj atyre personave të cilët kanë ndonjë invaliditet. Kjo pasqyrë e shkurtër për llojet e ndryshme të invaliditetit/pengesës ka për qëllim, që ta njohim kuadrin mësimor dhe jo mësimor në fakultetet me këto gjendje/çrregullime specifike dhe t'u ndihmojë në të ardhmen, ata më mirë t'i kuptojnë studentët me pengesa të ndryshme gjatë studimit të tyre. Gjithashtu këtë material mund ta shfrytëzojnë edhe të gjithë të interesuarit, miqtë e tyre, familjet, kolegët, punëdhënësit etj.[39]

- Ekzistojnë disa gjëra/imtësia të vogla të cilave duhet t'i kushtohet vëmendje, me qëllim të komunikimit të ndërsjellë student – profesor, që komunikimi të jetë më i lehtë dhe më i lirë.

[36] Në pajtim me Kushtetutën e R. Maqedonisë, përdoret termi "invaliditet". Megjithatë, duke i marrë parasysh sugjerimet nga ekspertët dhe vetë personat me handikap, në këtë publikim në mënyrë të barabartë do të përdoren termet "pengesa" dhe "handikap". Sqarimi për arsyetimin në këtë periudhë është përpunuar më hollësisht në kapitullin 1: Hyrje në këtë publikim. (Vërejtje e redaktorëve)

[37] Daniella Stojanovska – Xhingovska, V. Sc. E defektologjisë, kryetare e Shoqatës së studentëve dhe të rinjve me handikap – Shkup, Maqedoni, e-mail: stojanovskad@gmail.com.

[38] Dr. Ivana Biliq, D.Sc. e Ekonomisë, është docente pranë fakultetit Ekonomik, Universiteti në Split, e-mail: ibilic@efst.hr, ivanab13@yahoo.com.

[39] Broshura "Bonton" Shoqata e studentëve dhe të rinjve me handikap - Shkup, botimi maqedonas (versioni hard-copy) dhe Shoqata e studentëve dhe të rinjve – Serbi "Bonton" - (hard-copy i versioni serb) dhe internet botimi në http://www.ush.rs/lat/izdavastvo.html, www.iskra.org.rs/biblioteka_files/bonton.pdf.

- Drejtimi ndaj personave me handikap nuk është i vështirë, nuk dhemb dhe nuk kërkon shumë punë, si dhe nuk paraqet mund të veçantë.
- Megjithatë, frika nga e panjohura, paragjykimet, mos informimi ose qëndrimi mbrojtës dhe kujdesi ndaj këtyre personave shpesh nuk e mundëson komunikimin e drejt me këta studentë. Për shkak të qasjes së gabuar ndaj këtyre studentëve/personave në përgjithësi, kujdesi i tepruar ndaj tyre, shpesh sjell deri te dhënia e dhunshme e ndihmës dhe mbështetjes në momentin kur mbështetja nuk nevojitet dhe në mënyrë që ndonjëherë bile edhe mund ta lëndojë personin me handikap.
- Sjellja ndaj studentëve/personave me handikap duhet të jetë shumë normale dhe ata duhet të trajtohen si të barabartë me të gjithë personat/studentët tjerë, sepse me të vërtetë, ata edhe kështu janë, bashkëqytetarë të barabartë!!! **Handikapi nuk është sëmundje, por vetëm gjendje**.
- Gjatë takimit të parë me student me handikap, nuk duhet të shprehet keqardhje në qasje dhe komunikimi dhe gjatë drejtimit nuk duhet të përdoren terme në diminutiv nga tipi "shpirt", "zemër", "flori", bile edhe përdorimi në diminutiv te emrat personal Zharko-Zharçe, Iskra-Iskriçe, Daniella-Daniellçe, etj.
- Në situatë kur mendojmë se studentit me handikap i nevojitet ndihmë, gjithnjë duhet të pyetet studenti nëse ajo me të vërtetë i nevojitet dhe në cilën mënyrë më së miri t'i ndihmohet.
- Drejtimi duhet të orientohet në mënyrë të drejtpërdrejtë ndaj studentit me handikap, e jo ndaj prindit të tij, partnerit, mikut, komentuesit ose asistentit personal. Nuk duhet të praktikohet zhvillimi i bisedës në kabinetin e profesorit vetë me prindin, kujdestarin ose asistentin personal për obligimet e studentit lidhur e fakultetin, derisa studenti me handikap pret në korridor.
- Nuk duhet të ketë ngurrim për përdorimin e termeve nga tipi "Shihemi!", "Të përshëndes dhe vrapoj tutje!", "Dëgjohemi!", pa marrë parasysh për çfarë tipi të handikapit bëhet fjalë te personi, me të cilin zhvillohet biseda dhe aspak nuk duhet të ketë frikë dhe të jetë e pa këndshme nga përdorimi i cilësdo frazë të njëjtë ose të ngjashme.
- Gjatë të folurit ose drejtimit ndaj personit me handikap, nuk duhet të përdoret termi shpesh i përdorur "INVALID". Rrënja, prejardhja e kësaj fjale vjen nga fjala latine "INVALIDUS", që do të thotë jo valid, i lënduar, i pafuqishëm, i dobët. Përdorimi i kësaj fjale sjell deri te ajo që mjedisi social të krijojë atmosferë që e konteston çdo aftësi të studentit/personit me handikap, ndërsa në mënyrë plotësuese përkujton në keqardhje.
- Numër i madh i personave me handikap si fjalë ofenduese e llogarisin edhe shprehjen persona me nevoja të veçanta. Ky term përdoret për gjithë popullatën, të gjithë kanë nevoja të tyre të veçanta në jetën e përditshme, pa marrë parasysh faktin nëse kanë handikap ose jo. Çdo njeri ka nevojë për lëvizje dhe nga një vend të arrijë në vend tjetër. Dikush do shkojë ngadalë dikush më shpejtë, dikush do ta ngasë biçikletën, dikush do ta drejtoj automjetin, ndërsa dikush në karrocë invalidore ose me shkopinj si vegla dhe me ato do të lëvizë. **Të gjithë ne kemi nevoja të njëjta vetëm mënyra e plotësimit të atyre nevojave është e ndryshme.**
- Gjithnjë duhet të përdoren fjalë forma e të cilave na përkujton në aktivitete p.sh. ajo/ai është shfrytëzues i karrocës invalidore, e jo ajo/ai është njeri në karrocë ose i gozhduar për karrocë.
- Personit me lloj të caktuar të invaliditetit, nuk duhet t'i shtrohen pyetje indiskrete lidhur me handikapin e tij, përveç nëse me atë person nuk ekziston ndonjë relacion i afërt dhe i njëjti në mënyrë të pavarur e ka iniciuar atë bisedë.
- Nevojitet të jesh i duruar dhe të merret parasysh se studentit me handikap ndoshta i nevojitet më shumë kohë që të bëjë diçka, të zgjidh ndonjë detyrë ose t'i përgjigjet pjesës me shkrim nga provimi. Në pajtim me këtë, studentit me handikap gjithnjë duhet t'i sigurohet koha e nevojshme e domosdoshme. (Kjo ka të bëjë pothuaj me të gjitha llojet e handikapit).

- Nuk është e përshtatshme që personi me handikap të lavdërohet tepër për aktivitetet e kryera të përditshme.
- Asnjëherë nuk duhet të lejohet që handikapi të ketë çfarëdo ndikimi mbi formimin e vlerësimit te studenti me handikap, do të thotë sa është e mundur më shumë, nevojitet vlerësim të përputhet me njohurinë reale dhe kapacitetin e studentit.
- Vetëm nëse nga personi me handikap në mënyrë të sjellshme jeni lutur t'i pranoni mjetet e tija (shkopinjtë, shkopin ose karrocën invalidore) për t'i ndihmuar, bëjeni këtë, në të kundërtën mos e bëni. Mos u mbështetni në karrocën invalidore sepse ajo është pjesë e hapësirës personale të atij që e përdor. Lini hapësirë të mjaftueshme për kalim për personin që përdor çfarëdo mjeti.
- Nëse në fakultet/universitet ku studion studenti me handikap nuk ekziston parking i shënuar, nevojitet të bisedoni me personat përkatës, me qëllim të sigurohet shënimi i të paktën një vend parkimi dhe i njëjti gjithnjë duhet të jetë i lirë për t'u përdorur nga personi për të cilin është dedikuar.

Kontakti i parë me person/student me të dëgjuarit e dëmtuar

Më poshtë janë vendosur disa përshtatje të cilat mund të jenë të dobishme dhe do të ndihmonin që personat me të dëgjuarit e dëmtuar të marrin diplomë universitare, siç janë:

- Në realizimin e programit mësimor së pari profesori duhet të kujdeset për gjetjen e vendit të përshtatshëm për t'u ulur në klasë për studentin me të dëgjuarit e dëmtuar që të mund ta lexojë fjalën e tij nga goja.
- Studenti/studentja duhet të ulet në vendin prej ku ka pamje të mirë të ligjëruesit, komentuesit dhe tabelës, si dhe pamje të lirë ndaj personit dhe gojës së ligjëruesit.
- Metodat më të shpeshta mësimore të cilat duhet të përdoren gjatë ligjërimit të përmbajtjeve mësimore janë: metoda e demonstrimit, të treguarit dhe vëzhgimi, ku veçanërisht theks duhet t'i vihet termeve dhe dukurive, të cilat janë abstrakte, përdorni sa më shumë vegla vizuale.
- Në organizimin e mësimit është e domosdoshme që profesori të ndajë pak kohë pas orëve ose në terminët për konsultime për qasje individuale ndaj studentëve dhe sqarimi plotësues për përmbajtjet e paqarta mësimore.
- Plotësime të ligjëratave me gojë, detyrave dhe udhëzimeve të dhëna në formë të shkruar. Është e dëshiruar që të njëjtat të jepen paraprakisht, si studenti të mund të përqendrohet në ndjekjen e komentuesit se sa në të njëjtën kohë të lexojë ose ta kopjojë materialin e tij.
- Veglat vizuale, gjithnjë kur kjo është e mundur, duke përfshirë edhe versionet me tekst nga videoja ose filmi.
- Shfrytëzimi i reflektorit të vogël që të mund të shihet komentuesi gjatë projeksionit të filmit ose sllajdeve.
- Përsëritja është një nga mënyrat themelore për vërtetimin e njohurive të fituara te studentët me të dëgjuarit e dëmtuar.
- Përsëritja e pyetjeve dhe komenteve nga studentët tjerë.
- Qasja dhe ekspozimi në etapa të përmbajtjeve të reja mësimore është metodë për sundimin e përmbajtjeve.
- Ligjërata e profesorit gjithnjë duhet të jetë e shkurtër, e qartë, koncize me terme paraprakisht të njohura për studentin. Nëse profesori përdor terme të reja të panjohura, është e domosdoshme të vijojë sqarimi me terme konkrete, bile edhe përdorimi i veglave vizuale.

Profesori gjithnjë duhet të jetë i kthyer me fytyrë drejt studentit me të dëgjuarit e dëmtuar, që ai të mund ti sheh dhe të lexojë nga buzët e tija. Të folurit të jetë me intensitet normal (të mos flasë shumë me zë ose bile edhe të mos bërtas për studentin që të dëgjojë ose mos t'i flas drejtpërdrejt në vesh, duke menduar se ashtu do ta dëgjojë dhe kuptojë më mirë) dhe shpejtësia e të folurit të jetë normal (të mos flasë shpejt që të mund të kuptohet).

- Kur profesori ligjëron ndonjë përmbajtje mësimore është e domosdoshme që çdo gjë që flet ta shkruajë në tabelë ose më mirë për çdo përmbajtje mësimore për momentin kur ligjëron, të ketë të përgatitur prezantim në PowerPoint ose material në formë elektronike ose version të shtypur.
- Nëse studenti Ju drejtohet me pyetje, dëgjoni me vëmendje, përqendroheni dhe përpiquni ta kuptoni (pasiqë për personat me të dëgjuarit e dëmtuar, shpesh edhe kur kanë të folurit e kuptueshëm dhe solid, ekzistojnë fjalë të cilat vështirë kuptohen), patjetër kërkoni nga studenti t'ua përsërisë atë që Ju nuk e keni kuptuar, por kurrsesi mos aktroni se edhe pas përsëritjes e keni kuptuar, nëse nuk e keni kuptuar më mirë jepni t'ua shkruajë atë që nuk e keni kuptuar.
- Mos u përpiqni që Ju në vend të personit ta përfundoni fjalinë sipas supozimit tuaj se e dini çfarë dëshiron të thotë.
- Caktimi dhe vërtetimi i diturisë duhet të shkojë ose (1) me anë të mënyrës gojore, nëse studenti edhe krahas dëmtimit të dëgjuarit, me përdorimin e amplifikatorit për dëgjim (aparatit) flet mirë dhe nuk ndjehet inferior gjatë të folurit, ose (2) nëse profesori vërteton se studenti për shkak të dëmtimit të dëgjimit në mënyrë adekuate nuk mund t'i përgjigjet programit mësimor, provimi mund të realizohet me anë formës së shkruar me teste të përgatitura paraprakisht nga ana e profesorit, në pajtim me mundësitë e studentit. Në çdo rast (tjetër), testet edhe për këtë student duhet të jenë identike me testet për studentët tjerë.
- Përshtatja lidhur me testin mund të përfshijë: qasje deri te aplikacioni kompjuterik për përpunimin e tekstit (word processor), përdorimi i komentuesit për udhëzimet.
- Të sigurohet sqarimi i fjalëve të panjohura në formë të shkruar, në tabelë ose në formë të shtypur.
- Të shfrytëzohet e-posta, faksi ose aplikacioni kompjuterik për përpunimin e tekstit gjatë konsultimeve me profesorin.
- Sistemi vizual i paralajmërimit gjatë rasteve urgjente në vetë ndërtesën.
- Transkpriti simultan (real-time) ku arsimtari përdor mikrofon, ndërsa transkripti i tekstit shkon në ekranin kompjuterik të studentit.
- Aplikacioni për mbajtjen e shënimeve gjatë ligjëratave, që do t'i ndihmonin studentit ta ndjek komentuesin.
- Nëse studenti është me dëmtim të plotë të dëgjuarit, mbështetja e parë që profesori mund t'ia japë studentit (nëse nuk e njeh gjuhën e shenjave) është në komunikimin e ndërsjellë të shkëmbejnë letra, ku njëri shton pyetje, ndërsa tjetri përgjigjet dhe anasjelltas.
- Nëse institucioni arsimor nuk ka siguruar komentues në gjuhën e shenjave, është e domosdoshme në komunikimin me studentin që profesorit lejojë prezencën e një anëtari të familjes, i cili e njeh gjuhën e shenjave dhe i cili do ta komentojë të folurit e studentit.
- Nëse në grupin e njëjtë të studimeve ka student i cili e kupton ose e flet gjuhën e shenjave, në fillim, profesori mund ta shfrytëzojë njohurinë e tij. Nëse bëhet fjalë për dhënien e provimit, ndërsa personi për shkak të ndonjë shkaku objektiv nuk ka mundur ta realizojë të drejtën e komentuesit të autorizuar në gjuhën e shenjave, duhet ta marrë parasysh njohurinë e studentit me handikap, pa dyshuar aspak në besueshmërinë e përgjigjes së studentit me të dëgjuar të dëmtuar. Për komentimin, studenti nga profesori mund të fitojë shpërblim prej disa kredive studentore.

- Gjithsesi, është e domosdoshme, më e drejt, më adekuate dhe ligjore që profesori dhe studenti të angazhohen për prezencë të komentuesit të autorizuar në gjuhën e shenjave në procesin e përcjelljes së mësimit dhe provimeve ose defektologut që e njeh gjuhën e shenjave. (Shpenzimet për angazhimin e tij i mbulon Ministria e Punës dhe Politikës Sociale përmes Lidhjes së personave të shurdhër dhe gjysmë të shurdhër të RM, në mënyrë më të hollësishme do të sqarohet në kapitullin 5).

Në fund të këtij nëntitulli, të përkujtohemi në disa personalitete shumë të suksesshme të shurdhra:[40] **Francisko Goja** (**Francisco Goya**) (piktor spanjoll); **Miha Zupan** (**Miha Zupan)** (basketbollist slloven), **Tomas Alva Edison (Thomas Alva Edison)** (shpikës amerikan); **Ludvig Van Betoven (Ludwig Van Beethoven) (**kompozitor dhe realizues**); Keler (Keller)** (autor, aktivist dhe ligjërues) dhe shumë të tjerë.

Kontakti i parë me person/student me të parët e dëmtuar

Më e rëndësishmja nga të gjitha, gjatë kontaktit të parë me student me të parët e dëmtuar, profesori të prezantohet qartë, kush është, çfarë ligjëron, kur dhe ku do të mbahen ligjëratat dhe konsultimet e tija, në ora sa, në cilën klasë etj.

- Lajmërimi i mëparshëm për orarin dhe/ose ndryshimin e klasës.
- Nëse është e nevojshme, prezantohuni në fillim të bisedës dhe lajmëroni studentin/studenten kur dilni nga ambienti.
- Sinjalet joverbale varen nga perceptimi i mirë vizual. Momentet kyçe verbalist të theksuara gjatë bisedës e lehtësojnë komunikimin.
- Studenti mund të përdor qen-ndihmës[41] ose shkop të bardhë si ndihmë gjatë lëvizjes. Qeni-ndihmës është kafshë pune dhe nuk duhet të llogaritet si shtëpiake.
- Kur udhëhiqni ose ecni afër studentit, në mënyrë verbale jepjani bërrylin tuaj në vend që ta kapni bërrylin e tij/saj.
- Nëse studenti është me dëmtim të pjesshëm të parët (me të parët e dobët), profesori duhet të gjejë vend në klasë, përpara, përballë tij, për ndjekjen adekuate të mësimit.
- Nëse studenti është me dëmtim të plotë të parët, theks i veçantë duhet t'i kushtohet orientimit në hapësirë, t'ia japë dorën dhe ta pyesë se si e ka më mirë të ecë, në çift ose bashkë.
- Gjatë njohjes së parë me hapësirën në klasë/zyrë, nevojitet që me lëvizje të ngadalshme, studentit t'i tregohet hapësira, duke i prekur sendet në atë, dhe e gjithë kjo të përcillet me sqarim, p.sh. "kjo gjendet nga ana jote e majtë" etj. (kjo ka të bëjë edhe me studentët me të parët e rëndë). Me këtë në mënyrë plotësuese stimulohet aktiviteti fizik te këta studentë, pasiqë për shkak të mungesës së perceptimit vizual aktiviteti i këtillë është mjaft i zvogëluar.
- Sundimi i hapësirës dhe orientimi në atë nuk është proces afatshkurtër, prandaj, në mungesë të asistentit personal, mund të angazhohet një student nga grupi, të punojë me atë, ndërsa studenti i angazhuar mund të shpërblehet me disa kredi studentore. E njëjta ka të bëjë edhe në periudhën derisa ky student nuk angazhon asistent personal të autorizuar, të cilin do ta ketë edhe asistent për në laboratori.
- Gjatë përpunimit të përmbajtjeve mësimore, sa është e mundur më shumë të praktikohen veglat auditive dhe taktile për studentin, sa është e mundur në mënyrë taktile më shumë ta observojnë sendin ose materien konkrete, që është objekt i përpunimit për atë njësi mësimore.

[40] http://www.disabled-world.com/artman/publish/famous-deaf.shtml

[41] Në R. Maqedonisë, për shkak të një sërë shkaqesh me natyrë objektive dhe subjektive, duke përfshirë edhe definimin e pamjaftueshëm në legjislacionin, shfrytëzimi i qenit-ndihmës ende nuk përdoret në masë të madhe ose pothuaj aspak.

- Leximi me zë i materialeve nga prezantimet, tabela ose në formë të shtypur.
- Përshkrimi verbal i aktiviteteve të orës, për shembull, kur arsimtari kërkoi të ngrihet dora, të theksojë sa duar janë ngritur.
- Teknologjitë asistive të cilat përdoren nga studenti me pengesa në të parët:[42]
    - Magnetofoni, laptop kompjuteri ose tablet dhe stajlus lapsi për mbajtjen e shënimeve;
    - Lexuesi i ekranit dhe aparati për zë – mundëson që studenti/studentja ta dëgjojnë informatën nga ekrani ose dokumenti;
    - Fletoret elektronike – laptop special të cilët informatën e shkruar e transformojnë në të zëshme;
    - Programe për rritjen e përmbajtjes së ekranit dhe thjerrëzat (aparate për zmadhim).
- Pas përpunimit të përmbajtjes mësimore për personat me dëmtim të plotë të parët, është e domosdoshme që profesori të ketë version elektronik nga ligjërata, pasiqë ata për të mësuar përdorin kompjuter personal me LEXUES TË FOLURIT NGA EKRANI të instaluar në gjuhën maqedonase/kroate ose gjuhë tjetër ose UNREADER tjetër. Për personat me të parët e dobët, material i përgatitur me font të madh të shkronjave dhe temat e dhëna me shkronja të shtypit më të mëdha, përshtatja e kompjuterit në pikëpamje të fontit të zmadhuar, sintetizatorit për të folur dhe printer të alfabetit të Brajit.
- Format alternativ të testeve, si për shembull, të incizuara në trakë, fonti më i madh ose alfabeti i Brajit, përdorimi i lexuesve, formë e shkruar, përgjigje të incizuara në trakë, koha e vazhduar, llogaritës personal i adaptuar ose TV kanal i mbyllur.
- Rekomandohet të pyetet studenti se cili font i shkronjave i përgjigjet shkallës së tij të dëmtimit (të parët e dobët si e vetme ka variacione).
- Krijimi i mëparshëm i planeve dhe programeve mësimore si do të mundësohej kohë e mjaftueshme për transferimin e të njëjtave në formate alternative.
- Rekomandohet sugjerimi dhe inicimi i procedurës në universitetin adekuat, çdo grupi të studimeve në fakultetet e ndryshme, në bibliotekë të kenë të paktën një kompjuter me program të instaluar me zë – lexues të folurit nga ekrani në gjuhën maqedonase.
- Në konsultim me studentin me dëmtim të pjesshëm të parët, nëse ekzistojnë kushte për këtë, nevojitet të furnizohen thjerrëza si ndihmesë në mësim, që në pajtim me sugjerimet e studentit do të jetë më e volitshme dhe më aplikative për shkallën e tij të dëmtimit.
- Të përdoren shkronja të zeza në letrën e bardhë ose të verdhë që të arrihet kontrasti maksimal.
- Kontrolli dhe vërtetimi i diturisë në provimet ose në orët praktike më herët realizoheshin vetëm me gojë. Me avancimin teknologjisë kompjuterike, personave me dëmtim të plotë të parët tani u është mundësuar pa kurrfarë problemi të përgjigjen në teste, qoftë të bëhet fjalë për detyra ose për teori. Rekomandojmë që llogaritësi personal gjithnjë të përdoret si formë alternative për të shkruar.
- Personat me të parët e dëmtuar ose pengesë në të parët të mos privohen nga provimi me shkrim. Nevojitet që vetëm t'u jepet kohë për përgjigje e testit. Duhet t'i kushtohet vëmendje studentëve me të parët e dobët, të cilët shpesh kanë të folurit e varfër dhe nga disa persona të verbër, e lidhur me këtë, ata duhet të stimulohen që ta japin provimin me gojë.
- Për shkak të vëllimit të provimit dhe pamundësisë që ky student në afatin e caktuar ta lexojë gjithë materialin, kur bëhet fjalë për studentë me të parët e dobët, gjithnjë duhet të shprehet gatishmëri për ndryshim/përshtatje të datës së dhënies së provimit.

[42] Kis-Glavas, L., urednik (2012), Zbirka priručnika 'Studenti s invaliditetom', Sveučilište u Zagrebu, Zagreb.

- Të përpunohen paraprakisht nevojat e veçanta në rast të mësimit në terren ose aktivitete tjera jashtë klasës.
- T'i ofrohet ndihmë studentit gjatë caktimit të materialeve laboratorike, që i njëjti më lehtë t'i identifikojë.
- Pajisja asistive laboratorike (p.sh. termometrat dhe kalkulatorët me zë, sondat matëse dhe tajmerët taktil (punojnë me prekje).
- Vizatimet reliefë dhe modelet taktil të materialeve grafik.
- Video materialet me zë.
- Të njoftohet studenti/studentja me orarin e klasës ose laboratorikë, të sqarohet ku janë daljet më të afërta për raste urgjente dhe si të gjendet pajisja për raste urgjente.
- Të pyetet studenti nëse ai/ajo ka nevojë për ndonjë ndihmë gjatë evakuimit në raste urgjente dhe nëse është e nevojshme të b[het plani për të njëjtën.
- Të gjitha lajmërimet lidhur me lëndët adekuate, rekomandohet, përveç në tabelën për shpallje, të përsëriten me zë pas çdo ligjërate, si dhe të publikohen në ueb faqen e fakultetit/universitetit.
- Ekspozetë gjithnjë duhet të jenë të shkurta, të qarta, koncize me intensitet dhe shpejtësi normale.
- Ajo që shoqëria dhe kompetentët do të duhej të mundësonin që personave me dëmtim të pjesshëm dhe/ose të plotë të parët t'u lejohet dhe t'u mundësohet shfrytëzimi i qenit ndihmës. Edhe më shumë, në rregulloren ligjore, aktet nënligjore dhe rregulloret, është e nevojshme të parashihet se personi që shfrytëzon qen, do të ketë nevojë nga shfrytëzimi i transportit publik, taksisë, të arsimohet, të marrë pjesë në ngjarje kulturore dhe sportive etj., e në pajtim me këtë edhe qenit duhet t'i mundësohet qasje në lokacionet adekuate.

Në fund të këtij nëntitulli, t'i përkujtojmë disa personalitete shumë të suksesshme dhe të njohura me këtë lloj të invaliditetit, të cilët kanë vërtetuar se invaliditeti/pengesa e tyre nuk është kufizim për suksesin në jetë dhe karrierë[43]: **Helen Keler** (**Helen Keller)** (autore, aktiviste dhe ligjëruese); **Stivi Vonder** (**Stevie Wonder)** (këngëtar-autor amerikan i këngëve, instrumentalit dhe producent); **Franklin Delano Ruzvelt (Franklin Delano Roosevelt)** (kryetari i 32-të i SHBA-ve); **Lui Braj (Louis Braille)** (shpikës dhe krijues i alfabetit të Brajit); **Galileo Galilei (Galileo Galilei), Klod Mone (Claude Monet)** etj.

Kontakti i parë me person/student me invaliditet trupor

Së pari, t'i përkushtohemi disa parimeve shumë të rëndësishme, të cilat qëllimisht nuk janë përmendur në bontonin e përgjithshëm për këtë grup të personave me handikap, të cilat profesori duhet t'u përmbahet gjatë kontaktit të parë me studentin me invaliditet trupor, e këto janë:

- Gjatë kontaktit të parë me studentin, i kapluar nga përjetimi dhe refleksioni i perceptimit vizual, profesori kurrsesi nuk guxon të lejojë të sjell përfundim se ky student krahas/për shkak të invaliditetit trupor patjetër të ketë edhe pengesë intelektuale. Do të thotë duke gjykuar vetëm nga përshtypja e parë, nuk duhet menjëherë ta përshtatë të folurit dhe sjelljen e tij në pajtim me "ndonjë nivel të paramenduar ose të vlerësuar të zhvillimit" për këtë person.
- Gjatë njoftimit me studentin i cili ka dorë të amputuar, kuadriplegi (paralizë të ekstremiteteve të sipërme dhe të poshtme) ose shfrytëzon protezë në vend të dorës ose pëllëmbës, nuk duhet t shmanget përshëndetja me dorë. Përshëndetja me dorë mund të realizohet me prekje, me dorën e shëndoshë ose ashtu siç është më mirë për personin me handikap.

[43] http://www.disabled-world.com/artman/publish/famous-blind.shtml.

- Nëse biseda me studentin/studenten që përdor karrocë invalidore zgjat më gjatë, rekomandohet që edhe pala tjetër (profesori/studenti) të ulet që të mundësohet kontakti me sytë dhe ai të jetë në lartësi me sytë e tij/saj, që ai/ajo mos të lëviz poshtë-lartë.
- Studentët me invaliditet trupor, në përqindje të madhe, janë persona me aftësi dhe kapacitete tërësisht të ruajtura intelektuale dhe për këtë shkak nuk kërkojnë ndonjë adaptim të veçantë të përmbajtjeve mësimore, por vetëm kanë nevojë nga adaptime të kushteve optimale të ambientit në para-ambientin dhe vetë ambientin ku realizohet mësimi. Këto përshtatje kanë të bëjnë me:
  - Hapësirë e tërësishme e jashtme me qasje para universitetit/fakultetit e zgjidhur me barrierë të ndërtuar sipas të gjitha normave dhe standardeve për ndërtim dhe siguron hyrje të pandërprerë të karrocave invalidore që do të thotë se personi nuk do të duhet të kalojë asnjë prag arkitektonik, e lëre më shkallë.
  - Hapësirë e tërësishme e brendshme me qasje e zgjidhur me ashensor që shkon deri te katet e sipërme të ndërtesës.
  - Më së paku një tualet tërësisht me qasje sipas të gjitha normave dhe standardeve për ndërtim, që siguron hyrje të papenguar të karrocës invalidore, që do të thotë se personi nuk duhet të kalojë asnjë prag arkitektonik, e lëre më shkallë.
  - Gjithkund ku ekzistojnë shkallë në objekt të vendosen edhe doreza.

Çfarë mund të bëjë profesori kur disa nga këto kushte për qasje nuk janë plotësuar?

- Përveç se në mënyrë të vazhdueshme, bashkë me studentët të cilët kanë handikap, universiteti duhet të luftojë me çdo kusht t'i plotësojë kriteret lidhur me qasjen në gjithë objektin, profesori mund:
- ta përshtatë gjithë mësimin për grupet, ku gjenden studentë me handikap, të zhvillohet në kapin përdhe,
- të zgjedh klasë, gjerësia e të cilës do t'i plotësojë standardet për hyrje të karrocës invalidore dhe në atë të ketë mjaft hapësirë për manovrim me cilëndo ndihmesë (hyrje, dalje, shkëmbim)
- nëse për shkak të natyrës së invaliditetit trupor, për ndonjë student, është e domosdoshme, të gjendet tavolinë dhe karrige speciale për ndjekjen e mësimit, kjo menjëherë të bëhet,
- të mbajë llogari në kat të ketë tualet modest (në kushte të mungesës nga adaptimi), i cili me mbështetje të ndonjë personi/studenti tjetër do ta mund ta përdor çdo ditë,
- gjithnjë, për shkak të manovrimit të pandërprerë me karrocën invalidore dhe/ose me ndonjë ndihmesë tjetër ortopedike, të mbahet llogari në radhët e para të klasës të lihet hapësirë për karrocën invalidore dhe në atë hapësirë të ketë më pak karrige.

Edhe pse, gjatë përpunimit të përmbajtjeve mësimore nuk kërkohen adaptime të veçanta, megjithatë ekzistojnë përshtatje të caktuara të pakta të cilat do të mund të bëhen, do të thotë:

- Në mungesë të asistentit personal për sundimin e të gjitha pengesave lidhur me mos qasjen fizike në objekt, profesori mund të angazhojë ndonjë student nga grupi, përkohësisht të jetë asistenti i tij personal, derisa nuk gjendet asistent i autorizuar personal. Studenti adekuat do të mund të shpërblehej me disa kredi studentore.
- Pas përpunimit të përmbajtjes mësimore është e domosdoshme të keni version të shtypur të materialit, veçanërisht nëse përdorni diktim, pasiqë disa persona me invaliditet trupor kanë problem me zhvillimin e motorikes së ekstremiteteve të sipërme dhe atë motorikes së mirë, atë të gishtave dhe shkruajnë shumë ngadalë.

- Kompjuterin personal gjithnjë përdoreni si formë alternative për të shkruar, lejoni adaptimin e tij harduer dhe softuer, aplikacionet për të shkruar që aktivizohet me zë, modifikimin e tastaturës dhe/ose miut, tekste të incizuara[44].
- Kontrolli dhe vërtetimi i diturive në provim ose në orët praktike më parë realizoheshin vetëm me gojë, por tani me kompjuterin personal, personat me invaliditet trupor pa kurrfarë problemi mund të përgjigjen në testet, qoftë të bëhet fjalë për detyra ose teori.
- Personat me invaliditet trupor nuk duhet të privohen nga provimi me shkrim. Atyre vetëm duhet t'u sigurohet aq kohë sa u nevojitet për plotësimin e testit.
- Të gjitha lajmërimet lidhur me lëndën Tuaj kur do t'i shpallni në tabelë përpiquni t'i vendosni në lartësi të karrocës invalidore ose edhe tabelën vendosni në atë lartësi dhe gjithsesi rregullisht publikojini në ueb faqen e fakultetit/universitetit.
- Kur fakulteti në programin e vet studimor kërkon shumë punë praktike jashtë nga ambientet e fakultetit (në fakultete tjera, laboratori, forma, salla, dhoma etj.) le të përdor edhe asistent në laboratori, në asnjë rast mos e lironi studentin nga praktika në këto orë dhe dhënien e numrit të nevojshëm të kredive studentore, por gjeni ambient adekuat për realizimin e këtij mësimi ku në tërësi do të plotësohen nevojat e studentit me handikap.
- Tavolinat laboratorike ose të punës që mund të adaptohen.
- Planifikimi paraprak i mësimit në terren si do të mund të sigurohej që e njëjta të ketë qasje.
- Kjo vlen për të gjitha tipat e handikapit jo vetëm për invaliditetin trupor, por u theksua këtu për shkak se studenti me invaliditet trupor duhet të jap mund më të madh fizik për ndjekjen e mësimit, ndërsa invaliditeti trupor në asnjë rast nuk mbetet i pavërejtur nga ana e profesorëve.

Njerëz të njohur të cilët janë goditur me ndonjë lloj invaliditeti trupor:[45]

- Spina bifida: **Frida Kalo (Frida Khalo)** (piktore meksikane); **Xhudi Vudraf (Judy Woodruff)** (korrespondent përgjegjës në Shtëpinë e Bardhë për EnBiSi); **Xhin Driskoll (Jean Driscoll)** (sportiste; zëdhënës profesional) etj.,
- Paraliza celebrale: **Geri Xhuel** (**Geri Jewell)** (komike dhe aktore); **Kristi Braun (Christy Brown)** (autor, piktor dhe poet irlandez); **Kris Fonseka (Chris Fonseca)** (komik) etj.
- Skleroza laterale amiotrofike: **Mao Ce Tung (Mao Zedong)** (lider ushtarak dhe politik kinez); **Lu Gerig (Lou Gehrig)** (lojtar amerikan i bejsbollit);
- Polio: **Franklin Delano Ruzvelt** (**Franklin Delano Roosevelt)** (kryetari i 32-të i SHBA-ve); **Mia Farou (Mia Farrow)** (aktore); **Vilma Rudolf** (**Wilma Rudolph**) (atlete amerikane, gruaja e parë që ka fituar 3 medalje të arta në një olimpiadë),
- Persona të cilët përdorin karrocë invalidore: **Kristofer Riv** (**Christopher Reeve)** (aktor amerikan); **Franklin Delano Ruzvelt (Franklin Delano Roosevelt); Stiven Hoking (Stephen Hawking)** (profesor).

[44] Organizatë joqeveritare (OJQ) "Hapni dritaret" për përshtatjet harduer dhe softuer për personat me handikap www.openthewindows.org.
[45] http://www.disabled-world.com/artman/publish/article_0060.shtml.

Kontakti i parë me persona/studentë me pengesa në zhvillimin intelektual (mental) dhe personat me autizëm

Edhe pse në Republikën e Maqedonisë dhe në Kroaci, për shkak të natyrës së dëmtimit, shkalla e deficitit intelektual dhe specifikat që ai i ndjek, të cilat u sqaruan më parë në Kapitullin 2, personat me pengesa në zhvillimin intelektual (mental) dhe personat me autizëm shumë rrallë ose pothuaj aspak nuk e arrijnë shkallën e arsimit sipëror, megjithatë ekzistojnë disa raste që kanë arritur në këtë dhe të cilët na obligojnë të sqarojmë si duhet të sillemi ndaj tyre. Profesorët:

- Gjatë realizimit të mësimit duhet të përdoren materiale, të cilat do të jenë shumë interesante dhe do ta mbajnë vëmendjen e studentit.
- Ekspozetë gjithnjë duhet të jenë të shkurta, konkrete, të qarta, me përdorimin e termeve të thjeshta.
- Gjatë përpunimit të përmbajtjeve të reja mësimore medoemos duhet të përdoren numër i madh i mjeteve mësimore.
- Metodat e demonstrimit dhe të treguarit vazhdimisht duhet të aplikohen, përmbajtja mësimore ose tema e dhënë duhet të përsëritet disa herë, me qëllim që më lehtë të mbahet mend dhe të sundohet.
- Vërtetimi dhe kontrolli i njohurive në provim duhet të bëhet me shkrim dhe me gojë, përmes testeve paraprakisht të përgatitur, pyetje në pajtim me mundësitë individuale të studentit.
- Në raste më të shpeshta, kontrolli me gojë të bëhet me të treguar, numërimin e termeve ose sqarim me operacione më të thjeshta dhe me asistimin nga ana e ligjëruesit.
- Nevojitet angazhimi i asistentit personal gjatë procesit mësimor, patjetër duhet të ketë defektolog me profesion, i cili do të jetë vazhdimisht prezent në procesin mësimor, por këtu edhe si TUTOR/MENTOR me të cilin këta persona do ta sundojnë materialin mësimor.
- Kompleksja e gjithë këtij procesi kërkon komunikim dhe koordinim të vazhdueshëm me prindërit, si dhe me zyrën e dekanit nëse paraqitet nevoja nga angazhimi i ekipeve profesionale.
- Shumë e sigurt është se studentët me çrregullime psikike nuk do ndjeheshin këndshëm nëse zbulohet specifika e çrregullimeve të tyre.
- Vetëm nëse studenti është i hapur dhe i gatshëm të ndajë për mënyrën se si i ndikon çrregullimi i tij gjatë studimit dhe cilat përshtatje do t'i kishin ndihmuar.
- Me trajtim dhe mbështetje shumica e studentëve me çrregullime psikike mund të ballafaqohen me gjendjen e tyre mentale dhe të kenë dobi nga studimet.
- Nëse studentët/studentet kanë nevojë nga këshillimi në pikëpamje të problemeve lidhur me çrregullimet, inkurajoni të bisedojnë për problemet e veta me Koordinatorin për invaliditet/pengesa.
- Ndonjëherë studentët kanë nevojë t'i kontrollojnë perceptimet e veta të situatës ose informatës që e kanë prezantuar gjatë orës, si do ta kishin vërtetuar se janë në rrugë të mirë për ta kuptuar.
- Detyra lidhur me memorien, siç është spellingu, matematika dhe instruksionet graduale, ndoshta më lehtë do të kuptojnë nëse të njëjtat ndahen në njësi më të vogla (detyra).
- Përgjumësia, lodhja, humbja e memories dhe koha më e shkurtër për përgjigje mund të jenë pasoja nga ilaçet e dhëna.

Përshtatjet që do t'i ndihmonin studentit/studentes me sëmundje mentale (do të kishin mundur të përfshijnë):

- Koha e shtuar për provimet;
- Vend i qetë ku zhvillohet testi, pa mundësi për tërheqjen e vëmendjes;
- Provimet janë ndarë në segmente me pushime të përkohshme;
- Aparatet për mbajtjen e shënimeve, lexues ose incizues në klasa;
- Përdorimi i kompjuterit personal për shkrimin e detyrave për provimin;
- Vazhdimi, jo kompletja ose heqja dorë në momentin e fundit në rast të sëmundjes së vazhduar;
- Fleksibilitet i caktuar në pikëpamje të prezencës në rast të mungesës lidhur me shëndetin;
- Vendi i zgjedhur me kujdes ku studenti/studentja rri ulur (afër derës ose në pjesën e prapme të klasës);
- Pijet e lejuara gjatë orës për shkak të ilaçeve që mund të shkaktojnë etje;
- Të kërkohet ndihmë nga person profesional në pikëpamje të organizimit të kohës dhe aftësive;

Personalitete të njohura me këtë çrregullim:[46,47]

- Epilepsia: **Hugo Viving (Hugo Weaving)** (aktor); **Vinsent van Gog (Vincent van Gogh**) (piktor); **Napoleon Bonaparta (Napoleon Bonaparte**), **Agata Kristi (Agatha Christie**); **Leka i Madh (Alexander the Great**); **Leonardo da Vinçi** (**Leonardo da Vinci**); **Alfred Nobel (Alfred Nobel**); **Riçard Barton (Richard Burton)**
- Çrregullimi posesiv kompulsiv: **Çarls Darvin** (**Charles Darwin**) (hulumtues); **Xhesika Alba** & **Kameron Diaz** (**Jesica Alba** & **Cameron Diaz)** (aktorë); **Donald Tramp (Donald Trumph**); **Nikolla Teslla; Bill Gejts (Bill Gates**), etj.

Kontakti i parë me persona/studentë me çrregullim hiper kinetik me deficit të vëmendjes (Attention deficit hyperactivity disorder – ADHD)

Strategjitë për qasje dhe vlerësim që mund të jenë me dobi kur bëhet fjalë për studentët/studentet me ADHD:[48]

- Pasiqë këta studentë shpesh kanë edhe probleme me të mësuarit, përshtatjet që bëhen te studentët me probleme në të mësuarit mund të shfrytëzohen në mënyrë efikase edhe në këtë rast.
- Në strategjitë efikase bien edhe sigurimi i mundësive për studentët që të mësojnë me ndihmën e mjeteve vizuale, me zë dhe pjesëmarrje aktive.

Përshtatjet (të cilat mund të përfshijnë):

- Ekzemplarë nga vërejtjet nga kolegët dhe/ose tutori ose nga prezantimet;
- Koha e vazhduar për provimet;

[46] http://www.disabled-world.com/artman/publish/famous-ocd.shtml.
[47] http://www.celebrities-with-diseases.com/celebrities/bill-gates-richest-man-in-the-world-and-presumed-adhd-sufferer-2044.html.
[48] http://web.jhu.edu/disabilities/faculty/types_of_disabilities/adhd.html.

- Provimet të jenë në ambient të qetë, pa mundësi që të tërhiqet vëmendja;
- Pushimet gjatë provimit; provimi të jepet faqe për faqe ose pjesë-pjesë;
- Renditja e qartë e pyetjeve nga provimi në letër;
- Kalkulatori, kontrolli i gramatikës, kompjuter dhe/ose aparat për shkrim gjatë provimeve;
- Të përdoret kartelë ose letër e zbrazët si ndihmë gjatë leximit;
- Incizues dhe/ose kompjuter laptop;
- Tekst i incizuar dhe material tjetër gjatë ligjëratave;
- Të përdoren materiale të shtypura ose mjete vizuale;
- Koha e vazhduar e orës për detyrat e dhëna, si të mund të bëhet korrigjim në pikëpamje të spellingut, pikësimit, gramatikës;
- Aplikacioni për rregullimin e tekstit (Word processor) me mundësi për kontrollimin e asaj që është shkruar dhe/ose sintetizator që të sigurohet fidbek me zë;
- Instruksione ose demonstrime të paraqitura në më shumë mënyra;
- Instruksione koncize me gojë;
- Programi mësimor të dorëzohet para fillimit të semestrit;

Bile edhe disa rrethe akademike ndonjëherë janë të rezervuar dhe të kufizuar në pikëpamje të mendimit se personat me ADHD mund të studiojnë. Por, personalitete të njohura me ADHD vërtetojnë se ata mund të kenë karrierë interesante dhe të suksesshme[49]: **Xhastin Timberlejk (Justin Timberlake) (**këngëtar**); Xhejmi Oliver (Jamie Oliver) (**kuzhinier**); Uill Smith (Will Smith) (**këngëtar, aktor**); Xhim Keri (Jim Carrey) (**aktor**); Ser Riçard Branson (Sir Richard Branson) (**themelues i kompanisë **Virgin)** etj.

Kontakti i parë me persona/studentë me pengesa në të folurit

Problemet më të shpeshta në ndjekjen e përmbajtjes mësimore te këta studentë janë të natyrës sociale, prandaj roli i profesorit është shumë i rëndësishëm në ndërtimin e raportit e të drejt pozitiv ndaj vetes dhe studentëve tjerë. Ndihma dhe mbështetja është nevojshme edhe për motivimin e këtyre studentëve për shprehjen e pavarur dhe rrëfimin e mundësive dhe aftësive të tyre reale.

Përpunimi i përmbajtjeve të reja mësimore nuk kërkon adaptim të veçantë nga profesori. Thjesht, gjatë pyetjes nevojitet të aplikohet dhënia e provimit me shkrim, por kurrsesi të mos anashkalohet edhe pyetja me gojë për shkak të folurit gjatë përdorimit të tij dhe në pajtim me zhvillimin e tij të vazhdueshëm.

Kontakti i parë me studentë/personat të cilët kanë probleme emocionale dhe persona me vështirësi në të mësuarit

Në Rregulloren për vlerësim të nevojave specifike të personave me pengesa në zhvillimin fizik ose psikik[50], nuk janë përmendur dhe dy tipa të handikapit, të cilat karakterizohen me probleme të veçanta, ndërsa të cilat janë shprehur gjatë gjithë procesit mësimor. Këta janë **personat të cilët kanë vështirësi në të mësuarit me probleme emocionale**. Për shkak të dukurisë shumë të shpeshtë të këtyre

[49] http://www.parenting.com/gallery/famous-people-with-add-or-adhd.
[50] Rregullorja për vlerësim të nevojave specifike të personave me pengesa në zhvillimin fizik ose psikik (gazeta zyrtare e RM nr. 30/2000, 1777-1779).

studentëve në fakultete dhe pamundësia e profesorëve të zbulojnë se bëhet fjalë për ndonjë dëmtim, do të thotë në mënyrë adekuate t'u kushtojnë më shumë vëmendje, këtu do të ndalemi në disa sugjerime themelore, të cilat do të ishin të dobishme dhe do të kishin ndihmuar gjatë punës me këta persona gjatë realizimit të mësimit dhe për shkallën më të lartë të suksesit në të njëjtën[51].

1) Kontakti me studentë me probleme emocionale[52]

Këta persona kanë karakteristika të caktuara, të cilat në mënyrë negative reflektohen në gjithë procesin e të mësuarit dhe atë:

- hiper aktiviteti
- agresioni
- sjellja e papjekur
- paaftësi për socializim
- depresion
- tipa të parregullt të sjelljes nën kushte normale
- tendencë të zhvillohen qëndrime të caktuara të cilat dalin nga mjedisi arsimor

Këtyre studentëve duhet t'u jepet liri më e madhe e lëvizjes dhe aktivitete interesante të cilat do ta okupojnë kujdesin e tyre.

Programi arsimor duhet të drejtohet nga sundimi i aftësive konjunktive (renduese), zhvillimin e shkathtësive sociale, rritjen e vetëdijes për veten, zhvillimin e fotografisë pozitive për veten dhe vetëkontrolli.

2) Kontakti me persona/studentë me vështirësi gjatë të mësuarit[53]

Vështirësitë gjatë të mësuarit manifestohen me aftësi të papërsosur për dëgjim, mendim, të folurit dhe më së shumti në lexim dhe sundimi i materialit mësimor – dëmtimi, që njihet si **disleksi**¸ probleme në të shkruarit – **disgrafi**, si dhe vështirësi me matematikën e njohur si **diskalkuli** dhe kufizimi i të folurit tashmë ekzistues.

Ana e fuqishme të studentëve me disleksi paraqet perceptimin e mirë vizual, origjinalitetin, kreativitetin, zgjidhjen intuite të problemeve, mënyrën 'artistike' të menduarit, njohjen e fuqishme të kapacitetit global. Ata janë të mirë gjatë diskutimeve dhe aktiviteteve në grup.[54]

Zakonisht ekziston disbalanc mes arritjeve të personit dhe inteligjencës së tij. Për këtë shkak, gjatë punës me këta studentë, profesori duhet:

- në bazë të observimit dhe vlerësimit të mëparshëm të mundësive reale të studentit të ndërtojë qasje individuale të punës dhe vazhdimisht t'i motivojë studentët duke i theksuar aspektet e tija pozitive dhe potencialet për zhvillim dhe forcimin e vetëbesimit, që te këta persona dhe në këtë moshë është e pamjaftueshme ose nuk ekzisto fare;
- në procesin edukues arsimor duhet të përdoren mjetet auditive, siç është diktafoni dhe mjetet vizuale: fotografitë, ilustrimet, maketet, etj.;

[51] http://www.youtube.com/watch?v=1iTBu34HtBg&feature=share
[52] Internet doracaku për profesorë nga SHM "Dimitar Vllahov" – Internet botimi Scribd.
[53] Disleksia www.disleksija.rs.
[54] E përshtatur sipas: Glavas, L., urednik (2012), Zbirka priručnika 'Studenti s invaliditetom', Sveučilište u Zagrebu, Zagreb.

- të përdor metoda të demonstrimit, ilustrimit dhe prezantimit, si dhe veprimi në miratimin e përmbajtjeve të reja mësimore;
- të përdor fjali të shkurta dhe të qarta;
- provimet mund t'i realizojë me shkrim ose gojarisht, por me pyetje konkrete, kërkesa dhe ndihmë nga profesori;
- të përdor materiale të cilat menjëherë japin informatë kthyese;
- ta përdor kompjuterin personal si mjet alternativ dhe/ose ndihmës për shprehje. Për shkrimin e tekstit në kompjuter ekzistojnë standarde të caktuara, me çka teksti është përshtatur plotësisht për personat me disleksi dhe ato janë:
- të përdor shkronja san-serif gjegjësisht shkronja pa vija të shkurta në këndet.
- madhësia e shkronjave të jetë fonti 12, por mundet edhe më i madh.
- të rritet hapësira mes shkronjave dhe rreshtave, të përdoren shkronja bold dhe highlighted, derisa italic dhe nënvizimi i tekstit aspak nuk duhet të përdoret, pasiqë kjo mund të shkaktojë lidhje vizuale, lidhjen e fjalëve.
- pamja e tekstit, gjegjësisht stili i të shkruarit, të jetë me fjali të shkurta ku do të shmangen tërësi të mëdha tekstuale, ndërsa do të shkruhet në pasuse shumë të shkurta, të ndara në tërësi të vogla;
- rreshtat të barazohen nga ana e majtë;
- të mundohet që teksti të organizohet me renditje numerike në rreshta të ndarë;
- fjalitë të ndahen me hapësirë të dyfishtë (distancë e dyfishtë) dhe fjalia të mos fillojë nga fundi i rreshtit;
- të përdorem margjina të gjera;
- të përdoren tituj dhe nëntituj dhe të lihet zbrazëtirë mes pjesëve, pasuseve.

Prezantimi i informatave për këtë grup të personave/studentëve

- Gjatë prezantimit të informatave, në vend të fletës së bardhë, të përdoret letër me ngjyrë.
- Krijimi i faqeve duhet të jetë i thjesht dhe nuk rekomandohet përdorimi i fotografisë në prapavijë ose fonte shumë të ndryshme, pasiqë kjo do ta bëjë tekstin shumë të vështirë për të lexuar.
- Në një pllakat ku theksohet ndonjë ngjarje është mirë të grupohen informatat themelore, siç janë koha dhe vendi i mbajtjes.
- Afishet janë ideale për sqarimin e ndonjë procesi ose procedure, ndërsa gjatë sqarimit të ndonjë procedure, më e dobishme është të aplikohet lista numerike me udhëzimet në krahasim me tekstin në vazhdim.
- Është i domosdoshëm sqarimi i shkurtesave dhe fjalëve dialektike, sigurimi i përmbajtjeve në fillim të tekstit, di dhe në indeksin në fund të tekstit.
- Në tabelat për shpallje patjetër duhet të përdoret tekst i shkruar në kompjuter, e jo tekst i shkruar me dorë.
- Vendosja e pllakës nën kënd (i anësuar në rrafshinën vertikale) e lehtëson leximin.
- Të gjitha këto standarde janë aplikative edhe për personat të cilët kanë dëmtim të parët gjegjësisht të parët shumë të rëndë.

Krijimi i internet faqeve

- Faqja duhet të jetë e thjesht, ndërsa përmbajtja e faqes mos jetë shumë e ngarkuar.
- Do të ishte e dobishme që faqja të lexohet edhe offline, ku shfrytëzuesi duhet ta ketë të qartë cilat faqe i ka vizituar dhe për momentin ku gjendet.
- Te njerëzit me vështirësi në leximin e tekstit, i cili lëviz shkakton probleme.
- Disa shfrytëzues preferojnë shkronja të zeza ose të kaltra të errëta ose prapavijë të verdhë, pyesni ata çfarë është më mirë që mos të gaboni.
- Përqendrohuni në saktësinë dhe qartësinë e informatës, e jo në mënyrën e të shprehurit.
- Injoroni gabimet e tyre në shqiptim dhe gramatikë.
- Qasuni diturisë faktike të studentit/studentes, gjatë vlerësimit duhet t'i përfshini temat që janë lëndë e ligjëratave.
- T'u mundësohet studentëve të shprehen në mënyrën më të mirë për ata, të shkruajnë me shkronja të mëdha dhe t'u jepet mundësia të mbajnë shënime në kompjuterët e tyre personal.
- Atyre u nevojitet të paktën 30% më shumë kohë për të plotësuar provimin, testet dhe ushtrimet praktike.
- Të mos ketë teste të shkurta dhe të shpejta, për ata është më së miri të mbahen shënime se sa shtrimi i pyetjeve me gojë; kjo të bëhet çdoherë kur është e mundur.
- Nuk rekomandohen pyetje me zgjedhje nga më shumë përgjigje, si dhe kopjimi i përgjigjeve në fletën me përgjigjet e dhëna, do të ishte mirë që esetë të zëvendësohen me mënyra tjera të shkruarit të testeve.
- Kur ata mësojnë në gjuhë të huaj, do të duhej t'u lejohet kohë më e gjatë dhe deri 50% për lexim.

Personalitete të njohura me disleksi: **Agata Kristi (Agatha Christie)** (autore e librave); **Albert Ajshtajn (Albert Einstein)** (fizikan i madh dhe mendimtar); **Aleksandër Gream Bell (Alexander Graham Bell)** (shpikës); **Sher** (**Cher)** (këngëtare dhe aktore) etj.

Kapitulli 4

Nga pikë vështrimi i ekspertëve

Autorë: Daniella Stojanovska – Xhingovska[1], Jerko Markovina[2]

Për shkak të natyrës heterogjene të çrregullimeve zhvillimore, trajtimi i tyre në zhvillimin te fëmijët/personat me handikap, nevojitet punë ekipore dhe qasje multi disiplinore, që kërkon inkuadrim të më shumë profileve të ndryshme profesionale.[3].

Çdo personi me handikap duhet t'i kushtohet vëmendje e madhe dhe të përfshihet me trajtim të hershëm qoftë me:

1. **Puna patronazhi në familje[4]** – Trajtimi defektologjik patronazh në familje çdo herë duhet të jetë profesional dhe i bazuar në punë ekipore. Në përbërje të ekipit hynë: defektologu, punëtori social dhe fizioterapist.
2. **Institucionale** – me rehabilitim në Këshillimoret zhvillimore ose në institucione për fëmijët parashkollor. Ekipet profesionale në Këshillimoret zhvillimore kryesisht janë përbërë edhe nga profile tjera, e këta janë: mjeku specialist-pediatër, më shumë motra mjekësore, neuropsikiatër, otorinolaringolog-specialist, stomatolog, ftiziatër, sipas nevojës angazhohen edhe profesionistë tjera, të cilët edhe pse nuk janë lëndë e përpunimit në këtë kapitull është e rëndësishme të dihen si profile.

Pjesë përbërëse e Programit nacional për zhvillimin e arsimit (2005-2015) është edhe Programi për zhvillim profesional të kuadrit shkollor[5], në të cilin janë rregulluar kompetencat specifike për profilet profesionale, të cilat me ndryshime dhe përshtatje të caktuara në pajtim me moshën dhe pjekurinë e nxënësve dhe studentëve, këtu kanë të bëjnë me shkollat e mesme dhe fakultetet, ndërsa do të ndalemi vetëm te detyrat e punës të defektologut, psikologut dhe punëtorit social, të cilët kanë të bëjnë me punën në shkollat e mesme dhe fakultetet.

Nga perspektiva e defektologut

1) Përshkrimi i punës dhe detyrave të defektologut

- Defektologu kujdeset për realizimin e propozimit të ekipit profesional në planin e trajtimit defektologjik.
- Në realizimin ne observimeve, defektologu aplikon instrumente matëse dhe në bazë të rezultateve të marra, ndërsa në pajtim me rekomandimet e ekipit përpilon programe për punë individuale me nxënësit/personat me handikap, që i realizon në shkollë.

---

[1] Daniella Stojanovska – Xhingovska, V. Sc. E defektologjisë, kryetare e Shoqatës së studentëve dhe të rinjve me handikap - Shkup, Maqedoni, e-mail: stojanovskad@gmail.com.
[2] Dr. Jermo Markovina, Ph.D. në psikologji është docent pranë Universitetit në Zagreb, Kroaci: e-mail: jmarkovina@agr.hr.
[3] prof. dr. Ajdinski L; Metodika e trajtimit të hershëm dhe edukimi parashkollor i fëmijëve me pengesa në zhvillim, Fakulteti Filozofik-Instituti i defektologjisë, Shkup, 1996.
[4] Persona të caktuar profesional nga praktika realizojnë vizita në shtëpitë e personave me handikap dhe sigurojnë shërbime të nevojshme adekuate.
[5] Programi nacional për zhvillim të arsimit në R.M. (2005-2015) www.mon.gov.mk.

- E planifikon dhe e programon punën për vërtetimin e shkallës së aftësisë dhe mundësive të personit me handikap, shkallën e fitimit të diturisë në shkathtësitë dhe risitë.
- Çdo ditë udhëheq ditar për punën e vet dhe për përgatitjen e punës.
- E përgatit nxënësin/studentin/personin me handikap për inkuadrim në format e organizuara grupore për punë.
- Defektologu duhet të konsultohet me të gjithë anëtarët e ekipit profesional.
- Defektologu paraqet lidhje aktive mes shërbimeve adekuate profesionale (shërbimi arsimor-pedagogjik, fakulteti/universiteti, Qendra për punë sociale, organizata invalidore etj.) që mund të japin ndihmë adekuate në punën e defektologjisë dhe rezultatet prej saj.
- Merr pjesë në komisionet për kategorizimin e nxënësve/personit me handikap.

2) Kompetencat specifike të defektologut

Kompetencat specifike të defektologut si punëtor profesional në shkollë/fakultet[6] janë ndarë në tre nivele, dhe atë:

Puna e drejtuar ndaj arsimtarëve

- Përcjellja e qasjes së arsimtarëve/profesorëve në punën me nxënës/studentë me handikap;
- Metodat dhe mjetet për punë me nxënës/studentë me handikap;
- Shkalla e kënaqësisë e të gjitha nevojave;
- Krijimi i klimës;
- Përcjellja e inventives dhe kreativitetit të arsimtarëve/profesorëve për punë me këta nxënës/studentë.

Puna e orientuar drejt përcjelljes së shkallës së integrimit të nxënësve/studentëve me handikap në procesin mësimor

- Zbulimi i nxënësve/studentëve të cilëve u nevojitet ndihmë profesionale;
- Ndihmë në adaptim;
- Gjendja emocionale-nevoja të specializuara arsimore;
- Puna me fëmijë/nxënës (individuale, grupore dhe kolektive);
- Psiko-motorika;
- Të folurit;
- Diskalkulia;
- Lëvizshmëria dhe orientimi në hapësirë;
- Alfabeti i Brajit (për personat të parët e dëmtuar) ;
- Të folurit oral dhe me gjeste (për personat me të dëgjuarit e dëmtuar) ;
- Interpretimi i përmbajtjeve mësimore.

[6] Programi nacional për zhvillimin e arsimit në R. Maqedonisë (2015-2015) (fq.353) www.mon.gov.mk.

Kompetencat këshillëdhënëse-konsultative të defektologut

- Gjatë përpunimit të programit për punë-pjesëmarrje në identifikim; konkretizimi dhe operacionalizimi i qëllimeve dhe detyrave;
- Pjesëmarrje në adaptimin e përmbajtjeve;
- Përsosja profesionale e arsimtarëve/profesorëve të cilët punojnë me nxënës/studentë me handikap;
- Puna e të kuptuarit dhe toleranca mes nxënësve/studentëve;
- Këshillimi i prindërve për socializim të nxënësve/studentëve;
- Ndihmë tjetër profesionale e prindërve në bashkëpunim me ekspertët tjerë;
- Informimi i mjedisit social për nevojat dhe problemet e këtyre nxënësve/studentëve;
- Orientimi profesional i nxënësve sipas aftësive.

Nga perspektiva e psikologut: nevojat psikologjike të studentëve

1) Parimet psikologjike dhe puna e psikologut

Thelbi i këtyre parimeve kryesisht bazohet mbi hulumtimet, studimet dhe vërtetimin e cilësisë dhe kuantitetit të veprimeve psikike në tërësi dhe në funksionet individuale të tija. Qëllimi i parimeve psikologjike është që sa më mirë të njihet personaliteti i çdo nxënësi/studenti/personi me handikap, pastaj individi të orientohet se si dhe në cilën mënyrë t'i mbisundojë problemet lidhur me handikapin dhe sipas kësaj të përshtatet me realitetin. Rëndësia psikologjike e arsimit të nxënësve/studentëve/personave me handikap qëndron në atë se përmes mësimit të lehtësohet kalimi i nxënësve/studentëve/personave me handikap nga njëri mjedis në tjetrin.

2) Përshkrimi i punës dhe detyrave të psikologut

- Psikologu, si psiko-diagnostikues, është përgjegjës për aplikimin adekuat të metodës dhe teknikës për grumbullimin e informatave të mira nga pacienti (diagnoza dhe prognoza). Testet psikologjike i shpërndan sipas grupeve psikologjike ose sipas ndonjë sistemi tjetër të klasifikimit diagnostik të kritereve.
- E vlerëson gjendjen psikologjike dhe rëndësinë e simptomave, vendin dhe ndikimin e tyre të gjendjes mentale dhe përshtatjen.
- I njofton, zbulon dhe i definon problemet e pacientit dhe kontribuon për caktimin e ndikimeve dhe programit terapeutik.
- Në mënyrë aktive merr pjesë në forma të ndryshme të psikoterapisë dhe këshillimeve dhe bashkëpunon në mënyrë aktive me të gjitha institucionet për shkak të sigurimit të kushteve optimale për zhvillim.
- Bashkëpunon me shërbimin psikologjik të shkollës më organizimin e punës në fushën mentale higjienike për krijimin e klimës mentale për zhvillim harmonik dhe sukses më të mirë në shkollë.
- Bashkëpunon me qendrën për punë sociale për shkak të përkujdesjes së të gjithë personave, të cilëve u nevojitet kujdes i veçantë dhe ndihmë sociale.
- Kryen vlerësim të pjekurisë së nxënësve/studentëve/personave me handikap dhe merr pjesë në punën e komisionit për kategorizimin e personave me handikap.

- Shkruan gjetje psikologjike për nxënësit/studentët/personat për kërkesat e institucioneve tjera.
- Në mënyrë aktive merr pjesë në punën ekipore dhe sipas nevojës konsultohet me ekspertë të tjerë.

3) Kompetencat specifike të psikologut

Kompetencat specifike të psikologut si bashkëpunëtor profesional në shkollë/fakultet[7] janë ndarë në tre nivele, dhe atë:

Puna e orientuar ndaj arsimtarëve

- Studimi i klimës psikologjike në klasë/grupin e studimeve ku studion studenti me handikap.
- Bashkëpunimi me arsimtarët/profesorët për ofrimin e ndihmës nxënësve/studentëve të caktuar.
- Avancimi i vlerësimit të njohurive.

Puna e orientuar ndaj nxënësve

- Puna me nxënës/studentë (individuale, grupore dhe kolektive);
- Nxënës që përsëritin;
- Nxënës/studentë problematik;
- Nxënës/studentë të talentuar;
- Nxënës/studentë me probleme sociale;
- Nxënës/studentë me probleme familjare;
- Nxënës/studentë me probleme personale;
- Nxënës/studentë me sukses më të dobët;
- Nxënës/studentë me handikap;
- Ndjekja periodike e sjelljes së nxënësve/studentëve;
- Ofrimi i ndihmës psikologjike nxënësve/studentëve;
- Zbulimi i shkaqeve për ndryshimin në sjellje;
- Përshtatja e nxënësve në vitin e parë e arsimit të mesëm;
- Pjesëmarrja në punën ekipore në punën profesionale të nxënësve në vitet përfundimtare.

Kompetencat psikologjike

- Ndërtimi i marrëdhënieve ndër njerëzore dhe ndëretnike mes nxënësve/studentëve në kolektiv;
- Puna në këshillimoren mjekësore;
- Ndihma këshillëdhënëse dhe bashkëpunimi me prindërit.

Nga perspektiva e punëtorit social:
Puna dhe kompetencat e punëtorit social

- Punëtori social sipas kategorive për mbrojtjen e fëmijëve, të rinjve dhe të rriturve me handikap të situatave rrezikuara familjare dhe të çrregullimeve në sjellje.
- Bën anketë sociale në shkollë/fakultet dhe në terren për çështje të caktuara.
- Koordinon, hulumton, analizon dhe inicion pjesëmarrje në planifikimin dhe organizimin e aksioneve për pengimin e dukurive të caktuara të pavolitshme shoqërore.

[7] Programi nacional për zhvillimin arsimit në RM (2015-2015) (fq. 352) www.mon.gov.mk.

- I hulumton kushtet dhe shkaqet për lindjen e problemeve që e kanë sjellë personin në gjendje të nevojës sociale.
- Aktivitetet e veta i orienton drejt realizimit të kontakteve të ndryshme me institucionet tjera dhe bashkarish i aplikon masat adekuate të mbrojtjes sociale dhe shëndetësore.
- Punon në sanimin e konflikteve eventuale ose të vazhdueshme në mjedis.
- E realizon socio-terapinë e programit individual ose të përgjithshëm te nxënësit/personat me handikap të socializimit primar ose sekondar, këta janë persona sociopatë me devijime morale dhe çrregullime në sjellje.
- Kujdeset për nevojat socio-ekonomike të personave me handikap që janë regjistruar në këshillimoret dhe për personat tjerë që i drejtohen shërbimit shëndetësor, ndërsa sëmundja e tyre është e lidhur për gjendjen e keqe sociale dhe ekonomike dhe ndihmë për realizimin e të drejtave të tyre sociale.
- E ndihmon dhe e organizon vendosjen në ente speciale në bashkëpunim me qendrën për punë sociale të komunës ose qytetit ku jetojnë.
- Organizon punë individuale dhe grupore me prindërit.
- Në mënyrë të obligueshme konsultohet me anëtarët tjerë të ekipit të ekspertëve për çdo rast veçmas.
- Punon në programin e caktuar për nxënësin/studentin.
- U jep udhëzime prindërve për punën me nxënësin, ndërsa nëse paraqitet nevoja edhe me studentin.
- Merr pjesë në punën grupore me prindërit.
- Merr pjesë në punën e komisionit për kategorizimin e personave me handikap.
- Çdo ditë mban shënime në ditar për punën ku janë shënuar edhe përgatitjet për punë.
- Në mënyrë të obligueshme konsultohet me anëtarët tjerë të ekipit të ekspertëve me lajmërim gojor ose shkrimin e raportit me shkrim.

Roli i psikologut, punëtorit social dhe defektologut në përcaktimin e orientimit profesional të nxënësve/studentëve

Segmenti më i rëndësishëm i përbashkët ose fusha e interesit të këtyre tre profileve për kalimin nga arsimi i mesëm drejt atij sipëror ose nga arsimi i mesëm drejt punësimit është orientimi profesional. Në përmbajtjet e orientimit profesional në kuptimin e gjerë janë përmbajtur karakteristikat që vijojnë:

1. Orientimi profesional është veprimtari e cila paraqet dhënien e ndihmës në pikëpamje të profesionit dhe atë:
   - Ndihma t'u jepet atyre të cilët gjenden në lidhje të drejtpërdrejtë me çështjet për zgjedhjen e profesionit ose zgjedhjen e fakultetit ku do të studiohet.[8,9]
   - Ndihma të jepet derisa zgjat procesi i orientimit profesional.

2. Me orientim profesional duhet përpjekur që kandidati të drejtohet në atë profesion ku do t[ë ketë më shumë raste për sukses.

[8] Prof. dr. Risto Petrov, Ligjërata nga lënda "Orientimi profesional dhe aftësimi i personave me pengesa në zhvillim" – Shkup, 1998.
[9] Prof. dr. Risto Petrov, 2007, "Persona me invaliditet: Orientimi, aftësimi dhe punësimi profesional", Fakulteti Filozofik, Shkup, Universiteti Shën Qirili dhe Metodi, Shkup.

3. Orientimi profesional mund të organizohet dhe të realizohet vetëm me angazhimin dhe koordinimin e të gjithë faktorëve të cilët mund të ndihmojnë.

Ekzistojnë **tre faza në procesin e orientimit profesional** dhe atë:

1. Faza përgatitore;
2. Këshillimi gjatë zgjedhjes së profesionit ose fakultetit;
3. Faza e ndjekjes së suksesit të personit të këshilluar.

Komponentë më të rëndësishëm të **fazës përgatitore** gjegjësisht informimi për profesionin/fakultetin janë:

1. Njohja e kandidatit.
2. Ndikimi mbi kandidatin për zhvillimin e veçorive të tija dominuese gjatë njohjes së çështjeve më të rëndësishme lidhur me zgjedhjen e profesionit ose fakultetit.
3. Njohja e kandidatit me profesionet të cilat do t'i kishte punuar ose me fakultetin në të cilin do të studionte.
4. Njohja me nevojat e bashkësisë shoqërore nga fuqia e punës, si dhe me mundësitë për punësim.
5. Hedhja poshtë e paragjykimeve të caktuara dhe kuptimeve të gabuara gjatë zgjedhjes së profesionit/fakultetit.
6. Krijimi i qëndrimit aktiv të kandidatit në zgjedhjen e profesionit të tij.

Në **fazën e këshillimit gjatë zgjedhjes së profesionit ose fakultetit** vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet punës ekipore, që këtu ka rrjedhë specifike:

1. Bisedë fillestare me kandidatin që të njihen dëshirat e propozimet e tija;
2. Realizimi i kontrollit mjekësor me qëllim të vërtetimit të indikacioneve dhe koftra indikacioneve mjedisore për zgjedhjen e profesionit/fakultetit;
3. Hulumtimet psikologjike me qëllim që të fitohen të dhëna për gjendjen psikike të kandidatit (intervista, testi, anketa);
4. Analizimi i të gjitha të dhënave për kandidatin të fituara gjatë fazës përgatitore (dëftesat, dosjet);
5. Përpunimi, krahasimi dhe harmonizimi i të gjitha informatave të fituara me qëllim që të vërtetohet prognoza dhe të parashihen profesionet/fakultetet, ku kandidati ka më së shumti raste për sukses;
6. Bisedë me kandidatin me qëllim që t'i kumtohet këshillit të ekipit të ekspertëve.

Arsyetimi i **fazës së tretë,** do të thotë faza e përcjelljes së suksesit, nga orientimi profesional potencohen me disa fakte:

1. Përcjellja dhe kontrolli i suksesit të personit të këshilluar është e nevojshme për shkak të kontrollit nëse profesioni/fakulteti i zgjedhur është adekuat për kandidatin, pasiqë me këshillën profesionale arrihet siguri më e madhe, por jo edhe absolute për suksesin në profesionin/fakultetin e zgjedhur.[10]
2. Bile edhe në rast kur do të vërtetohet se profesioni i propozuar i përgjigjet kandidatit, përcjellja dhe kontrolli i mëtejshëm i suksesit janë të nevojshme për shkak të ndërmarrjes së masave të caktuara që kandidati sa më mirë të përshtatet në vendin e punës ose në fakultet.
3. Përcjellja dhe kontrolli i suksesit dhe për shkak të shqyrtimit të gabimeve, lëshimeve ose përparësive të mundshme në bazë të cilave në kohë do të pengohet frustrimi i personalitetit

[10] Prof. dr. Risto Petrov, Ligjërata nga lënda "Orientimi profesional dhe aftësimi i personave me pengesa në zhvillim" – Shkup, 1998.

dhe do të ndërmerren masa për eliminimin komplet të asaj gjendje dhe do të avancohet procesi i orientimit profesional.

Nevoja për ekzistimin e të gjitha këtyre tre profileve (psikologu, punëtori social dhe defektologu) duhet të forcohet, gjegjësisht të gjithë ata duhet të jenë prezent patjetër në arsimin fillor dhe të mesëm, si dhe në procesin e arsimit sipëror pa dallim të pjekurisë së moshës.

Orientimi profesional është i nevojshëm për përcjelljen dhe kontrollin e gjithë procesit arsimor sipëror nga fillimi deri te përfundimi i studimeve të caktuara, pasiqë nëse profesorët universitar konstatojnë se u nevojiten konsultime me ekipin e ekspertëve për shkak të ndryshimit të grupit të studimeve, bile edhe ndryshimi i fakultetit për student të caktuar me handikap, i cili nuk shpreh shkallë të mjaftueshme të diturisë dhe mbetet prapa në studim, për të mirën e studentit, kjo duhet të bëhet menjëherë, kështu që ai në kohë të drejtohet në fakultetin e vërtetë, ku në mënyrë adekuate do t'u përgjigjet obligimeve, në pajtim me mundësitë dhe kapacitetet e veta.

Bile edhe nëse bëhet fjalë për studentë shumë solid me handikap, studimet e tyre duhet të përcillen në mënyrë të vazhdueshme, me qëllim që duke i marrë parasysh kapacitetet e tyre më tej t'u mundësohet punësim adekuat.

Për fat të keq në R. Maqedonisë këto shërbime për orientim profesional shumë pak ose aspak nuk funksionojnë dhe nevojitet riorganizimi i tyre i tërësishëm dhe vendosja e standardeve, metodave dhe mënyrave të reja të funksionimit.

Si ta dimë nëse ndonjë person/student ka nevojë për ndihmë profesionale dhe/ose ka tip të caktuar të vështirësive gjatë mësimit

Duke marrë parasysh faktin se kapitulli i parë në mënyrë të hollësishme i përshkruan karakteristikat e personave me handikap nga të gjitha kategoritë, ndërsa kapitulli i dytë jep drejtime konkrete se si profesori të sillet gjatë kontaktit të parë me këta studentë, në këtë kapitull në pyetjen: Si të vlerësohet nëse studentëve u nevojitet ndihmë profesionale, ndaj kësaj pyetje pjesërisht është përgjigjur në kapitujt paraprak dhe me këtë kapitull, për atë qëllim këtu do të përmendet vetëm se si të zbulohen në vështrim të parë më lehtë ato handikapi të padukshme siç janë: disleksia dhe atë se si ajo më lehtë të njihet përmes testeve adekuate të dedikuara për profesorët, të cilat nuk janë përmendur në kapitujt e parë.

1) Pyetësor si ta njohim disleksinë[11]

1. A ju duket se fëmija/personi shpesh hutohet, ndërsa Ju nuk e dini shkakun për këtë?
2. Standardet për punën e tij/saj a janë të pa përhershme?
3. A ka vështirësi të mbani mend disa instruksione?
4. A bën gabime të çuditshme gjatë leximit dhe shkrimit?
5. A ka probleme gjatë shkrimit të audio materialit të dëgjuar në kasetë, CD?
6. A ka vështirësi gjatë zotërimit të operacioneve matematikore dhe përmbajtjeve mësimore nga matematika?
7. A Ju befason mundi që e investon përkundër rezultateve të dobëta që i arrin?
8. A është i plogësht në disa fusha, ndërsa shumë i shkathët në tjera?
9. A sillet shumë shpesh si palaço në grup, ndërsa Juve ju duket se nuk është i/e lumtur dhe i/e gëzuar?

[11] Disleksia www.disleksija.rs.

10. A ju duket se nuk Ju dëgjon?
11. A lë përshtypje se është dembel/e dhe aspak nuk e intereson çfarë flisni?
12. A lë përshtypje se nuk është i përqendruar dhe se nuk mund ta mbajë gjatë kohë vëmendjen?
13. A ka faza të mira dhe të këqija gjatë ditës?
14. A është i/e hutuar në hapësirë, veçanërisht kur bëhet fjalë për majta dhe djathtas?
15. Është dukshëm më i/e mirë në shprehjen me gojë?

2) Indikacionet specifike, d.m.th vështirësitë lidhur me leximin

- Vështirësi gjatë lidhjes së grafemave me fonemën gjegjësisht shkronja me zërin;
- Vështirësi gjatë lidhjes së zërave dhe rrokjeve në fjalë;
- Gabime strukturore, zhvendosja ose ndërfutja e shkronjave në fjalë, zëvendësimi i ngjashmërive grafike (nuk ka – mua);
- Zëvendësimi i shkronjave të ngjashme fonetike siç janë b-p, d-t, g-k, etj.;
- Zëvendësimi i rrokjeve (ai – imi);
- Zëvendësimi i fjalëve dhe të qëlluarit;
- Lëshimi i shkronjave dhe rrokjeve dhe përsëritja e pjesëve të panevojshme nga fjalët;
- Vështirësitë për ndjekjen e rreshtit të shkronjave dhe numrave kur janë shkruar bashkë në rresht;
- Vështirësi për ndjekjen e drejtimit të leximit lart dhe poshtë, si dhe majtas dhe djathtas;
- Kthimi i tashmë rreshtit të filluar për lexim;
- Lëshimi i fjalëve të tëra, si dhe rreshtave të tërë;
- Leximi i një fjale në disa mënyra të gabuara;

3) Indikacione specifike, d.m.th. vështirësi lidhur me të shkruarit

- Vështirësi gjatë lidhjes së grafemës me fonemën gjegjësisht shkronja me zërin;
- Zëvendësimi i shkronjave të ngjashme grafike;
- Të shkruarit dhe vizatimi me pasqyre i shkronjave të errësuara;
- Gabime strukturore (shtimi, ndërfutje dhe zhvendosje);
- Lëshimi i shkronjave, pjesëve të fjalëve dhe fjalë të tëra;
- Përveç vështirësive lidhur me leximin dhe shkrimin, fëmijët me disleksi shpesh kanë probleme edhe me zotërimin e njohurive nga fusha e matematikës dhe operacioneve matematikore;

4) Simptoma të disleksisë te të rriturit: Simptomat e përgjithshme

- Jo baraspeshë mes vetive të përgjithshme dhe shkathtësive gjuhësore;
- Ndryshimi i disponimit, ditë të mira dhe të këqija;
- Konfuzja-vështirësitë në organizimin e ditës së punës dhe kohës së lirë;
- Memoria e dobët dhe afatshkurtër punuese;
- Saktësia e pamjaftueshme dhe orientimi në hapësirë dhe kohë (majtas – djathtas ose lindje - perëndim);
- Vështirësi në sekuencimin (rendi i alfabetit, muajt e vitit, tabelat, lista me instruksione, ditëlindja);
- Probleme në mbajtjen mend të kohës, humbja e kohës;
- Vështirësi në gjetjen e rimës;

- Vështirësi në të kuptuarit e humorit, që është shprehur me fjalë;
- Vështirësi në bisedë, u nevojitet kohë për përpunim dhe gjetjen e shprehjes së vërtetë;
- Vështirësi në koordinim në hapësirë, kohë dhe përjetim;
- Perceptim i pasaktë, kryesisht i keq për veten dhe krijimi i pasqyrës së keqe te të tjerët (jam dembel dhe i pakujdesshëm);

5) Simptoma lidhur me vështirësitë gjatë të mësuarit dhe edukimit

- Të ngadalshëm dhe të pasigurt në lexim, veçanërisht gjatë leximit me zë;
- Vështirësi në të kuptuarit e asaj që është lexuar dhe si pasojë e kësaj, sjellja e përfundimeve të gabuara;
- Probleme në dekodimi e fjalëve, termeve dhe fakteve të reja të panjohura;
- Të folurit e shpejt e asaj që është mësuar dhe gjetja e vështirë në libër të asaj që është mësuar në klasë;
- Strategji të varfra për transferimin e diturisë dhe informatave në memorien afatgjate, pamundësia për të shkruar shpejt, veçanërisht shënimi gjatë diktimit sepse nuk mund të dëgjojnë dhe të shkruajnë njëkohësisht;
- Vështirësi në të shprehurit e pavarur me shkrim (lidhja e dobët e ideve dhe koncepteve, përdorimi i dobët i fjalorit personal, si dhe të gramatikës dhe sintaksës);
- Vështirësi në organizimin e të mësuarit, veçanërisht të bazës së të dhënave;
- Probleme lidhur me dorëshkrimin (jo pedant dhe pa lexueshmëri);
- Është e mundshme edhe prirje edhe përdorimi i kalkulatorit;
- Vështirësi në gjeneralisimin dhe aplikimin e diturive të reja;
- Probleme gjatë punës në rrethinë, ku ka shumë zhurmë, si dhe ngacmime tjera;
- Nevojë që informata t'u thuhet disa herë;
- Për shkak të leximit të ngadalshëm dhe të kuptuarit e dobët të asaj që është lexuar, vazhdimisht u mungon kohë që ta bëjnë punën e tyre dhe vazhdimisht janë ngushtë e kohën.

Kapitulli 5

Përvojat personale të personave/studentëve me invaliditet

Autorë: Irena Bojmalieva[1], Aneta Llambevska[2],
Biljana Manevska[3], Raull Kevriq [4]
Koordinuar nga: Daniella Stojanovska – Xhngovska[5] dhe Ivana Biliq[6]

Përvoja personale, perspektiva dhe sugjerimet e personit/studentit me të parët e dëmtuar

Në bazë të përvojës sime si jurist i diplomuar në Fakultetin Juridik "Justiniani 1" – Shkup, me notë mesatare 8,5 (tetë e pesëdhjetë) për studimet para diplomimit, si student me të parët tërësisht të dëmtuar, ndërsa tani student pas diplomimit në fakultetin e njëjtë me të gjitha provimet e dhëna sipas programit të paraparë me sukses të realizuar 10,00 (dhjetë) në drejtim të lehtësimit të qasjes së arsimit sipëror për studentët me të parët e dëmtuar, nevojitet të bëhet si vijon:

1) Qasja në fakultet

- Në çdo klasë, në çdo kabinet të profesorëve ose ndonjë ambient tjetër që ka numër, sqarim se cili ambient është ky, nëse ka emër, mbiemër dhe titull të profesorëve/të punësuarve, në mënyrë të obliguar duhet të ketë shenja me Alfabetin e Brajit, studentët me të parët e dëmtuar nuk do të duhet t'i pyesin kolegët, dhe/ose nuk do të duhet t'i lusin që t'i shoqërojnë deri te ambienti adekuat ose deri te kabineti i ndonjë profesori. Në fillim të studimeve të mia, më nevojitej ndihmë e madhe nga kolegët e mi dhe atë ndihmë e kërkoja dhe e merrja në mënyrë jo egoiste. Pasiqë kam orientim të mirë dhe pasiqë gjatë studimeve të mia të mëtutjeshme u njoftova me atë se ku gjendet çdo klasë dhe kabinet i profesorëve në fakultetin ku studioja, ngadalë fillova të bëhem i pavarur. Megjithatë, ende marr ndihmë jo egoiste nga kolegët e mi, të cilën e pranoj me gjithë qejf.
- Sa i përket bibliotekës dhe klasës për lexim, patjetër duhet të ketë të paktën një kompjuter, i cili do të aftësohet për studentët me të parët e dëmtuar. Që të mundësohet kjo, nevojitet që te kompjuteri të instalohet **sinteza folëse** ose "thënë në mënyrë popullore" **lexues i ekranit.** Me këtë do të zgjidhet një nga problemet më të mëdha gjatë studimit për personat e verbër. Në

[1] Irena Bojmalieva, studente pas diplomimit në Fakultetin Juridik pranë Universitetit "Shën Qirili dhe Metodi" në Shkup, ndërsa është person me dëmtim të tërësishëm të parët, e-mail: bojmalieva.irena@gmail.com.
[2] Aneta Llambevska është studente pas diplomimit në Fakultetin Natyror-matematikor pranë Universitetit "Shën Qirili dhe Metodi" në Shkup, ndërsa është person me dëmtim të dukshëm të dëgjimit, e-mail: aneta_lmb@yahoo.co.nz.
[3] Biljana Manevska, diplomoi në Fakultetin Filologjik, grupi Gjuha angleze pranë Universitetit "Shën Qirili dhe Metodi" në Shkup, person pa ekstremitetet e poshtme të trupit, përdor karrocë invalidore, e-mail: bibismith@yahoo.com.
[4] Raull Kevriq, diplomoi pranë Fakultetit Juridik, Universiteti në Rjekë. Ai ka qenë kolumnist në e-Balkan, por para do kohe e humbi vendin e punës, e-mail: raul.kevric@mail.inet.hr.
[5] Daniella Stijanovska – Xhingovska, V. Sc. E defektologjisë, kryetare e Shoqatës së studentëve dhe të rinjve me handikap – Shkup, Maqedoni, e-mail: stojanovskad@gmail.com.
[6] Dr. Ivana Biliq, D.Sc. e ekonomisë, docente pranë Fakultetit Ekonomik, Universiteti në Split, e-mail: ibilic@efst.hr, ivanab13@yahoo.com.

këtë mënyrë, në rast të pushimit disa orësh, teknologjia e këtillë asistive i ndihmon studentit që në mënyrë të dobishme ta shfrytëzojë kohën e lirë për lexim në këtë kompjuter të përshtatur.

- Një nga problemet më të mëdha të studentëve me të parët tërësisht të dëmtuar është rreth ndjekjes së mësimit. Për dallim nga studentët të cilët nuk kanë dëmtim të parët dhe të cilët gjatë ligjëratave kanë mundësi të mbajnë shënime, për studentët me të parët e dëmtuar kjo paraqet vështirësi. Kjo pengesë do të tejkalohej më lehtë nëse studenti me të parët e dëmtuar ka diktafon dhe mund ta incizojë ligjëratën. Nga ana tjetër, ky opsion, përsëri është nën pikëpyetje, pasiqë jo secili profesor dëshiron të incizohet. Prandaj, do të ishte mirë që të gjithë profesorët që kanë kontakt me studentë me të parët e dëmtuar, t'u thuhet që të lejojnë incizimi e ligjëratave të tyre, e në këtë mënyrë studentit me të parët e dëmtuar t'ia lehtësojnë ndjekjen e mësimit. Gëzim të madh gjatë studimeve të mia para diplomimit, si dhe tani gjatë studimeve pas diplomimit paraqet se pjesa më e madhe e profesorëve më lejuan t'i incizoj ligjëratat. Përjashtim bënin vetëm një ose dy profesorë, të cilët nuk lejuan incizimin e ligjëratave të tyre.
- Sa i përket përgatitjes për provim, nga ajo që u tha më sipër, më së miri studenti me të parët e dëmtuar të ketë kompjuter, i cili është përshtatur për nevojat e tija me sintezë folëse. Në këtë mënyrë, profesorët do të mund t'i dërgonin materialet e privimit me anë të postës elektronike, që studenti në tërësi të jetë i pavarur gjatë të mësuarit dhe gjatë përgatitjes së materialit për provim. Përvoja ime me përgatitjen e provimeve gjatë studimeve para diplomimit ishte pak e komplikuar, pasiqë çdo provim duhej të incizohet n CD. Çdo libër duhej ta blija, që të mund të incizohej me zë. Kontribut të madh rreth incizimit të materialit të provimit dha "lidhja e personave të verbër të R. Maqedonisë", por kurrsesi nuk guxoj të mos e përmend edhe ndihmën e kolegëve dhe shokëve të mi. Në Lidhjen e personave të verbër, i gjithë materiali ishte incizuar në studio profesionale, që është pronësi e Lidhjes. Materialin e provimit e lexonin kolegët dhe shokët e mi, në fillim pa kurrfarë kompensimi, derisa më vonë Lidhja e të verbërve ndau mjete nga buxheti i tyre për personat që lexonin – për çdo orë të lexuar u jepte një shumë simbolike prej 120 denarëve. Tani, si student i studimeve pas diplomimit ky problem u tejkalua. Tani profesorët, materialin e provimit ma dërgojnë përmes postës elektronike, ndërsa për mua ky është lehtësim i madh dhe tërësisht më bën të pavarur. Për këtë u falënderohem edhe profesorëve dhe atyre që mundësuan përdorimin e lexuesit të ekranit (ANRIDER – UNREADER).
- Gjatë dhënies së provimeve duhet të vlejë e njëjta rregull, si edhe te studentët tjerë, të cilët nuk kanë dëmtim të parët. Profesorët gjithnjë duhet të jenë korrekt, në çdo kohë, të jenë të kapshëm për konsultime. Ata duhet ta kenë parasysh se, në krahasim me studentët me dëmtime të parët (të cilëve përgatitja e materialit iu është lehtësuar, pasiqë e kanë librin para vetes), studentëve me të parët e dëmtuar do t'u duhet më shumë kohë për përgatitje, pasiqë të njëjtin ose duhet t'u lexohet ose të aplikohet "lexuesi i ekranit" që gjithashtu kërkon më shumë kohë.
- Me qëllim që në mënyrë reale ta vlerësoni studentin sipas meritave të tija/saja, do të ishte e arsyeshme që dhënia e provimit për studentët me të parët e dëmtuar të realizohet gojarisht, në pajtim me rregullat e njëjta që vlejnë për të gjithë studentët, me pyetjen e materialit para të gjithë të pranishmëve. Në këtë mënyrë do të shmanget si profesori edhe studenti të gjenden në situatë të palakueshme, që do të aludonte lëshim, me qëllim që të merret notë më e lartë.
- Sa i përket qasjes deri te çështjet studentore, do të kisha propozuar që në tabelat për shpallje, të cilat janë në kuadër të çështjeve studentore, shpalljet të jenë të shkruara edhe me Alfabetin e Brajit. Përvoja ime është se kolegët mi lexonin kumtesat lidhur me atë se kur janë caktuar provimet ose ndonjë informatë tjetër. Megjithatë, duhet të përmend se çdo herë kur i kam pyetur të punësuarit në çështjet studentore, jam informuar në mënyrë korrekte.
- Rreth jetës sociale në fakultet, pasiqë gjatë pauzave shkonim për kafe ose për mëngjes në bufenë e fakultetit, do të ishte mirë që menyja të ishte shkruar edhe në Alfabetin e Brajit, me qëllim që t'u lehtësohet studentëve me të parët e dëmtuar. E njëjta do të mund të aplikohet edhe në objektet hotelerie. Për t'u përshëndetur është se disa kafene dhe restorante në kryeqytet tashmë e aplikojnë këtë metodë praktike.

2) Arritja në fakultet dhe prapa

- Arritja dhe kthimi nga fakulteti është një nga problemet më të mëdha për personat e verbër. Problemi paraqitet që nga largimi nga vendbanimi. Në të vërtetë, që të arrihet deri në fakultet, ata duhet të arrijnë deri te stacioni i autobusit, që të arrijnë deri aty ata ballafaqohen me situata të pakëndshme siç janë: personi edhe pse ka orientim të mirë në hapësirë, nuk është i sigurt nëse në rrugën nëpër të cilën lëvizë ka automjet të parkuar ose ndonjë gropë etj.
- Pas arritjes në stacionin e autobusit ata janë të detyruar ta pyesin ose ta lusin ndonjërin nga të pranishmit t'u thotë kur do të arrijë autobusi. Për fat të keq, në kryeqytet dhe në gjithë R. Maqedonisë në asnjë stacion autobusi nuk ka informim me zë për arritjen e autobusit të qytetit. Në vendet e zhvilluara, arritja e autobusit alarmohet me sinjal të zëshëm, për personin me të parët e dëmtuar të tërësishëm që të mund të jetë i pavarur nga ndonjë person tjetër dhe të und të lëvizë pavarësisht.
- Nga ajo që u tha më sipër, zgjidhja e problemit rreth arritjes dhe kthimit nga fakulteti për personat e të parët e dëmtuar, praktikisht do të thotë zgjidhja e kaosit të komunikacionit dhe infrastrukturës që sundon për momentin. Arritja dhe kthimi im deri dhe nga fakulteti, shpesh ka qenë i shoqëruar nga kolegët ose shokët e mi. Për fat të keq, ende nuk jam në situatë që këtë ta bëjë vetë.

3) Vendosja dhe qasja në konvikt

- Konviktet studentore duhet të jenë të adaptuar ose të kenë qasje për personat me të parët e dëmtuar. Është e nevojshme që t'u lehtësohet vendosja e tyre në dhoma një krevatesh ose dy krevatesh.
- Në ashensorë duhet të instalohet softueri i zëshëm, që kur të ndalet lifti në cilindo kat, personat me dëmtim të parët të mund ta dëgjojnë dhe nuk duhet t'i pyesin të pranishmit në cilin kat është ndalur lifti. Në të vërtetë, ndonjëherë ndodh që në ashensor mos gjendet askush, e atëherë janë të detyruar të gjinden vetë, e jo çdo person me të parët e dëmtuar është i aftë ta bëjë këtë. Gjithashtu, në ashensorët në çdo buton ku janë numëruar katet të ketë edhe numra në Alfabetin e Brajit, që personat me të parët e dëmtuar të mund të gjinden më lehtë, që për fat të keq në konviktet studentore nuk i plotëson këto kritere.
- Të gjitha shenjat, mbishkrimet, emrat dhe numrat në mënyrë plotësuese duhet të shkruhen edhe në Alfabetin e Brajit, me çka do të mundësohej lëvizja e papenguar e personave me të parët e dëmtuar nëpër kampin dhe konviktet studentore.

Përvoja personale, perspektiva dhe sugjerimet e personit/studentit me të dëgjuarit e dëmtuar

Si student i diplomuar në Fakultetin Natyror-matematikor, për momentin në studime pas diplomimit në fakultetin e njëjtë, në tekstin që vijon do të përpiqem të përmend përmes rasteve pozitive dhe negative me të cilat jam ballafaquar gjatë procesit tim arsimor, e veçanërisht gjatë studimit.

Që të mund të lehtësohet bashkëpunimi me personat që kanë problem me të dëgjuarit, si këshillë deri te profesorët, ua rekomandoj këtë që vijon:

- Para së gjithash, hapi i parë dhe më i rëndësishëm, në mënyrë të barabartë duhet të trajtohen studentët të cilët kanë probleme me të dëgjuarit dhe studentët që aspak nuk kanë problem të tillë. Nëse kjo nuk praktikohet, do të paraqiste problem serioz në komunikimin e ndërsjellë, si mes vetë studentëve, ashtu edhe mes profesorit dhe studentëve. Për fat të keq, e gjithë kjo do të jetë në dëm të studentit me të dëgjuarit e dëmtuar.

- Nëse vëreni student i cili Ju ndjek me vështir5ësi gjatë mësimit, menjëherë të reagoni dhe të vendosni kontakt me atë, të bisedoni rreth problemit dhe të gjeni zgjidhje si t'i tejkaloni vështirësitë rreth mësimit. Edhe pse është e drejt dhe rekomandohet, studenti vetë të paraqitet dhe ta thotë problemin e tij. Megjithatë, vetë mentaliteti i këtyre hapësirave ballkanike nuk lejon që studenti të ketë guxim dhe ta thotë problemin e tij. Ende nuk gjendemi në nivel mjaft të lartë të vetëdijes rreth kësaj problematike dhe që në fillim ka shumë çështje që duhet të përpunohen dhe të përgjigjen. Ne vetë jemi fajtor për shkak se shumë shpesh e anashkalojmë këtë problem si fakt. Para së gjithash, në gjithë konstatimin ndikon rrethina, fakulteti si mjedis, ndërsa më së shumti kolegë dhe profesorët me të cilët ka kontakt çdo ditë vetë studenti me të dëgjuarit e dëmtuar. Mu për këtë, ata janë më përgjegjës për raportin e drejt dhe ndihmën, që duhet të vendosen dhe prej tyre duhet të dalin iniciativa për zgjidhjen graduale e të gjitha problemeve me të cilat ne ballafaqohemi çdo ditë.
- Do të ishte mirë që të bisedoni me kolegjiumin për problemin e studentit me të dëgjuarit e dëmtuar dhe të gjeni zgjidhje të përbashkët si t'ia lehtësoni procesin e studimit, e me këtë edhe t'i ndihmoni vetes, pasiqë me forca të përbashkëta dhe komunikim të përditshëm, këshillim të ndërsjellë mund ta arrini qëllimin e dëshiruar dhe ëndrrën e çdo studenti, e kjo është ta kryejë fakultetin e tij.
- Të shprehni vullnet dhe diskonim për bashkëpunim të mirë. Kështu studenti do të mund ta ndjejë lirinë që t'ju drejtohet për problemin e vet dhe rreth pengesave ose vështirësive gjatë mësimit. E gjithë kjo kontribuon për feed-back bashkëpunim më të mirë dhe më të lehtë.
- Rekomandojmë që në asnjë rast të mos niset me ndjenje të keqardhjes, përbuzjes, tallje, lëshimit (për marrjen e notës më të lartë). Përkundër, është e nevojshme që studentit me të dëgjuarit e dëmtuar t'i jepet mundësi e barabartë që ta prezantojë diturinë e vet dhe në asnjë rast studenti të mos diskriminohet dhe me dyshim se nuk është i/e aftë që ta kryejë arsimin e vet. Do të thotë, rekomandojmë, raport të tërësishëm të barabartë, si dhe për të gjithë studentët tjerë.
- Gjatë ligjëratave, është mirë që studenti që ka problem me të dëgjuarit ta ulet përpara, të mund t'i ndjek ligjëratat dhe mësimin praktik, profesori të jetë në afërsinë e tij/saj: kur ligjëroni të flisni qartë, mjaft me zë, ngadalë dhe rrjedhshëm. Të ktheheni drejt tij që të mund t'ju ndjek me të folurit e gojës, në këtë mënyrë ia lehtësoni ndjekjen e mësimit. Të gjitha aktivitetet duhet të realizohen në mënyrë normale dhe pa theksim para të gjithëve. Gjithashtu, studentit me të dëgjuarit e dëmtuar është mirë që t'i ofroni të ketë konsultime pas ligjëratave dhe ushtrimeve dhe kështu të kontribuoni që të tejkalohen pengesat dhe paqartësitë që kanë ndodhur gjatë mësimit.
- Gjatë provimit, pa marrë parasysh nëse ai është menduar me shkrim dhe me gojë ose është provim praktik, ju rekomandojmë që studenti me të dëgjuarit e dëmtuar të trajtohet i barabartë me të gjithë studentët tjerë, të cilët nuk kanë problem me të dëgjuarit. Nëse bëhet fjalë për provim me shkrim nuk do të paraqiste problem, por nëse është provim me gojë kushtoni vëmendje nëse ka nevojë dhe Ju duket se studenti nuk mund t'ju ndjekë. Disa herë përsëritni pyetjen, tregoni durim dhe mundohuni pa vështirësi ta bëni këtë, d.m.th. t'i lejoni studentit ta shprehë mendimin e vet pa i ndihmuar ose pa i lëshuar pe. Si shembull nga përvoja ime do të kisha theksuar se shpesh gjatë provimeve me gojë, para se të përgjigjet në pyetjen jepet koncept me shkrim me pyetje për studentin që të ketë kohë të mjaftueshme si dhe të gjithë studentët tjerë, mirë të mendohet para se të përgjigjet në pyetjet e dhëna. E njëjta ka të bëjë edhe me pjesën praktike të provimit.
- Në asnjë rast, të mos lejoni që studenti ta keqpërdor problemin (handikapin) e tij. Nga përvoja jonë shumëvjeçare si profesor, vetë do të vlerësoni nëse studenti e ka merituar ta kalojë provimin ose jo dhe me cilin çmim.
- Nëse profesori gjatë mësimit ka pjesë ku studenti e mbindërton kualitetin dhe njohurinë me realizimi e prezantimeve, ndërsa është pjesë e domosdoshme dhe e paraparë për formimin e notës përfundimtare për atë lëndë, në asnjë rast mos lihet anësh studenti me të dëgjuarit e

dëmtuar dhe të mos supozohet që ai/ajo nuk është i/e aftë që ta realizojë atë. Përkundër, është e nevojshme që t'i jepet nxitje dhe inkurajim që ta bëjë atë hap dhe me këtë të dëshmoni se është i/e barabartë me studentët tjerë.

- E njëjta ka të bëjë edhe kur vetë lënda kërkon: vizitë në aksione në terren me pjesëmarrje në aktivitete terreni dhe mundësi për zgjerimin njohurive dhe interesimit për fushë të caktuar nga shkenca; përpunimi i punëve seminariste; pjesëmarrje në seminare, konferenca, simpoziume shkencore, kongrese: aktivitete në ndonjë shoqatë shkencore; përpunimi i punimeve shkencore. E gjithë kjo ndihmon në mbindërtimin e diturisë dhe kualitetit të studentit gjatë mësimit dhe mundësi që t'i shprehë aftësitë dhe kualitetet e tija.
- Gjithnjë ta keni parasysh se ballafaqimi me problemin e dëmtimit të dëgjuarit aspak nuk është e lehtë. Përkundrazi, kjo është për t'u përshëndetur, ndërsa Ju me këtë qasje pozitive do të ndihmoni dhe do të kontribuoni në humanizmin tuaj, para së gjithash, si njeri, ndërsa pastaj si profesor dhe pedagog.
- Asnjëherë nuk duhet të harroni se megjithatë ka kategori të ndryshme të dëmtimit, por edhe se ka studentë me shkallë të ndryshme të gatishmërisë për të mësuar. Në pajtim me këtë, Ju si intelektualë në arsim, do të vlerësoni nëse studenti ka kapacitet dhe mundësi të studiojë ose është me aftësi mesatare intelektuale. Gjithsesi, nuk duhet të harrohet se nëse personi/studenti me të dëgjuarit e dëmtuar ka arritur nderi te arsimi sipëror do të thotë se është i aftë dhe ndjehet i gatshëm ta vazhdojë arsimimin e tij. Ju me intelektin dhe humanizmin tuaj, vetëm duhet t'i ndihmoni kolegut tuaj të ardhshëm, bashkëpunëtorit dhe akademikut ta nxirrni në rrugë të drejtë në këtë botë.

Për këtë që e them dhe e shkruaj kam arsye të vërtetë. Kjo nuk është trillim por situatë reale jetësore (tregim), që përpiqem t'ua afroj nga përvoja ime si student i diplomuar, ndërsa për momentin edhe në studime pas diplomimit, që edhe krahas handikapit tij, kam arritur deri në këtë nivel.

Që kur kam lindur përdor aparat në të dy veshët. Bie në grupin e personave me dëmtim të rëndë të dëgjuarit, prej 60 deri 80 Db, te të cilët dëmtimi i të dëgjuarit ka ndodhur para se të zvillohet të folurit, do të thotë persona të cilët para dëmtimit të dëgjuarit në mënyrë spontane nuk e kanë zhvilluar të folurit verbal, por pastaj me trajtim intensiv dhe sistematik surdo-audiologjik e kanë arritur këtë. Trajtimi rehabilitues intensiv prej dhjetë viteve në Entin për dëgjim, të folurit dhe zë – Shkup më ndihmuan ta zhvilloj komunikimin verbal dhe me sukses solid ta përfundoj arsimin tim të deritanishëm. Këtë nuk do ta arrija pa ndihmën e nënës sime, që më nxori në rrugë të drejtë dhe pa atë nuk do të isha ajo që jam. Duke i falënderuar mbështetjes së saj të pafund, durimit dhe dashurisë, të paraqes sukses për atë, për familjen time dhe për veten. Edhe për shkak të faktit se çdo prind e dëshiron të mirën për fëmijën e tij, nuk mund të përshkruhet energjia e saj e pashterur dhe durimi me të cilën më mundësuan të zhvillohem në personalitet normal; të jem e pranuar nga shoqëria dhe duke i falënderuar mbështetjes së madhe, para së gjithash nga familja, nxënësit, kolegët, arsimtarët dhe profesorët: ta kaloj procesin jetësor që nga kopshti, arsimi fillor, arsimi i mesëm, e deri në fakultet. Shumë pak është të them një faleminderit dhe janë të pakta fjalët që të përshkruhet rruga me gjemba nga lindja, deri në ditën ne sotme.

Shpresoj se ky nën-kapitull, me të cilën unë personalisht u angazhova, si e prekur nga ky problem, Ju ndihmova dhe u lehtësova të paktën pak që t'ju them si të veproni me studentët që kanë dëmtim në të dëgjuarit.

Përvoja personale, perspektiva dhe sugjerimet e personit/studenti me invaliditet trupor

Nga koha studimeve të mia në Fakultetin Filologjik, Grupi i gjuhës angleze pranë Universitetit "Shën Qirili dhe Metodi" në Shkup, kaluan shumë kohë dhe për fat të mirë ndërkohë ndryshuan shumë punë për të mirë. Këtë e them si person, për shkak të humbjes së ekstremiteteve të poshtme, vazhdimisht

përdor karrocë invalidore. Në kohën kur studioja, ndërtesa e Fakultetit Filologjik aspak nuk kishte qasje (për fat të mirë sot nuk është ashtu) për personat me karrocë, nëse të njëjtit nuk i ndihmohet që të hipë shkallëve të shumta jo vetëm në hyrje, por edhe brenda në objekt. Për fat të mirë, këmbëngulësia ime dhe jo vetjakësia dhe flijimi i prindërve të mi nuk lejuan që pengesat si shkallët, dyert e ngushta, tualeti joadekuat të jenë edhe pengesë për studimin tim të mëtejshëm dhe përfundimin e fakultetit.

Duhet përmendur se u regjistrova si studente e çrregullt, që ishte zgjidhja ime e vetme për mua si banore e një qyteti tjetër. Në kontekst të kësaj, kisha dashur të ndërlidhem me njërin nga problemet që i kanë personat me invaliditet trupor, veçanërisht ata që lëvizin vështirë – personat që përdorin proteza dhe paterica, e më së shumti ata me invaliditet të rëndë trupor d.m.th. personat që përdorin karrocë invalidore, e kjo është mungesa e kushteve për transport publik në vendin tonë. Për fat të mirë, në Shkup ky problem nuk ndjehet aq shumë sepse prej para do kohe ekzistojnë autobusë të ulët, me çka është lehtësuar jeta e këtyre personave në pikëpamje të transportit në vetë qytetin. Për fat të keq, kjo nuk është kështu në qytetet tjera dhe unë, si edhe kolegët e mi të cilët nuk jetojmë në Shkup jemi të detyruar të shfrytëzojmë transport me automjet, pasiqë transporti publik (treni, autobusi) aspak nuk është i përshtatur për këtë kategori të personave. Kjo nuk është vetëm shprehje e diskriminimit, por kërkon mjete plotësuese financiare për vetë personat me invaliditet trupor. Vetëm si krahasim – çmimi për transport nga njëri vend në tjetër me tren ose me autobus është shumë më i ulët se sa ai me automjet.

Ka shumë nga kolegët e mi të cilët drejtojnë automjet të përshtatur me komanda dore, por jo të gjithë e kanë këtë mundësi. Në pikëpamje të kësaj do të duhej çdo fakultet të ketë parking të caktuar, ku do të parkohen vetëm personat me shenjë adekuate të automjetit të tyre dhe gjerësi adekuate, si do të mund të hapej dera e automjetit, që personi të mund të transferohet me siguri nga ulësja e automjetit në karrocë dhe anasjelltas. Këtë e theksoj pasiqë është vështirë që personi në karrocë të hyjë në automjet nëse hapësira mes automjetit të tij dhe atij fuqi është aq i vogël sa vetëm pjesërisht mund ta hapë derën, që është mënyra më e shpeshtë e parkimit në mjediset tona. Sa herë më ka ndodhur që nga ana e majtë, gjegjësisht ana e vozitësit të automjetit tim, të parkohet automjet tjetër aq afër sa është e vështirë edhe për personin që nuk është në karrocë të hyjë në atë, e kështu jam e detyruar të lusë dikë që ta zhvendos automjetin, që të mund të transferohem me siguri në ulësen e automjetit. PRANDAJ, nëse vëreni se në automjetin e parkuar është vendosur shenjë, që është simbol ndërkombëtar për person që përdor karrocë invalidore, do të ishte mirë që të parkohen në distancë adekuate, që t'i mundësoni personit qasje deri te automjeti i tij.

Gjithashtu, këtu duhet të përmenden edhe barrierat e shumta arkitektonike me të cilat ballafaqohemi çdo ditë, veçanërisht jashtë, gjatë lëvizjes në rrugë pasiqë nuk ka shtigje adekuate për lëvizje, rrugët dhe trotuaret janë shumë të larta, shpesh me pengesa, p.sh. nëse intervenohet në ndonjë trotuar ose rrugë, të njëjtat sipas rregullës janë groposur pa u siguruar shteg rezervë ku do të mund të lëviznin lirë qytetarët, e veçanërisht personat me ndonjë invaliditet ose pengesë (të verbrit, ata që lëvizin vështirë). Do të thotë, nëse student në karrocë invalidore vendos të vijë në fakultet vetë, kjo nuk do të ishte e mundur nëse nuk bëhen përpjekje që të rregullohet infrastruktura e komunikacionit, e kjo, me përjashtime të vogla, vlen pothuaj për të gjitha qytetet në R. e Maqedonisë.

Nga kjo hyrje pa e gjatë do të dalin edhe rekomandimet e mia për qasjen e lehtësuar në arsimin sipëror për studentët me invaliditet trupor, veçanërisht për ata që përdorin karrocë invalidore.

- Së pari, qasja fizike deri te ndërtesa, d.m.th. nëse te hyrja ka shkallë, duhet të qëndrojë edhe shteg adekuat për qasje e ndërtuar sipas të gjitha normave dhe standardeve që personi në karrocë (me dorë ose me fuqi motori) të mund me siguri dhe pa mund të madh të hyjë në ndërtesën e fakultetit. Shtegu shumë i pjerrët mund të jetë shumë i pasigurt, bile edhe i rrezikshëm për personin që ngjitet nëpër të njëjtin vetëm me forcën e dy duarve. Do të ishte e pëlqyeshme që nga njëra anë e shtegut të ketë edhe dorezë në lartësi adekuate, që do të ishte prej ndihmës së madhe edhe për personat të cilët përdorin paterica në lëvizjen e tyre.

- Ashensorë të përshtatur, elevatorë ose platforma në shkallët, si do të sigurohej që të gjitha ambientet në ndërtesën e fakultetit të jenë të qasura për personat që përdorin karrocë invalidore.

- Dera hyrëse (dhe të gjitha dyert në ambientet e ndërtesës) të jenë mjaft të gjera dhe të mund të hapen lehtë, që mos të vijë deri te dëmtimi i saj ose deri te lëndimi i padëshiruar i personit, që nuk do të ishte në mundësi të intervenojë shpejt nëse dera mbyllet papritur, nuk hapet sa duhet ose nevojitet mund i madh që të hapet.

- Qasje e pa penguar deri te të gjitha ambientet në ndërtesën e fakultetit, do të thotë deri te klasat/amfiteatrit/kabinetet e profesorëve/bibliotekat/laboratorit/shërbimin për çështje studentore/restoranti etj.

- Tualet i adaptuar në mënyrë adekuate, d.m.th. derë mjaft e gjerë, mbajtës të siguruar afër tualetit, hapësirë brenda për personin që përdor karrocë invalidore që të mund të manovrojë lehtë dhe në mënyrë të sigurt dhe ta ketë privaten e domosdoshme.

- Në klasat/vendet për lexim/bibliotekat/laboratorit të ketë hapësirë të mjaftueshme që personi që përdor karrocë të mund të manovrojë, të lëvizë dhe të shkëmbehet. Gjithashtu duhet të kihet kujdes të ekzistojnë tryeza/banka me lartësi adekuate ku personi/studenti në mënyrë komode do të vendoset pa u ulur dhe mundim pa nevojë.

- Jo të gjitha raftet në bibliotekë ose laboratori janë të kapshme, gjegjësisht shumë të larta dhe kjo do të paraqiste problem të madh nëse nuk bëhen përpjekje që të njëjtat të kenë mekanizëm rrëshqitës, ose platforma të mundshme, me ndihmën e të cilave personi që përdor karrocë invalidore do të vinte në nivel të caktuar të lartësisë (supozoj se kjo shumë pak mund të realizohet te ne); në të kundërtën, duhet të ekzistojë vullnet i mirë nga personi që punon atje ose ndonjë koleg t'i ndihmojë nëse personit në karrocë i nevojitet ndonjë material, libër ose send që është vendosur shumë lartë.

- Në pikëpamje të qasjes do të kisha dashur të përmend se gjatë studimeve të mia kishte vetëm një profesoreshë e cila insistonte që provimi të mbahet në katin e sipërm, ndërsa profesorët tjerë, kabinetet e të cilëve gjendeshin në katin e sipërm ose në krahët ku kishte shkallë, ishin shumë fleksibël dhe na dilnin në ndihmë kur duhej ta jap provim gojarisht ose me shkrim, shprehnin vullnet të mirë dhe e organizonin provimin në bibliotekë ose në ndonjë zyrë në katin përdhes. Nënkuptohet se vetë provimet ishin të njëjtë si dhe për studentët tjerë, pa kurrfarë lëshimesh për shkak të gjendjes sime.

- Nëse sigurohen të gjitha parakushtet në pikëpamje të qasjes, nuk ekzistojnë probleme më të mëdha që personi në karrocë të vijë deri në fakultet, ta ndjekë mësimin dhe ti jap provimet e parapara (këtu duhet të përmend se personave që iu është diagnostifikuar kuadriplegia pse spastia dhe kanë vështirësi me motoriken e pëllëmbëve duhet t'u sigurohet më shumë kohë për të shkruar).

- Gjatë qëndrimit më të gjatë me person që përdor karrocë invalidore është e nevojshme që bashkëbiseduesi të ulet, si do t'i kishte kushtuar më shumë vëmendje dhe respekt ndaj vetë personit.

- Nëse studenti vjen nga ndonjë vend tjetër dhe dëshiron të qëndrojë në konvikt studentor në vend që të udhëtojë me automjet (për shkak të mos pasjes së transportit të përshtatshëm publik ndër urban), është e domosdoshme që edhe vetë ndërtesa e konviktit t'i ketë këto specifika në pikëpamje të qasjes siç u përmend më sipër (vetëm përsëritje e shkurtër – shteg me qasje, dyer të gjera, krevat mjaft të lartë, do të ishte ideale në lartësi të karrocës, tualet i adaptuar dhe

banjë në dhomë, dollap me rafte mjaft të ulëta si dhe sirtarë, shteg për rrymë elektrike në nivel të ulët etj.).

- Nëse vëreni person/student që përdor karrocë invalidore, ku juve ju duket se ndoshta ka ndonjë problem, ofroni ndihmën tuaj, por mos prisni që e njëjta të mos pranohet me dashamirësi ose të refuzohet. Në rastin e parë, kërkoni instruksione si ti ndihmoni më së miri sipas jush dhe për personin në karrocë, i cili e di cila është mënyra më e mirë, me cilën teknikë, fuqi dhe pa problem me dhe ndonjë dëm që të bëhet aktiviteti i duhur (për shembull me siguri të lëshohet ose të ngjitet në shkallë, ose ti ndihmohet ta vendos karrocën në automjet). Nëse oferta juaj për ndihmë refuzohet me dashamirësi, lirisht pranoni këtë pa u hamendur. Mos insistoni, pasiqë është normale që personi në karrocë të dijë ta kalojë ose jo ndonjë pengesë.

- Gjatë përvojës time shumëvjeçare si person që përdor karrocë invalidore, në të gjitha aktivitetet e mia të përditshme në shtëpi dhe jashtë jam gjetur në shumë situata që të kërkoj ose të më ofrohet ndihmë: (1) nga ata që dëshirojnë të ndihmojnë, por nuk e dinë se si – me personat e tillë komunikimi dhe mirëkuptimi është lehtë, vetëm nevojitet t'u jepen instruksione të drejta për atë se si ofrohet ndihma; (2) nga ata që dëshirojnë të ndihmojnë, por nuk munden dhe vetë kanë ndonjë problem shëndetësor (diskopati, sëmundje të zemrës); derisa (3) ekzistojnë edhe të tillë që nuk dëshirojnë të ndihmojnë, që nuk është e drejtë. Kuptohet edhe kjo duhet të pranohet në mënyrë të zakonshme, sepse, në fund të fundit, të gjithë jemi njerëz me të gjitha mangësitë dhe mirësitë tona.

- Është njerëzore të kërkohet ndihmë, siç është njerëzore të ofrohet dhe të pranohet ndihma e ofruar. Mendoj se kjo vlen për të gjithë njerëzit dhe për të gjitha segmentet nga jeta. Secili ndonjëherë është gjetur në situatë të ngjashme, pa marrë parasysh nëse bëhet fjalë për person me ndonjë pengesë ose jo. Por, gjithashtu, është njerëzore edhe të respektohet dëshira e personit me invaliditet trupor (dhe jo vetëm trupor) që ta ruajë pavarësinë e tij dhe privaten, e kjo mund të arrihet kryesisht me ndryshimin e vetëdijes te njerëzit, me gatishmërinë e tyre që të jenë njerëz me shpirt të hapur, pa kufizime dhe pa paragjykime. E pastaj me ndryshimin e mjedisit fizik, veçanërisht me ndërtimin e objekteve të reja qoftë të bëhet fjalë për institucione shëndetësore, arsimore ose shoqërore ose nga fusha e sportit, zbavitjes dhe jetës shoqërore të individit.

- Prandaj, profesorët të nderuar, mos u ngushtoni të vendosni kontakt me person me invaliditet trupor, në të vërtetë, si edukatorë dhe pedagogë, kjo në njëfarë mënyre është obligimi Juaj.

- Studentë të nderuar, shfrytëzoni mundësinë që të njoftoheni me kolegun Tuaj, i cili ka ndonjë invaliditet, duke përfshirë edhe personin në karrocë, jam i sigurt se në shumicën e rasteve do të befasoheni këndshëm dhe do të keni mundësi të mësoni se pamja e jashtme pothuaj sipas rregullës asnjëherë nuk është reflektim i asaj që e kemi në vete. Çdo situatë tejkalohet, nevojitet vetëm pak mendje e shëndoshë dhe praktike, e me siguri të madhe pohoj se pjesa më e madhe e personave me invaliditet këtë e posedojnë.

Përvoja persona dhe sugjerimet e personit/studentit me pengesa të kombinuara:

"Tung, si jeni?"[7]

Shpeshherë disa njerëz më drejtojnë kritika se duhet të jem më i sjellshëm ndaj njerëzve të cilët ma ofrojnë ndihmën e tyre derisa eci nëpër rrugë, si dhe se duhet të punoj më shumë në shkathtësitë e mia sociale, e veçanërisht në pikëpamje të atyre bisedave joformale dhe të filloj biseda rreth asaj se si është moti. E shkruaj këtë që të mund t'i prezantoj disa nga situatat e mia, gjithsesi perspektivë shumë unikate, pasiqë shpesh njerëzit më akuzojnë se jam i pakulturuar, bile edhe snob.

Edhe pse të ecurit nuk më paraqesin ndonjë problem, unë lëviz në një mënyrë specifike për mua. Për shembull, unë nuk mund të qëndron nëse nuk mbështetem në diçka ose te dikush ose mund ta bëjë këtë, por me përqendrim maksimal, kur fokusohem vetëm në të ecurit dhe në asgjë tjetër. Në të kundërtën, kur do të ndalem, unë automatikisht bie. Para do kohe, udhëtoja për në Zagreb, e pasiqë tezja ime punon në një qoshk për gazeta në stacionin e autobusëve në Rjekë, më vërejti dhe thërriti pas meje. Unë vetëm kalova përreth qoshkut, thash "Tung!" dhe vazhdova të eci drejt autobusit, i cili qëndronte në stacion. Kur u ktheva në shtëpi, u bë një dramë e vërtetë rreth asaj se është dashur të jem e sjellshme ndaj tezes sime, e cila ishte ankuar ndaj sjelljes sime.

Ndërsa ja çfarë ndodhi në të vërtetë: Në çastin kur më pa tezja, unë tashmë isha me mendimet në Zagreb dhe as që vërejta afër cilit qoshk kaloj, e as që prisja që dikush do të më drejtohet. Kur e vërejta, mënyra e vetëm në të cilën mundesha të qëndroj ishte ta hedh gjithë peshën time në qoshkun e mallkuar dhe të bëj rrëmujë nga gazetat. Kjo nuk mu duk si ide e mirë. Unë mund të qëndroj normal vetëm kur mbështetem në derën e parme të autobusit. Supozoj se nga ai moment unë do të isha në situatë të kthehen dhe të gjej ndonjë vend prej ku do të mund të shkëmbeja ndonjë fjalë me tezen time. Por, për turpin tim, kurrsesi nuk mund ta bëja këtë vetëm që të përgjigjesha në pyetjen "Si je?" ose diçka të ngjashme që sigurisht ajo do më pyeste nëse do të gjendeshim në ndonjë situatë më të përshtatshme. Relativisht shpesh gjenden në situatë të tillë të moskuptimit me të njohur të ndryshëm, të cilët më takojnë në qytet dhe të cilët janë të shokuar kur më shohin se nuk ndalem të bisedoj pak dhe të përfundojmë se sot moti është i mirë. Një nga shkaqet pse nuk e bëj këtë përpjekje plotësuese është edhe bindja se shumicës as nuk i bëhet vonë për atë se ndjehem në atë moment të caktuar, ose çfarë mendoj për motin sot. Kjo nuk do të thotë se unë jam kundër bisedës me njerëzit, por jo gjithnjë e kam lehtë ta mbaj baraspeshën time vetëm për shkak të disa formaliteteve. Një nga mundësitë që e kam në situata të tilla është të mbështetem te personi që e kam takuar, por nuk jam i afërt me secilin, e ndonjëherë, ai, tjetri diçka mban në duar dhe nuk është i gatshëm për situatën ashtu siç nuk jam edhe unë.

Kuptohet problemi ka edhe disa aspekte tjera, ndërsa njëri prej tyre është edhe fakti se e ecura për mua kërkon energji më të madhe se sa te njeriu mesatar. Nëse lëvizë dhe njëkohësisht mendoj për diçka, unë shpesh nuk kam energji të mjaftueshme të shoh përreth dhe ta vërej secilin që kalon afër meje dhe ta përshëndes. Zakonisht vetëm dëgjoj nga largësia "Ej, Raul!", e derisa eci nuk mund të kuptoj kush më drejtohet.

Edhe një moment tjetër, shumë i rëndësishëm lidhur me këtë, është edhe nevoja ime që ta mbroj privaten time dhe integritetin personal. E di se kjo tingëllon shumë në mënyrë melo-dramatike, por ja çfarë është thelbi: Njeriu mesatar i cili ecë nëpër rrugë zakonisht mund të llogarisë në atë se ka mjaft private që të përqendrohet në mendimet personale. Nëse nuk hasni në ndonjë të njohur, pothuaj të gjithë jeni të sigurt në faktin se mendimet Tuaja nuk do të ndërpriten në mënyrë të ashpër nga ndonjë i

[7] Teksti është dërguar nga dr. Ivana Biliq, si kontribut nga z. Raul Kevriq për Projektin tonë AEIF.

panjohur. Unë nuk e kam këtë luks dhe asnjëherë nuk e kam pasur, edhe pse më duhet kohë që të mendoj dhe të përgatitem për ngjarjet e ardhshme, si dhe çdo tjetër. Dua apo s'dua, në jetën time hyn një armatë e vogël njerëzish, të cilët kalojnë përreth meje në rrugë, dhe të cilët asnjëherë nuk do të më drejtoheshin nëse, në ndonjë rast tjetër, do të lëvizja në mënyrë normale. Disa njerëz më afrohen në mënyrë normale dhe mendoj se ata janë të sjellshëm. Disa janë me mendime të këqia dhe më drejtohen me fjalë shumë bizare. Bile disa më kaplojnë me keqardhje të madhe dhe e praktikojnë qasjen me "bamirësi", ndërsa në të vërtetë arrijnë të bëjnë nervoz tej mase. Disa dëshirojnë t'i edukoj dhe më shtrojnë pyetje për gjendjen time shëndetësore, ku disa kanë kuptim, derisa të tjerat janë të pakuptimta. Disa janë fanatikë religjioz, të cilët më japin afishe për seminare shpirtërore dhe seanca për shërim. Disa më ofrojnë të holla ose bonbone pasiqë më llogarisin të pa endacak ose lypës. Disa janë të marrë dhe agresiv dhe me fuqi më detyrojnë t'i mbaj për dore. Disa pëshpëritin mes vete duke menduar se nuk mund t'i dëgjoj. Një herë dëgjova se si dy gra haheshin nga fakti se prindërit e mi më kanë lëshuar jashtë pa më kontrolluar njeri. Isha i rritur kur ndodhi kjo.

Nuk e refuzoj komunikimin me të gjithë ata. Me disa bisedoj dhe shpesh i edukoj njerëzit e thjesht. Varet nga ajo si ndjehem dhe ku shkoj në atë moment të caktuar. Me të vërtetë vlerësoj ata që ma ofrojnë ndihmën e tyre me qëllim të mirë dhe ndjenjën e diskrecionit, si dhe ata që më ndihmojnë kur kam nevojë për ndihmë. Nuk i respektoj shumë ata që bëjnë shumë zhurmë rreth asaj që të më ndihmojnë, vetëm sa t'i tregojnë botës se janë të mirë dhe bamirës. Ata me buzë në gaz i quaj "samarianët e mirë".

Samarianët e mirë më ofendojnë me marrëzinë dhe agresivitetin e tyre, ndërsa ndonjëherë thjesht nuk e marr përsipër të edukoj dikë kur rastësisht e takoj në rrugë. Ka momente kur do ta kisha bërë këtë, por nuk ia vlen pasiqë kam ndër mend gjëra të tjera. Ndonjëherë mekanizmat e mia mbrojtëse punojnë më shumë se sa duhet dhe unë jam i pasjellshëm ndaj dikujt që nuk e meriton atë, por edhe unë mund ta vlerësoj çdo situatë në mënyrë të drejtë. Një nga gjërat e vogla që me të vërtetë më mungojnë për shkak të handikapit tim është e drejta të jem dhe të mendoj në mënyrë të pavarur, diçka që shumica e marrin si të gatshme. Mendoj se nuk është fer të pritet nga unë që ta përqesh dikë që e takoj në rrugë, përgjigjem me durim ndaj pyetjeve dhe komenteve, bile edhe të pyes "Si jeni?" E di që secili ndonjëherë e bën këtë, e bëj edhe unë, por nga unë kërkohet që vazhdimisht ta bëj këtë. Dhe secili thjesht ofendohet pasiqë kam vendosur që pikërisht atë prej të gjithë njerëzve në botë ta anashkaloj.

Një herë, dikush u përpoqe ta zgjidh problemin dhe më propozoi t'i lejoj të gjithë njerëzve të më ndihmojnë, qoftë e nevojshme ose jo kjo, që të shpëtoj nga të gjitha diskutimet. Por, atëherë njerëzit do të fitojnë edhe më shumë paragjykime kur do të shohin se vazhdimisht më nevojitet ndihma e tyre. Përveç kësaj, e kam shumë më lehtë t'i kryej punët vetë se sa dikush të më ndihmoj, pasiqë njerëzit shpesh nuk janë të njoftuar dhe të pakujdesshëm dhe shpesh më qasen sikur të jem tërësisht i paralizuar, duke u përpjekur ta mbajnë gjithë trupin tim, që vetëm i keqëson punët për mua, pasiqë më marrin si trup. Unë nuk jam as i vogël, e as i lehtë e as i dobët dhe nuk ka nevojë të më tërheqin, e as unë nuk e kam të lehtë të më tërheqin. Nëse nuk më besoni, provoni këtë!

E fundit që mi vështirëson këto situata ka shumë pak lidhje me handikapin tim, por më shumë me diçka që e llogaris si shumë konfuze: Shpesh më afrohet person i moshuar, që mezi më njeh, dhe më pyet si "Prindi Juaj a Ju dëgjon?". Bile edhe kur kisha 5 vjet nuk dija t'i përgjigjem kësaj pyetje. Gjithnjë e pyesja veten çfarë do të thoshte nëse them po, e çfarë jo. Ndërsa kjo është pyetje që është e përshtatshme për moshën 5 vjeçare. Tani, si 30 vjeçar, unë përsëri habitem me këtë pyetje, pasiqë asnjëherë nuk e kam pasur të qartë nëse ky person mendon se jam i retarduar ose thjesht nuk ka kreativitet gjatë shtrimit të pyetjes.

E, lexues të dashur, si jeni sot? Po, pajtohem, sot është ditë e mrekullueshme. E shkruaj këtë në një ditë vere, e me të vërtetë do të ishte e çuditshme po mos ishte ashtu.

Kapitulli 6

Shërbimi administrativ për studentët me handikap: Qasja deri te informatat dhe shërbimet

Autore: Daniella Stojanovska - Xhingovska[1]

Duke marrë parasysh shkallën e zhvillimit në rrjedhë të mendimit të njeriut, i dalë nga ngritja evidente dhe rezultatet e arritura të pakontestueshme të lëvizjes globale kundër të gjitha llojeve të invaliditetit, janë kuptimësuar në nivel botëror dhe më tej dizajnohen forma dhe mënyra të ndryshme, në të cilat shteti i mbron dhe i praktikon të drejtat e kësaj popullate, d.m.th. e lehtëson/ndihmon pjesëmarrjen në përditshmërinë shoqërore.

Serviset, në kuptimin e ngushtë, janë ato që konkretisht kanë të bëjnë me nevojat sociale të gjithë personave që kanë nevojë nga shfrytëzimi i tyre (asistentë personal, qendrat ditore për fëmijë, kujdesi social etj.), ndërsa në kuptimin më të gjerë ato paraqesin përfshirje të gjerë të serviseve me funksion social, si për shembull: arsimi, kujdesi primar shëndetësor, punësimi. Qëllimi i fundit i çdo servisi është i dedikuar për personat me invaliditet është të përmirësohet kualiteti i jetës së tyre dhe të forcohet pjesëmarrja aktive në jetën sociale.

Shteti është përgjegjës të sigurojë qasje për të gjithë qytetarët deri te shërbimet e servisit, edhe pse në disa raste nuk është furnizues i drejtpërdrejtë! Me qëllim që të plotësohet ky rol, serviset për personat me invaliditet duhet në numër të madh të zhvillohen në nivel lokal, duhet të jenë cilësore dhe të qëndrueshme, t'u përgjigjen nevojave të personave me moshë, nevoja dhe kategori të ndryshme të invaliditetit.

Në ditët e sotme vërehen ndryshim i paradigmës për dhe në serviset sociale, që lëviz (1) nga modeli mjekësor dhe mbrojtës ndaj atij social dhe përfshirës, i fokusuar në të drejtat e njeriut, mundësitë e barabarta dhe pjesëmarrjen e tërësishme në bashkësi, si dhe (2) nga institucione të mëdha ndaj serviseve në bashkësi, të bazuara në mundësitë për zgjedhje, nevojave dhe interesave të personave.

Ekzistojnë disa tipa të shërbimeve të servisit d.m.th. të rregullta, për punësim, për kujdes shëndetësor, për mbrojtje sociale.

Serviset për mbështetje (support services):

- Aparatet ortopedike dhe asistive.
- Asistentë personal.
- Defektolog të lëvizshëm.
- Përkthyes në gjuhën e shenjave.
- Serviset e shërbimeve të specializuara janë: qendrat ditore, institucionet rehabilituese, punëtoritë mbrojtëse.

Shenja **"4–A"** në shërbimet sociale vjen nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës ku për shërbimet sociale thuhet se janë:

[1] Daniella Stojanovska – Xhingovska, defektologe e diplomuar, kryetare e Shoqatës së studentëve dhe të rinjve me handikap – Shkup, Maqedoni, e-mail: stojanovskad@gmail.com

- **Accessible** ose me qasje
- **Available** territorial ose me qasje territoriale
- **Affordable** ose me qasje financiare
- **Accountable** ose transparente në aspektin organizativ dhe financiar



Fotografia: 6.1. Serviset për mbështetje[2]

Nga kjo del edhe i ashtuquajturi Tuin - trak (twin – track[3]) qasje që parasheh:

1. balancë i drejt mes serviseve të rregullta dhe të specializuara të bazuara në bashkësi;
2. zvogëlimi i pabarazisë mes personave me invaliditet dhe personave të cilët nuk kanë invaliditet;
3. potencomi i domosdoshmërisë nga inkuadrimi i çështjes për invaliditetin në të gjitha rregulloret dhe iniciativat ligjore;
4. nxitja e iniciativave plotësuese të cilat kanë të bëjnë me nevojat specifike të personave me invaliditet.

Në **Nenin 24** nga Konventa për të drejtat e personave me invaliditet, të miratuar nga ana e Kuvendit gjeneral të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB) më 13.12.2006, ndërsa të ratifikuar nga Kuvendi i R. Maqedonisë më 05.11.2011, **rregullohet Arsimi.** Konventa i cakton këto obligime:

- shtetet nënshkruese, në bazë të barazisë me tjerët dhe pa diskriminim e njohin të drejtën e arsimit të personave me pengesa dhe të sigurojnë arsim në të gjitha nivelet.
- Për këtë qëllim shtetet nënshkruese duhet të sigurojnë adaptime të shëndosha, ndihmë dhe mbështetje për personat me pengesa, në kuadër të sistemit të përgjithshëm arsimor, të lehtësohet mësimi me Alfabetin e Brajit dhe alfabetet alternative dhe gjuhën e shenjave, të

[2] www.disability.org.
[3] ibid.

punësohen arsimtarë të cilët janë të kualifikuar për Alfabetin e Brajit dhe gjuhën e shenjave (me gjeste), të sigurohet qasje për personat me pengesa deri te arsimi i përgjithshëm sipëror, trajnim vokacioni/profesional, arsimi i të rriturve dhe mësimi i përjetshëm pa diskriminim.[4,5]

Megjithatë,edhe krahas asaj që Maqedonia e ratifikoi Konventën, studentët me handikap ende ballafaqohen me një sërë barrierash dhe atë:

- Klasa, tualete, kuzhina, salla si dhe dhoma gjumi fizikisht pa qasje në konviktet studentore.
- Mungesa e servileve për asistencë personale.
- Mungesa e materialeve arsimore në formate alternative, siç janë tekstet shkollore në format elektronik, audio dhe "format të zmadhuar të shtypur" ose të shtypura në Alfabetin e Brajit.
- Mungesa e programeve kompjuterike për studentët me të parët e dëmtuar.
- Mungesa e transportit të organizuar për shfrytëzuesit e karrocave invalidore.
- Mungesa e komentuesit të gjuhës së shenjave për studentët/studentet me të dëgjuarit e dëmtuar.
- Mungesa për njohjen e llojeve të caktuara të handikapit, siç janë disa vështirësi gjatë të mësuarit.
- Ndarja e studentëve me handikap në konvikte speciale studentore.

E gjithë kjo kulminon jo vetëm me mosekzistimin e të dhënave statistikore për numrin e përgjithshëm të personave me handikap në Republikën e Maqedonisë, por nuk ekzistojnë as të dhëna zyrtare statistikore për atë se sa është numri i studentëve me handikap. Në të vërtetë, në asnjë universitet shtetëror në Republikën e Maqedonisë nuk ekziston **Shërbimi administrativ për studentë me handikap** që i rregullon të gjitha çështjet lidhur me studentët me handikap.

Shembuj pozitiv të trajtimit të drejt të studentëve përmes sigurimit të Shërbimit administrativ për studentët me handikap

1) Shembuj nga jashtë vendit

Në Universitetin në Ilionis[6], SHBA, ekziston shërbim i pavarur administrativ që i rregullon të gjitha çështjet lidhur me nevojat, të drejtat dhe jetën e studentëve me handikap.

Në Evropë, në Universitetin Shtetëror në Palermo, (Universita Degli Studi di Palermo, Facolta di littere e filosofia), Itali, në kuadër të Institutit për edukim dhe rehabilitim special, ekziston shërbim i ngjashëm administrativ, si pjesë e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, përmes së cilit studentëve me handikap u mundësohen të gjitha shërbimet dhe servilet e nevojshme, d.m.th. atyre u mundësohet pavarësia dhe barazia e tërësishme në procesin arsimor.[7]

Në fqinjësinë tonë, d.m.th. në hapësirat ballkanike, Qendra universitare për studentët me handikap[8], zyrtarisht filloi me punë më 20 mars 2008. Qendra është themeluar nga ana e Universitetit në Beograd me mbështete të Telenor Fondacionit, ndërsa në bashkëpunim me Shoqatën e Studentëve me handikap nga Serbia[9]. Qendra është themeluar me qëllim që t'u jepet mbështetje studentëve me handikap në të gjitha nivelet e arsimit sipëror. Obligimet e Qendrës universitare janë:

- Zhvillimi dhe avancimi i kushteve për studim të studentëve me handikap,

[4] https://www.un.org/disabilities/default.asp?id=150.
[5] Konventa e Kombeve të bashkuara për të drejtat e personave me invaliditet. E marrë nga: www.poraka.org.mk.
[6] www.uic.edu.
[7] http://portale.unipa.it/lettere/.
[8] http://www.bg.ac.rs/csrp/clanice/centri/csh.php.
[9] www.seen-ysd.org

- mbështetje për lexim, skanim dhe hedhjen e teksteve shkollore në formë audio dhe elektronike për studentët me handikap,
- mbështetje në procesin për përkthimin e mësimit në gjuhën e shenjave,
- dhënia e informatave studentëve me handikap për kushtet për studim dhe mënyrat e mbështetjes së fakulteteve në procesin e zgjedhjes së fakultetit, si dhe për mundësitë për punësim pas përfundimit të studimeve,
- organizimi i seminareve edhe tribunave dhe paraqitja në media me qëllim të motivimit të studentëve me handikap për regjistrim në fakultet, si dhe ngritja e nivelit të vetëdijes së opinionit në Serbi për çështjen për gjendjen e personave me handikap,
- bashkëpunimi me institucionet relevante me qëllim të përmirësimit të pozitës së studentëve me handikap,
- kryerja e punëve të tjera për nevojat e studentëve me handikap.

2) Shembuj në kuadër të R. Maqedonisë

Në R. Maqedonisë vetëm në Universitetin e Evropës Juglindore[10] në Tetovë ka shërbim administrativ që udhëheq regjistër të studentëve me tipa të caktuar të handikapit dhe/ose invaliditet, për të gjitha nivelet gjatë studimit, ndërsa në mënyrë plotësuese jep edhe mbështetje këshillëdhënëse për mundësitë për punësim të studentëve me handikap që kanë diplomuar.

a) Servisi informativ-shërbyes për studentët me handikap në Shkup si shembull i praktikës së mirë

Servisi informativ-shërbyes për studentët me handikap në Shkup për herë të parë u hap në dhjetor të vitit 2004, nga ana e Shoqatës së studentëve dhe të rinjve me handikap – Shkup (SHSRH)[11,12]. Mbështetja financiare për funksionimin e kësaj zyre sigurohet nga donatorët të ndryshëm nga vendi dhe jashtë (Ambasada amerikane në Shkup[13], Rektorati i Universitetit Sh. Qirili dhe Metodi nga Shkupi[14], biznes bashkësia nga vendi.

Bëhet fjalë për zyrë të vogël, e vendosur në anën e majtë të hyrjes së Fakultetit Filozofik dhe Filologjik në Shkup, më konkretisht deri te zyra amë e profesorëve të gjuhëve. Zyra është pronë e Lidhjes së Studentëve të Fakultetit Filologjik, por me kërkesë të Shoqatës së studentëve dhe të rinjve me handikap – Shkup iu është dorëzuar për nevojat e servisit për studentët me handikap dhe shërben si

[10] www.seeu.edu.mk

[11] Shoqata e studentëve dhe të rinjve me handikap nga Shkupi (SHSRH) ekziston nga dhjetori i vitit 2002, ndërsa e themeluan një grup entuziast, studentë defektologë, si dhe studentë nga grupet tjera, fakultete dhe universitete nga Republika e Maqedonisë.
Misioni i kësaj shoqate është të promovojë arsim inkluziv të mesëm dhe sipëror për të rinjtë dhe studentët me handikap përmes sigurimit të gjitha kushteve të nevojshme për këtë, avokim i modelit social në qasje drejt handikapit dhe realizimit të qëllimeve të hartuara të organizatës.
SHSRH është **shoqata e vetme në RM,** që punon vetëm në procesin e arsimit, lobimit dhe avokimit për realizimin e të drejtave, kushteve dhe mundësive të barabarta në procesin arsimor për këtë kategori të qytetarëve dhe ndërmerr aksione konkrete për sigurimin e shërbimeve për të gjithë anëtarët dhe shfrytëzuesit dhe atë në përqindje të madhe të shërbimeve me karakter të qëndrueshëm dhe me këtë krijon "shoqëri inkluzive", shoqëri ku të gjithë qytetarët kanë jetë të barabartë, me dinjitet dhe plotësisht të pavarur.
Më shumë informata për SHSRH mund të gjenden në: www.zsmh.org.mk и www.seen-ysd.org.

[12] Aktivitetet e SHSRH janë në lidhje të ngushtë me aktivitetet e Rrjetit të rinjve dhe studentëve me handikap. Ky është themeluar në shkurt të vitit 2004 dhe rrjetin gjatë viteve të kaluara e përbënin katër organizata: Shoqata e studentëve me handikap "Gaudeamus" nga republika e Moldavisë, Shoqata e studentëve dhe të rinjve me handikap nga Republika e Maqedonisë, Shoqata e të rinjve me handikap nga Republika e Malit të Zi dhe Shoqata e studentëve me handikap nga Republika e Serbisë. Më shumë informata në www.seen-ysd.org.

[13] www.macedonia.usembassy.gov.

[14] www.ukim.edu.mk.

Servis informativ-shërbyes për studentët me handikap që funksionon në kuadër të Universitetit "Sh. Qirili ndhe Metodi" në Shkup.

Mbushen 8 vite nga funksionimi i tij, edhe pse me ndërprerje në periudhat kur pritet mbështetje financiare nga ndonjë donator (i huaj ose nga vendi). Në punën dhe funksionimin, Servisi udhëhiqet nga përvojat e personave të angazhuar në atë (bëhet fjalë për vullnetarë), por njëkohësisht duke u bazuar në përvojat e vetë studentëve – për të cilin është dedikuar – arrin që në pjesën më të madhe t'i realizojë përvojat aktivitetet dhe qëllimet për të cilin, ai edhe është themeluar.

Pse janë bërë përpjekje për ngjalljen e kësaj qendre?
Cilat janë idetë, qëllimet, detyrat dhe aktivitetet e saja?

Qendra/servisi, në të vërtetë paraqet një lloj të çështjeve studentore i dedikuar për studentët me handikap. Shërbimet e këtij servili i realizojnë tre vullnetarë, të cilët studentëve u janë në dispozicion çdo ditë në periudhën nga ora 11 deri më 14. Në punë janë inkuadruar tre studentë, prej të cilëve dy studentë nuk kanë handikap, ndërsa njëri studentë është me handikap. Qendra është një lloj shërbimi administrativ që studentëve u ofron çfarëdo mbështetje, me qëllim që këtyre studentëve t'u lehtësohet qasja deri te arsimi sipëror, ndërsa në të njëjtën kohë të zvogëlohen pengesat me të cilat ballafaqohen çdo ditë. Servisi jo rrallë është vend ku studentët e kalojnë kohën e lirë, e prandaj është burim i shumë miqësive, shoqërimeve, shkëmbimit të përvojave.

Më konkretisht, shërbimet të cilat qendra/servisi dhe SHSRH përmes zyrave amë **ua ofrojnë studentëve me handikap janë të tipit:**

1. Realizimi i kontakteve me çështjet studentore për marrjen dhe dhënien e informatave adekuate lidhur me sesionet e provimeve, afatet për paraqitje dhe dhënie e provimeve dhe regjistrimin e viteve.
2. Përcjellja e rendit të ligjëratave, konsultimeve dhe dhënies së provimeve te profesorët adekuat nga grupet, ku ka studentë me dëmtim të dëgjuarit dhe të parët që t'u mundësohet qasje adekuate.
3. Transporti deri te fakulteti – SHSRH, ndërsa me këtë edhe Servisi, me mbështetje të vazhdueshme financiare të Kuvendit të Qytetit të Shkupit (që e financon transportin), ndërsa në bashkëpunim me Ndërmarrjen publike transportuese – Shkup (NPT), duke filluar nga viti 2005, me autobus të adaptuar siguron transport për studentët dhe nxënësit me handikap. Nga viti 2008, Qeveria e RM, gjegjësisht Ministria e Arsimit dhe Shkencës, përmes Qytetit të Shkupit, SHSRH në dispozicion ua ka dhënë edhe një kombe, tërësisht të adaptuar për shfrytëzuesit e karrocave invalidore. Në këtë mënyrë, për të gjithë studentët e tanishëm dhe të ardhshëm që studiojnë në Shkup, në nivel institucional u tejkalua edhe një nga problemet e hidhura themelore të studentëve me handikap, kjo është pamundësia që rregullisht t'i ndjekin ligjëratat dhe ushtrimet.
4. Zhvillimi dhe avancimi i kushteve për studim të studentëve me handikap.
5. Mbështetje për të lexuar, skanim dhe hedhjen e teksteve shkollore në format audio dhe elektronik për studentët me handikap, ndërsa nëse paraqitet nevoja edhe angazhimi i përkohshëm i personit që bën sinkronizimin e literaturës për studentët me të parët e dëmtuar, përkthimin e librave, skripteve dhe shënimeve në formë elektronike, audio ose tjetër të nevojshëm, përshkrimin (në makinën për shkrim) dhe rregullimin e teksteve dhe shënimeve dhe krijimi i formateve tjera të kapshme të literaturës.
6. Mbështetje në procesin për përkthimin e mësimit në gjuhën e shenjave dhe angazhimi i komentuesit të gjuhës së shenjave për studentët me të dëgjuarit e dëmtuar, gjithnjë kur të paraqitet nevoja për këtë, e rregulluar me Ligjin për përdorimin e gjuhës së shenjave (Gazeta Zyrtare e RM nr. 105 nga 21 gushti 2009)

7. Dhënia e informatave studentëve me handikap për kushtet e studimit dhe mënyrat e mbështetjes në fakultetet në procesin e zgjedhjes së fakultetit, si dhe për mundësinë për punësim pas përfundimit të studimeve. (SHSRH deri tani realizoi disa punësime të suksesshme të kuadrove të veta sipërore arsimore në administratën publike).
8. Informim dhe mbështetje gjatë realizimit të niveleve të ndryshme gjatë studimit. Në të vërtetë, shpesh studentët dhe studentet me handikap nuk janë njoftuar me të drejtat e veta dhe mënyrat e realizimit siç është e drejta për lirimin e studentëve me handikap deri në diplomim nga pagesa e participimit, si e drejtë ligjore e rregulluar në Nenin 87 nga Ligji për arsim sipëror nga 14.03.2008. Inkorporimi i këtij neni në ligj është dëshmi për bashkëpunimin shumëvjeçar të suksesshëm mes Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe SHSRH.
9. Dhënia e mbështetjes përmes informimit dhe këshillave dhe gjetjes së mënyrave, si këto të drejta mund të realizohen, shpesh duke siguruar logjistikë dhe mbështetje tjetër në komunikim me administratat përkatëse (të fakulteteve dhe universiteteve etj.), marrja e dokumenteve të nevojshme dhe mbështetje e ngjashme në realizimin e të drejtës për fitimin e bursës studentore, informimi për konkurset dhe të drejtën për bursë, sigurimi i kushteve të volitshme për fitimin e bursave të ndryshme (që i sigurojnë ministritë kompetente, autoritetet e qytetit dhe sektori privat) dhe mbështetja gjatë sigurimit të dokumentacionit të nevojshëm.
10. Lajmërimi i kandidatëve të interesuar për mundësitë për studim përmes publikimeve të rregullta (internet prezantimeve, e-mail listat, buletinet, revistat) dhe me anë të shfrytëzimit të mediave.
11. Organizimi i seminareve dhe tribunave dhe paraqitja në media me qëllim të motivimit të studentëve me handikap për regjistrim në fakultete, si dhe ngritja e vetëdijes të opinionit në R. Maqedonisë për çështjet lidhur me gjendjen e personave me handikap.
12. Dhënia e mbështetjes për sigurimin e parakushteve tjera akademike – vendet në konviktet studentore, qasja deri te shtëpitë, klubet studentore, kuzhinat etj.
13. Bashkëpunimi me institucionet relevante me qëllim të përmirësimit të pozitës së studentëve me handikap.
14. Mbështetja psiko-sociale dhe inkurajimi i të rinjve me handikap – përmes kurseve, trajnimeve dhe punëtorive – përfshin organizimin e kurseve për gjuhë të huaja dhe programe kompjuterike, si dhe trajnime nga fusha e të drejtave të njeriut, modeli i qasjes ndaj handikapit, shkathtësitë organizuese (shkathtësi për komunikim, punë ekipore, për cikël projekti etj.), këshillime psikologjike dhe punëtori dhe forma të tjera të ndryshme të punës me të rinjtë me handikap.
15. Kryerja e punëve të tjera për nevojat e studentëve me handikap. Prej para do kohe Servisi filloi të ofrojë edhe shërbime për fotokopjim me çmime më të ulëta se të tjerët. Në këtë mënyrë tejkalohen dhe shmangen turmat e përditshme në vendet për fotokopjim.

b) Servisi – asistenca personale për studentët dhe të rinjtë me invaliditet

Edhe një tip servisi tjetër për mbështetje të studentëve me invaliditet u realizua në kuadër të Shërbimit informativ – shërbyes. Ky është servisi – asistenca personale për studentët dhe të rinjtë me invaliditet. Së pari, në periudhën prill 2006 deri më korrik 2007, kjo Qendër u themelua përmes mbështetjes së Ambasadës Amerikane në Shkup[15] dhe Rektoratit pranë Universitetit "Shën Qirili dhe Metodi" në[16] në Shkup, e pastaj, me mbështetje nga programi CIVICA Mobilitas të zbatuar nga Qendra për Zhvillim Institucional CIRa dhe financiarisht e mbështetur nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, vazhdoi me punë në periudhën shtator 2010 deri mars 2011. Me projektin[17], përveç

[15] www.macedonia.usembassy.gov.
[16] www.ukim.edu.mk.
[17] www.cira.org.mk.

studentëve, u përfshinë edhe nxënësit e shkollave të mesme me invaliditet, d.m.th. gjithsej shtatë shfrytëzues, prej të cilëve katër nxënës të shkollave të mesme dhe tre studentë shfrytëzuan asistim personal:

Duke e zgjeruar konceptin e asistencës dhe mbështetjes së personave me handikap në territorin e Komunës së Karposhit dhe Sarajit, me zbatimin e hulumtimit në këto komuna, SHSRH krijoi bazë të saktë të dhënave për atë se sa personave u nevojitet asistenca, me çfarë handikapi janë këto persona, në çfarë forme u nevojitet asistenca. Numrat e fituar nga terreni janë tregues i mjaftueshëm për atë se asistenca personale për këta persona domosdo nevojitet të ekzistojë në të gjitha nivelet dhe për të gjitha kategoritë e moshës. Nevojë më e madhe nga asistenca në dy komunat u paraqit asistenca në kushte shtëpie, ndërsa nuk ishte edhe aq i vogël interesimi për asistencë gjatë mësimit[18].

SHSRH fitoi tregues të drejtpërdrejtë, konkret dhe të saktë për nevojën nga ky shërbim nga vetë personat me handikap, shfrytëzuesit potencial.

Ky shërbim jo që u nevojitet shumë personave pjesëtarë të grupeve të ndryshme të moshës dhe në forma të ndryshme, por gjatë procesit hulumtues në Komunën e Karposhit hasëm në persona që dëshironin ta plotësonin fletën anketuese edhe pse nuk janë banorë të kësaj komune. Ky fakt qartë flet për nevojën nga zgjerimi i konceptit të propozuar edhe në komuna të tjera. U anketuan këto komuna: Aerodrom, Gjorçe Petrov, Qendër, Veles, Kisella Vodë. Gjatë kësaj, të gjitha faktet dhe treguesit, të cilët mes tyre gjenden në varësi shkak-pasojë, në mënyrë tendencioze shpijnë drejt arsyetimit për zgjerimin e këtij koncepti anembanë territorit të R. Maqedonisë.

Nga bisedat me prindërit dhe nga pyetësorët plotësues anketues u vërtetua nevoja nga asistenca edhe për nxënësit nga shkollat fillore. Veçanërisht për personat me pengesa intelektuale, u nevojitet asistent personal, defektolog, i cili gjatë mësimit do ta ndjek procesin arsimor bashkë me fëmijën dhe do të punojë në mënyrë plotësuese me atë. Këtë e theksuan edhe të gjithë përfaqësuesit e shërbimeve pedagogjike psikologjike në shkolla. Për këtë qëllim SHSRH do t'i merr parasysh të gjitha sugjerimet për nevojën nga ekzistimi i asistentit personal në forma të ndryshme.

Qëllimi i Zyrës informative shërbyese të Fakultetit Filologjik është pikërisht ky, por që kjo të funksionojë përherë dhe në mënyrë të vazhdueshme nga ana e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës gjegjësisht nga ana e shtetit nevojitet:

1. Hapja e Zyrave shërbimeve administrative në çdo universitet shtetëror në RM (së paku nga një zyrë të tillë) nën kompetencat e Ministrisë së Arsimit deh Shkencës.
2. Punësimi i obliguar i së paku një personi me handikap në këtë shërbim në këtë shërbim të universiteteve (jo si angazhim me honorar, por përmes realizimit të drejtës së themelimit të marrëdhënies së punës).

Menaxhimi me këto shërbime duhet t'i besohet Shoqatës së studentëve dhe të rinjve me handikap – Shkup, sipas parimit të dhënies së licencës së SHSRH nga ana e MASH për të drejtën e fituar për kryerjen e shërbimeve për MASH. Në këtë mënyrë, SHSRH do të fitojë statusin e organizatës me interes publik (Ligji për shoqatat e qytetarëve dhe fondacionet nga neni 73 deri te neni 90, ku është caktuar mënyra dhe kriteret për fitimin e statusit së organizatës me interes publik).

[18] Raport i SHSRH për CIRA 2010 – 2011.

Kapitulli 7

Mundësi plotësuese për studentët/personat me invaliditet/pengesa: Aktivitete jashtë shkollore

Autorë: Jagoda Risteska[1], Jasmina Risteska[2], Ana M. Llazarevska[3]

Në këtë kapitull do të përqendrohemi në disa drejtime dhe udhëzime në kërkim të mundësive për studentët/personat me invaliditet/pengesa në krahasim me ata, të cilët zakonisht llogarite si persona kushtimisht "pa" ndonjë invaliditet/pengesë, pasiqë të gjithë ne "vuajmë" nga ndonjë aftësi ose paaftësi.

Studentët me invaliditet/pengesa/handikap i kanë nevojat e njëjta në kohën e lirë, si edhe studentët tjerë, për çka do të duhej ti kenë siguruara të njëjtat kushte dhe mundësi për plotësimin e të njëjtave. Ky kapitull ka për qëllim t'u përgjigjet pyetjeve të tipit:

1. Çfarë mund të bëjnë profesorët dhe kolegët (në çfarë mënyre do të mund të ndihmonin) që të sigurohen nëse të njëjtat, të paktën kushte të ngjashme për studentët me invaliditet/pengesa/handikap të inkuadrohen në jetën jashtë klasave? Si për shembull, mundësi për:
   - angazhim në sport, ekipe sportive në kuadër të universitetit, por edhe më gjerë;
   - angazhimi në art, muzikë (orkestër dhe korre), punime të ndryshme dore, letërsi ose klube/punëtori të tjera për të cilat profesori ose kolegu kanë informata;
   - angazhimi në aktivitete lidhur me projekte në rrjedhë si pjesë e aktiviteteve profesionale shkollore dhe/ose jashtë shkollore (aktivitete ndërkombëtare, mobiliteti, vullnetarizmi etj.);
   - pjesëmarrja në trajnime për studentë të cilët nuk janë përfshirë me ligjëratat e rregullta.

2. Çfarë do të kishim mundur ne si individë/miq etj. Të bëjmë për jetën e personave me invaliditet/pengesa/handikap që të jetë si edhe jeta e "studentëve pa invaliditet/pengesa/handikap", d.m.th. ta mundësojmë integrimin e tyre dhe qasjen e barabartë deri te mundësitë në të gjitha nivelet dhe në çdo formë të jetës shoqërore?

3. Çfarë mund të bëjnë/përshtatin/zbatojnë institucionet që të mund t'i mundësojnë/sigurojnë kushtet e lartpërmendur për qasje të barabartë dhe mundësi të barabarta për personat me invaliditet/pengesa/handikap (d.m.th. aspekti i qasjes fizike dhe tjetër që është e domosdoshme për aktivitetet e lira).

Ekzistojnë më shumë mundësi për arsim dhe zhvillim profesional të personave me invaliditet/pengesa/handikap jashtë sistemit të rregullt arsimor. Këto mundësi mund të jenë në nivel nacional dhe ndërkombëtar, varësisht nga dëshirat e personave me invaliditet/pengesa/handikap. Do të duhet të kuptohet më shumë për të gjitha mundësitë dhe të vendoset cili program më së shumti përgjigjet. Personat me invaliditet/pengesa/handikap duhet të grumbullojnë informata për organizatat e ndryshme dhe programet e tyre që të shohin nëse ato mundësi u përgjigjen interesave dhe nevojave të tyre.

[1] Jagoda Risteska, ekonomiste e diplomuar, aktiviste në Organizatën e qytetarëve Mobiliteti – sfidë, Maqedoni, e-mail: risina79@hotmail.com.
[2] Jasmina Risteska, ekonomiste e diplomuar, aktiviste në Organizatën e qytetarëve Mobiliteti – sfidë, Maqedoni, e-mail: inaris0702@yahoo.com.
[3] Dr. Ana M. Llazarevska, docente pranë Fakultetit të makinerisë – Shkup, Universiteti "Shën Qirili dhe Metodi", Shkup, Maqedoni. e-mail: ana.lazarevska@gmail.com and ana.lazarevska@mf.edu.mk.

Në **nivel nacional,** ekzistojnë shumë mundësi për personat me invaliditet/pengesa/handikap për pasurimin e njohurive dhe shkathtësive të tyre përmes pjesëmarrjes në punëtori, kurse, trajnime të ndryshme etj. Disa nga këto mundësi paraqesin pjesë përbërëse të programeve të përgatitura nga ana e organizatave jofitimprurëse, të cilat bashkëpunojnë me personat me invaliditet/pengesa/handikap dhe të njëjtat janë pa pagesë për shfrytëzuesit e fundit. Për të tjerët, nevojitet të paguhet një shumë e caktuar. Për momentin në R. Maqedonisë, më së shpeshti përmes sektorit joqeveritar, ofrohen kurse për gjuhë të huaja, për me kompjuterë dhe punëtori për teknika të ndryshme të artizanaleve.

Për personat me invaliditet/pengesa/handikap të cilët kanë njohuri të caktuara të gjuhëve të huaja dhe të cilët janë të interesuar të udhëtojnë jashtë shtetit dhe t'i provojnë kushtet e jetës dhe zhvillimi e mundësive të veta profesionale në periudhë të caktuar kohore, ekziston spektër i gjerë i **mundësive ndërkombëtare** për personat me invaliditet/pengesa/handikap përmes më shumë programeve për shkëmbim siç janë:

- Studimi jashtë vendit
- Programi për të mësuarit e përjetshëm
- Bursat
- Praktikumi
- Vullnetarizmi
- Pjesëmarrje në aktivitete të ndryshme nga vendi dhe jashtë, seminare, punëtori, konferenca etj.

Studimi jashtë vendit

Edhe krahas invaliditetit/pengesës/handikapit – çrregullimit trupor ose psikik, secili mund ta gjejë vendin e vet në mundësitë për studim jashtë vendit. Rreth 3% të atyre që studiojnë jashtë vendit kanë ndonjë invaliditet/pengesë/handikap, qoftë që bëhet fjalë për të dukshëm ose që nuk vërehet, dhe numri i tyre vazhdimisht është në rritje.[4]. Nëse studenti me invaliditet/pengesë/handikap ka dëshirë me të vërtetë të studiojë jashtë vendit, duhet mirë të mendojë për atë çfarë do të kishte dashur të përjetojë dhe me cilat sfida do të ishte i gatshëm të përballohet.

Në botë ekzistojnë qindra programe për studim jashtë vendit, ndërsa secila prej këtyre programeve mund të jetë e dedikuar për nevoja të ndryshme, disa janë lidhur me invaliditetin/pengesën/handikapin, ndërsa të tjera jo.

Pasiqë gjeti disa programe të cilat i janë dukur interesante, studenti duhet të përpiqet të gjejë sa është e mundur më shumë informata dhe fakte për secilën prej programeve në pikëpamje të:

- Nëse janë plotësuar interesat dhe nevojat e tyre arsimore?
- Cilat janë mundësitë për gjetjen e vendosjes që i përgjigjet nevojave në pajtim me invaliditetin/pengesën/handikapin e tij/saj?
- Cilat janë kushtet financiare për secilën nga programet?

Programet ndryshojnë në pikëpamje të asaj si janë hartuar dhe në cilën mënyrë funksionojnë, e për shkak të kësaj është shumë e rëndësishme që të shqyrtohen mundësitë në disa vende të ndryshme dhe kushte të ndryshme akademike, pasiqë kohëzgjatja e programeve ndryshon nga disa javë deri në një vit shkollor.

[4] International Educational Exchange (CIEE) është organizatë jofitimprurëse joqeveritare për shkëmbim ndërkombëtar www.ciee.org.

Financimi për studim jashtë vendit

Një nga kushtet më të rëndësishme për studim jashtë vendit është gjetja e mjeteve financiare. Ekzistojnë vetëm disa fonde të dedikuara vetëm për personat me invaliditet/pengesa, por studentët me invaliditet/pengesa/handikap nuk duhet të kufizohen vetëm në këto resurse. Më shumë bursa dhe programe për financim nxisin që të paraqiten njerëz nga mjedise të ndryshme, ndërsa invaliditeti është pjesë e rëndësishme e këtij diversifikimi në pjesën më të madhe të vendeve të zhvilluara. Lista e fondeve është vëllimshme dhe kërkon hulumtim të hollësishëm, ndërsa në pjesën më të madhe nevojitet të dorëzohen edhe punime nga aplikuesi, e kështu studentët shpeshherë nuk aplikojnë për të gjitha bursat, ndërsa disa fonde mbeten të pashfrytëzuara. Kur për herë të parë u pa se sa është numri i bursave, duket sikur kërkon shumë nga aplikuesi, por nëse kërkohet gradualisht, çdo ditë nga pak, është e mundur të gjendet mbështetja që kërkohet.

Kur zgjidhet universiteti në të cilin dëshiron të studiojë, e para se të fillohet me hulumtim të kushteve për financim, nevojitet së pari të drejtohen deri te shkollat te të cilat do të dëshironin të aplikojnë. Prej atje do të fitoni informatë për lartësinë e pagesës, si dhe për ndihmën financiare që është e vetme për çdo shkollë, fushën për të cilën jeni të interesuar, si dhe participimi për shkollën e dedikuar vetëm për studentët me invaliditet që vijnë jashtë vendit.

Për shtetasit e Maqedonisë ekzistojnë numër i madhi mundësive për studim jashtë vendit në shumë vende, por sa i përket mundësive për studentët me invaliditet/pengesa/handikap që të fitojnë ndihmë financiare, këta kryesisht vijnë deri nga institucionet arsimore në vendet e Bashkimit Evropian ose SHBA.

Programi për të mësuarit e përjetshëm[5]

Nëse studenti/studentja me invaliditet/pengesë/handikap dëshiron të shkojë në ndonjë universitet në ndonjë vend evropian, Programi për të mësuarit e përjetshëm të Komisionit Evropian jep më shumë mundësi për arsim dhe zhvillim profesional për qytetarët nga Evropa. Është shumë e rëndësishme të përmendet se Komisioni Evropian në mënyrë shumë të hapur e stimulon dhe e mbështet pjesëmarrjen e personave me invaliditet/pengesë/handikap në të gjitha programet dhe projektet e veta.

Programi për të mësuarit e përjetshëm të Komisionit Evropian u mundëson njerëzve në të gjitha stadiumet të jetës së tyre të marrin pjesë në proceset stimuluese të mësuarit, ndërsa në mënyrë plotësuese ndihmon për zhvillimin e sektorit arsimor dhe profesional anembanë Evropës. Ekzistojnë katër nën-programe që financojnë projekte të shkallës së ndryshme të arsimit dhe trajnimit.

Comenius Program – qëllimi i këtij programi është që të rinjtë dhe personeli arsimor më mirë t'i kuptojnë kulturat, gjuhët dhe vlerat evropiane. Gjithashtu mundëson që të rinjtë të fitojnë shkathtësi themelore jete dhe kompetenca, të cilat janë të domosdoshme për zhvillimin personal, punësimin dhe jetën e qytetarit aktiv. Programi Comenius përqendrohet në të gjitha shkallët e arsimit, nga arsimi parashkollor dhe fillor deri te ai i mesëm. Programi është i rëndësishëm për secilin që është përfshirë me arsimin shkollor, kryesisht nxënësit dhe arsimtarët, por gjithashtu edhe për autoritetet lokale, përfaqësuesit e organizatave të prindërve, organizatat joqeveritare, institucionet dhe universitetet për trajnim të arsimtarëve.

Leonardo da Vinci Program – përmes këtij programi financohen projekte praktike të arsimit dhe trajnimit profesional. Përfshin iniciativa mobile me çka njerëzve u mundësohet të trajnohen në shtete tjera, të fitojnë shkathtësi dhe kualifikime të reja. Shfrytëzues të këtij programi mund të trajnohen për

[5] I financuar nga Komisioni Evropian, Programi për të mësuarit e përjetshëm (Lifelong Learning Program – LLP) që mbështet vëllim të gjerë të aktiviteteve arsimore dhe trajnuese anembanë Evropës, por siguron edhe mundësi për të gjitha nivelet dhe hapat e të mësuarit e përjetshëm.

trajnimin fillestar profesional, persona që tashmë kanë diplomuar, si dhe ekspertë që janë aktiv në këtë fushë.

Erasmus Program – program arsimor që u mundëson studentëve të studiojnë dhe punojnë jashtë vendit. Krahas kësaj, me programin financohet bashkëpunimi mes institucioneve të larta arsimore anembanë Evropës. Programi jo vetëm që i mbështet studentët, por edhe profesorët dhe pjesëtarët e biznes sektorit, të cilët dëshirojnë të ligjërojnë jashtë vendit, si dhe t'i ndihmojnë kuadrit mësimor në trajnimin e tij.

Grundtvig Program – qëllimi i këtij programi është forcimi i dimensionit evropian të arsimit të rriturve dhe të mësuarit të përjetshëm anembanë Evropës. Fusha specifike drejt së cilës janë drejtuar këto programe është hulumtimi pas sfidave arsimore, në të cilën mund t'i rritin shkathtësitë dhe kompetencat e tyre. Termi "i rritur" në programin Grundtvig ka të bëjë me të gjithë mbi moshën 25 vjeçare si dhe të gjithë atyre mes 16 – 24 vjet, të cilët nuk mund ta ndjekin arsimin fillor në sistemin e rregullt arsimor. Programi Grundtvig siguron mbështetje financiare për përfshirje të gjerë të aktiviteteve. Ja disa shembuj: shkathtësitë themelore, gjuhë të huaja, arsimi për prindërit, projekte nga fusha e artit dhe kulturës.

Nëse studentët me invaliditet/pengesë/handikap kanë dëshirë të udhëtojnë dhe të hulumtojnë kontinente tjera, larg nga shtëpitë e tyre, ndoshta shembull më i mirë për ata do të ishin disa nga kolegjet dhe universitetet në SHBA, në pajtim me mundësitë për gjetjen e ndihmës financiare për studimin e tyre, me anë të bursave. Kolegjet dhe universitetet në SHBA kanë obligim ligjor të sigurojnë qasje për personat me invaliditet/pengesa/handikap deri te programet e tyre. Pothuaj në çdo institucion arsimor në SHBA ekziston Zyrë shërbyese për personat me invaliditet, që siguron vendosje adekuate për personat me invaliditet gjatë studimit të tyre.

Nëse jeni të interesuar për më shumë detaje për programet për shkëmbim në SHBA si dhe mundësitë për financim, këtë mund ta gjeni në internet faqen e organizatës Mobility International USA[6].

Mundësi për mbështetje me bursa të personave me invaliditet/pengesa/handikap

Bursa paraqet shpërblim në të holla në fushë të caktuar, zakonisht u ndahet studentëve në studime para diplomimit dhe pas diplomimit. Bursat mund të ndryshojnë në pikëpamje të shumës, kohëzgjatjes, çfarë ofrohet dhe çfarë kërkohet. Shpesh hasen bursa nga tipi i punës së përkohshme si arsimtar, hulumtim i avancuar ose mundësi për studim. Bursat shpesh i fitojnë ekspertë, arsimtarë, hulumtues dhe studentë të diplomuar.

Bursat zakonisht jepen në bazë të parakushteve që vijojnë, që aplikuesi duhet t'i plotësojë:

- Aktivitet ose hulumtim paraprak akademik;
- Rëndësia e hulumtimit ose studimit të propozuar;
- Njohja e shkëlqyeshme e gjuhës angleze nëse nuk është gjuhë amtare e studentit/studentes;
- Vlera të tjera.

Personi që e fiton bursën quhet bursist/bursiste dhe e njëjta fitohet nga ndonjë organizatë private, qeveri ose universitet. Kjo ndihmë financiare, që ndryshon varësisht nga kohëzgjatja e studimit, mund të jepet për mbulimin e shpenzimeve të ardhshme:

[6] Mobility International USA është organizatë e personave me invaliditet/handikap/pengesa, misioni i së cilës është forcimi i rolit të këtyre personave në gjithë botën në arritjen e të drejtave të tyre të njeriut, me anë të shkëmbimit ndërkombëtar dhe zhvillimit ndërkombëtar. Më shumë detaje mund të gjenden në internet faqen e tyre: www.miusa.org

- Transporti ajror;
- Vendosja dhe ushqimi;
- Sigurimi shëndetësor;
- Participimi për shkollim;
- Librat dhe material tjetër mësimor;
- Shpenzime të tjera.

Këtu janë dhënë disa mundësi për bursa:

Atlas Service Corps, Inc

1133 19th Street NW, 9th Floor
Washington DC, 20036 USA
Email: info@atlascorps.org

Afati i fundit për paraqitje mes 15 shkurtit dhe 15 prillit për bursën e vjeshtës ose mes 15 gushtit dhe 15 tetorit për bursën e pranverës.

Atlas Service Corps ka nevojë për liderë jofitimprurës të cilët do të aplikonin për marrjen e bursës. Kandidatët nevojitet të kenë përvojë prej 2 ose më shumë viteve në sektorin joqeveritar, diplomë universitare, njohja e shkëlqyeshme e gjuhës angleze, të jenë të moshës deri 25 vjeç ose më të rinj dhe të kenë dëshirë të kthehen në atdheun e tyre pas periudhës prej 12-18 muaj, sa zgjat bursa.

Emerging Leaders International Fellow Program

The Gradate Center
The City University of New York
365 Fifth Avenue, Suite 5401
Email: info@philanthropy.org

Afati i fundit: shtator

Qendra për filantropi dhe shoqëri civile (The Center on Philanthropy and Civil Society) sponsorizon program tremujor për trajnim për liderë, përmes hulumtimit të aplikuar dhe mentorimit profesional të bursistëve/ekspertëve më të rinj se 36 vjet, të cilët punojnë në sektorin joqeveritar anembanë botës. Bursat jepen nga ana e The Graduate Center of The City University of New York, ku do të kyçen në projekte individuale hulumtuese dhe do të marrin pjesë në seminare me liderë nga sektori i tretë. Çdo vit zgjidhet nga fushë e veçantë tematike. Çdo bursë i përfshin shpenzimet për shkollim dhe shumë prej 1.300 $ në muaj për shpenzime jete. Vendosja është siguruar në konvikte studentore, ku dot ë sigurohet edhe buleta kthyese me aeroplan. Kandidati/kandidatja duhet të ketë së paku diplomë nga kolegji ose fakulteti dhe të ketë njohje të shkëlqyeshme të gjuhës angleze (të flas dhe të shkruaj).

Mundësi për praktikum

Përmes praktikumit mundësohet që dituria e fituar gjatë studimit të aplikohet në praktikë, në kushte pune. Praktikumi mund të jetë në kuadër të ndonjë programi, por pjesa më e madhe e studentëve krijojnë praktikën e tyre. Hulumtimi dhe vullnetarizmi gjithashtu mund të paraqesë një formë të praktikumit.

Praktikumi i ofron këto mundësi:

- Të shihet si duket të punohet në ndonjë fushë të caktuar;
- Të kontaktohet me ekspertë nga fusha e caktuar;

- Pasurimi i biografisë. Kur shqyrtohet pranimi i ndonjë programi nga punëdhënësi/fakulteti shpeshherë nevojitet përvojë adekuate.
- Punëdhënësit shpeshherë i punësojnë praktikantët e tyre.

Studentët/studentet të cilët dëshirojnë të konkurrojnë për praktikum gjithashtu duhet të kenë parasysh edhe faktin se në cilën mënyrë praktikumi përputhet me qëllimet e ardhshme. Është e rëndësishme që praktikumi t'ua japë përvojën në fushën ku studenti/studentja do të dëshironte të punojë pas diplomimit. Përvoja e parë në praktikum do të mund ta japë njohjen e domosdoshme me fushën, me çka do të ndihmonte të sjellin vendim më të mbajtur për karrierën e tyre të ardhshme.

Këtu janë vendosur disa mundësi për praktikum:

CDS USA Internship Program

440 Park Avenue South
New York, NY 10016
Web: cdsintl.org
Email: usabroad@cdsintl.org

Afati i fundit: dërgoni e-mail për më shumë detaje

The USA Internship Program – ky program për praktikum në SHBA u jep mundësi studentëve dhe ekspertëve të rinj nga gjithë bota të praktikojnë ose të trajnohen në SHBA. Programet mund të jenë me kohëzgjatje prej 6 javë deri më 18 muaj dhe janë përpiluar në atë mënyrë që ta promovojnë zhvillimin profesional dhe bashkëpunimin dhe mirëkuptimin ndërkulturor.

Krahas ndihmës që merret për J-1 vizën, Programi për praktikum në SHBA siguron edhe ndihmë gjatë arritjes në SHBA, ndihmë për marrjen e numrit të sigurimit social, mundësi për lidhjen me organizata tjera dhe ngjarje kulturore, si dhe ndihmë gjatë studimit. Për Programin për praktikum në SHBA mund të paraqiten vetëm ata të cilët kanë gjetur mundësi për praktikum në ndonjë kompani amerikane në SHBA. Pasiqë e fitojnë praktikumin, CDS (organizatë jofitimprurëse) do t'u ndihmojë në çdo fazë të marrjes së vizës J-1.

Mundësi për vullnetarizëm të personave me invaliditet/pengesa

Shumë shpesh personat me invaliditet/pengesa/handikap llogariten si persona të cilëve u nevojitet ndihmë, ndërsa shumë rrallë si persona të cilët mund ta ofrojnë ndihmën e tyre dikujt tjetër. Në pajtim me këtë, janë shumë të rralla rastet kur personat me invaliditet/pengesa/handikap vullnetarizojnë gjatë realizimit të ndonjë projekti ose pune në organizata qytetare.

Vullnetarizmi është mundësi që të përjetohet aventurë dhe njëkohësisht të shprehen aftësitë e tyre, të përmirësohen shkathtësitë e tyre dhe t'u ndihmohet njerëzve të tjerë ose organizatave në arritjen e qëllimeve të tyre. Vullnetarizmi mund të jetë:

- Në vend, dhe
- Jashtë vendit

Nëse vendosni për vullnetarizëm në vend, mund të inkuadroheni në realizimin e ndonjë projekti ose pune administrative në organizatë qytetare në afërsinë tuaj. Në këtë rast nevojitet që personat me invaliditet/pengesa/handikap të kërkojnë ndonjë organizatë e cila punon në fushën që është në interesin e tyre, duke i marrë parasysh aftësitë, shkathtësitë dhe mundësitë me të cilat mund të kontribuojnë.

Në nivel **ndërkombëtar,** në shumë vende në botë ka nevojë aktuale për kujdes për individë të cilët mund të kontribuojnë në më shumë mënyra në krijimin e bashkësive të fuqishme. Personat me

invaliditet/pengesa/handikap nuk duhet të kufizohen për vullnetarizëm vetëm në organizatat që merren me personat me invaliditet/pengesa/handikap. Ata do të mund të vendosnin edhe për këtë që vijon:

- Mësim ose punë me fëmijë ose të rritur;
- Pjesëmarrje në mbrojtjen e ambientit ose kafshëve;
- Ndihmë në pikëpamje të problemeve me interes për shoqërinë ose bashkësinë.

Si përgjgije për këtë, do të fitojnë miq jashtë vendit, do të njihen me njerëz të tjerë të cilët kanë pasion të ngjashëm dhe do të kontribuojnë me diçka pozitive në botën e tyre.

Para se personi me invaliditet/pengesa/handikap të ndërmarrë ndonjë aktivitet, nevojitet të gjejë kohë dhe ta pyesë veten për këtë:

Pse dëshiron të vullnetarizojë?
Njerëzit dëshirojnë të vullnetarizojnë për më shumë shkaqe. Ndonjëherë, ata janë të përkushtuar ndryshimeve shoqërore, ndonjëherë thjesht vetëm dëshirojnë ta thellojnë njohurinë e vet për botën ose të fitojnë përvoja të reja nga fusha e tyre. Cili është shkaku i tij/saj? Pse ai/ajo dëshiron të kalojë një kohë të caktuar dhe të vullnetarizojë në ndonjë organizatë, qoftë ajo e vendit ose e huaj?

Cilat janë pritjet e tyre?
Çfarë pret ai/ajo nga vullnetarizmi? Cilat janë pritjet e tija/saja nga arritjet në ndonjë organizatë të caktuar?

Çfarë mund të ofrojnë ata?
Cilat janë talentet dhe shkathtësitë e tij/saja me të cilat ai/ajo mund të kontribuojë në organizatë? Cilat janë anët e fuqishme/të dobëta të tij/saja?

Si do të ballafaqohen me shpenzimet?
Studenti/studentja me invaliditet/pengesa/handikap nëse ka qenë e veçuar nga familja dhe siguria? Të jesh vullnetar jashtë vendit sjell ndryshime të mëdha. Ata janë larg familjes së tyre, jetojnë në një vend tjetër me njerëz tjerë dhe nuk do kenë kurrfarë rroge. Si ai/ajo do të ballafaqohen me situatën?

Si komunikon me të tjerët?
Si ai/ajo komunikon me të tjerët? Si ai/ajo reagon ndaj problemit dhe mospajtimeve?

Çfarë i bën të kënaqur?
Në fund të fundit, çfarë është ajo që ai/ajo i bën të ndjehen mirë? Si ai/ajo e kalojnë kohën e lirë kur është vet? Ku e gjen ai/ajo ngushëllim?

Shumica e organizatave që kërkojnë vullnetarë dhe nuk kanë mjete të mjaftueshme financiare që t'i paguajnë vullnetarët. Kjo do të thotë se vullnetarët i paguajnë vetë shpenzimet për rrugë, vendosje dhe ushqim.

Ndonjëherë, ndonjë organizatë mund t'u ofrojë vullnetarëve shumë të vogël si ndihmë në pikëpamje të shpenzimeve për vendosje ose rrugë. Në raste të tilla, nga vullnetari kërkohet që të obligohet në periudhë më të gjatë kohore në atë organizatë.

Varësisht nga organizata, mund të ketë edhe kompensim të caktuar që duhet t'i paguhet organizatës për mbulimin e shpenzimeve për gjetjen e mundësisë për vullnetarizëm. Nevojitet që personat me invaliditet/pengesa/handikap të sigurohen nëse kjo organizatë me të vërtetë ekziston dhe punon. Të tjerat, organizata, veçanërisht ato që kanë përvojë më të madhe me vendosjen e vullnetarëve, mund t'u ofrojnë vendosje dhe ushqim vullnetarëve të vet, edhe pse është e mundur të paguhet për këtë shërbim.

Para se të nisen në aventurë si vullnetarë jashtë vendit, nevojiten përgatitje të rëndësishme për personat me invaliditet trupor. Ata duhet të sigurohen se kanë bërë mjaft kërkime dhe se i kanë gjetur informatat e drejta në pikëpamje të:

- Vendosje të qasur;
- Pozita, përgjegjësitë dhe detyrat;
- Qasja e organizatës ku do të vullnetarizojnë;
- Qasje në transportin publik dhe vetë qytetin.

Në kushte të sotme, mundësia për grumbullimin e të dhënave përmes internetit në masë të madhe ndihmon të merren informatat e drejta për vendin, organizatën dhe punën para se ata të obligohen për obligim për vullnetarizëm. Është e rëndësishme të shfrytëzohen të gjitha resurset e mundshme, të përgatiten para se të shkojnë në vend tjetër të angazhuar si vullnetarë.

Nëse dëshirojnë, personat me invaliditet/pengesa/handikap mund të drejtohen edhe deri te ndonjë agjenci ose organizatë që ndërmjetëson dhe gjen vend për vullnetarizëm, e organizon strehimin, ushqimin dhe transportin deri/prej vendit ku është vullnetar. Nëse vendosin t'i shfrytëzojnë shërbimet e cilësdo agjenci, me siguri duhet të paguajnë kompensim të lartë për këtë, punët do t'i kryejë agjencinë, por personat me invaliditet/pengesa/handikap duhet të sigurohen se strehimi, vetë vullnetarizmi dhe transporti do të jenë të kapshme për nevojat e tij/saja.

Personat me invaliditet/pengesa/handikap mund të zgjedhin vetë ta organizojnë aventurën e tyre vullnetare. Në atë rast duhet të kalojmë më shumë muaj në kërkimin e organizatës së vërtetë, strehimin dhe transport me qasje në vendin ku duhet të udhëtojmë. Mund ta kontaktoni personin përgjegjës në organizatë që është e interesuar të angazhojë vullnetar(ë) dhe ta paraqesin interesimin e tyre. Pasiqë të marrin përgjigje pozitive nga organizata, mund të fillojnë me organizimin e strehimit dhe transportit. Pjesa më e madhe e organizatave të cilat janë të interesuara për angazhim të vullnetarëve jashtë vendit, gjithashtu janë shumë të gatshme t'u ndihmojnë me sugjerime në pikëpamje të strehimit dhe t'u dërgojnë letra-ftesa për aplikim për vizë. Në dobi të tyre është të grumbullohen më shumë informata për vetë organizatën si dhe për vendin ku do të udhëtojnë.

Vijojnë informatat për mundësitë për vullnetarizëm jashtë vendit:

United Nations Volunteers

Postfach 260 111
D-53153 Bonn, Germany
Email: information@unvolunteers.org

Afati i fundit për paraqitje: i hapur

United Nations Volunteers – vullnetarët e kësaj organizate dërgohen në detyra lidhur me misionin e Kombeve të Bashkuara. Pjesa më e madhe e angazhimeve janë të natyrës humanitare dhe kryerjen e operacioneve paqësore ose ndihmë në zhvillim. Vullnetari duhet të jetë i moshës prej 25 vjet ose më i vjetër; të ketë diplomë universitare ose diplomë të lartë teknike; njohja gjuhës angleze, spanjolle ose franceze së punës; si dhe disa vjet përvojë pune adekuate. Ndihma përbëhet nga shpenzimet për jetë të vullnetarit, sigurimi shëndetësor dhe jetësor, pushimi vjetor, rroga e garantuar para fillimit të angazhimit. Pjesa më e madhe e obligimeve të vullnetarit nga Kombet e Bashkuara janë në bazë prej 6-12 muaj me mundësi për vazhdim, dhe me nën-klauzolë se vullnetarët e KB-ve janë të obliguar në minimum një vjet shërbim.

Pjesëmarrja në seminare, punëtori dhe shkëmbime nga vendi dhe jashtë

Ekzistojnë edhe shumë projekte dhe ngjarje afatshkurta në të cilat mund të marrin pjesë persona me invaliditet/pengesa/handikap për shkak të zhvillimit të tyre personal dhe profesional. Numër i madh i fondacioneve, organizata jofitimprurëse nga vendi dhe jashtë anembanë botës, puna e të cilëve është kushtuar çështjes së invaliditetit, shpesh organizojnë aktivitete dhe ngjarje për shkak të shkëmbimit të përvojave, ndërtimit të strategjive të reja dhe fitimit të njohurive për personat me invaliditet/pengesa/handikap. Personat me invaliditet/pengesa/handikap mund të lidhen me organizatat invalidore në qytetin e tyre dhe t'i ndajnë aktivitetet e tyre me qëllim të inkuadrohen dhe t'i rritin rastet e tyre që të bëhen pjesë e ndonjë ngjarje të ngjashme në të ardhmen. Ky lloj i aktiviteteve organizohen në forma të seminareve ose konferencave, me qëllim që të sillet një grup i caktuar në takime dhe bisedime për tema të caktuara. Mundësi tjetër është edhe organizimi i punëtorive dhe shkëmbimi i një grup njerëzish me interesa të ngjashme, me qëllim të shkëmbimit të përvojave dhe strategjive zhvillimore për arritjen e qëllimeve të caktuara. Programi Të rinjtë në aksion në kuadër të Bashkimit Evropian[7] siguron përfshirje të gjerë të mundësive për inkuadrim në opsione të ndryshme për shkëmbim të rinjve deri në moshën 25 vjeç. Personave me invaliditet/pengesa/handikap u rekomandojmë dhe i inkurajojmë të aplikojnë dhe të marrin pjesë në projekte të mbështetura me këtë Program.

Webinar - online edukimi

Webinar është një nga mënyrat se si të merret pjesë në ndonjë konferencë, e të mos dilet nga shtëpia. Personat me invaliditet/pengesa/handikap mund të marrin pjesë me ndihmën e kompjuterit dhe telefonit, mund ta dëgjojnë prezantimin (si lidhje konference), si dhe t'i ndjekin slljadet nga ai që prezanton (përmes internet lidhjes). Nuk do të jenë në mundësi ta shohin prezantuesin ose moderatorin, si dhe pjesëmarrësit tjerë të programit.

Më së shpeshti, për vendosjen e lidhjes nevojitet paraprakisht të bëhet regjistrimi që të mund të rezervohet hapësira dhe të merren instruksione si të inkuadroheni në program në terminin e paraparë për të njëjtin. Në formularin për regjistrim nevojitet të shkruhen të dhënat themelore për pjesëmarrësit dhe në të njëjtin mund të jepet përgjigje në disa pyetje me çka do t'u ndihmonte prezantuesve që të përgatiten për nevojat dhe pritjet e publikut prezent.

Paraprakisht para terminit të planifikuar për prezantimin, pjesëmarrësit duhet të paraqiten në linkun, i cili është caktuar për atë komunikim me anë të vërtetimit të mesazhit që do ta merrni me anë të e-postës. Personat me invaliditet/pengesa/handikap duhet ta shkarkojnë (download) programin e caktuar (software) në kompjuterin e vet dhe duhet ta kontrollojnë nëse sistemi i sigurisë në kompjuterin e tyre (firewall) e lejon këtë. Me këtë program mundësohet që në kompjuter të shihen sllajdat nga prezantuesi, si dhe shënimet ose vizatimet gjatë prezantimit.

Udhëtimi me invaliditet/pengesë/handikap

Personat me invaliditet të cilët kanë për qëllim të studiojnë jashtë vendit, të jenë vullnetarë ose të praktikojnë, duhet të bëjnë shumë përpjekje që ta organizojnë udhëtimin. Varësisht nga lloji i

[7] Të rinjtë në aksion është Program që Bashkimi Evropian e vendosi për të rinjtë. Ka për qëllim ta forcojë ndjenjën e qytetarizimit aktiv, solidaritetit dhe tolerancës mes të rinjve në Evropë, si dhe t'i inkuadrojë në formimin e të ardhmes së Bashkimit. Më shumë detaje mund të gjenden në internet faqen: http://eacea.ec.europa.eu/youth/

invaliditetit/pengesës/handikapit me të cilin ballafaqohen, duhet të kushtohet vëmendje e veçantë kësaj që vijon:

- të organizohet fluturimi, nëse udhëtohet me aeroplan;
- të gjendet strehim adekuat në vendin ku ai/ajo do të studiojë ose do jetë vullnetar;
- të organizohet transporti lokal gjatë angazhimit të tij/saj.

1) Organizimi i transportit ajror

Çdoherë kur është e mundur, personat me invaliditet ta planifikojnë dhe ta rezervojnë transportin ajror shumë më herët dhe ta informojnë agjencinë turistike dhe avio kompaninë për këtë:

- Llojin e invaliditetit/pengesës/handikapin dhe ndihmesat që përdoren, siç është bastuni, patericat, karroca invalidore (manuale ose me elektromotor). Nëse bëhet fjalë për person që shfrytëzon karrocë invalidore, ai/ajo duhet të dorëzojë informatë nëse akumulatori shfrytëzon thartirë të lëngshme ose është me bateri të thata.
- Nevoja nga ushqimi i veçantë ose ndihmë gjatë të ushqyerit (personelit në aeroplan nuk i është lejuar t'i ndihmojnë gjatë ushqimit, por do të kishin mundur të ndihmojnë gjatë hapjes dhe identifikimit të ushqimit që gjendet në shërbim).
- A do ta shoqërojë person tjetër udhëtarin me invaliditet/pengesë/handikap.

Është e mundur që personeli i aeroportit në disa vende të mos jetë i njoftuar me politikën dhe ligjet për udhëtim të personave invalidë, për çka është e rëndësishme që personat me invaliditet/pengesë/handikap ta dinë këtë që vijon:

- Mund të kërkojnë shoqërues i cili do t'u ndihmojë derisa janë në aeroport.
- Rekomandohet në aeroport të vijnë të paktën një orë më herët nga koha që është e paraparë. Me këtë do të fitojnë kohë të mjaftueshme që të bëhet vendosja dhe të shmangen vonesat e mundshme.
- Nevojitet që personat me invaliditet/pengesa ta shohin mundësinë për kohëzgjatjen e fluturimit(eve) varësisht nga nevojat e tija/saja. Fluturimet e gjata mund të mos jenë të rehatshme, veçanërisht për personat të cilët nuk mund t'i shfrytëzojnë tualetet pa qasje në aeroplan. Alternativë më e mirë do të ishte me siguri të zgjedhin fluturim më të shkurta me lidhje të ndërsjella.
- Nevojitet të mundësohet periudhë prej më së paku 90 minutave mes fluturimeve (ose më gjatë nëse është e nevojshme të kalohet dogana ose të pritet në pjesën për migracion) si do të ketë kohë të mjaftueshme që të shkohet nga njëra dalje në tjetrën (gejt) të aeroportit.

2) Strehimi me qasje

Gjetja e strehimit me qasje që i përgjigjet nevojave të personit me invaliditet/pengesë/handikap mund të jetë sfida e parë, bile edhe në vendet e zhvilluara. Për këtë shkak, strehimi duhet të organizohet shumë më herët para ardhjes. Nëse ka mundësi studenti me invaliditet/pengesa/handikap të qëndrojë në konvikt studentor gjatë studimit të tij. Është shumë më lehtë të merret informata e parë për qasjen që e ofron.

Si vullnetar, personi me invaliditet/pengesë/handikap mund të shfrytëzojë shërbime të Agjencisë për vullnetarë, që zakonisht për një shumë të caktuar, mund të sigurojë strehim dhe ushqim. Por, për fat të keq janë shumë të rralla rastet kur Agjencia e merr parasysh qasjen gjatë strehimit. Në rast të tillë do të ishte mirë të kërkohet strehim që personi t'ia lejojë vetes në pikëpamje të pagesës, në afërsi të vendit ku është vullnetar dhe ta organizojë qëndrimin për gjithë periudhën derisa është vullnetar. Kërkimi dhe komunikimi përmes internetit lidhur me gjetjen e strehimit shumë e lehtëson këtë proces.

3) Transport lokal me qasje

Përveç udhëtimit personat me invaliditet/pengesë duhet të përgatiten mirë me informata edhe në pikëpamje të transportit në vendin ku ai/ajo duhet të studiojë ose të jetë vullnetar. Në vendet më të zhvilluara në Evropë dhe SHBA mund të pritet që transporti publik tërësisht ose pjesërisht të jetë me qasje për personat me invaliditet/pengesa/handikap. Nëse ai/ajo dëshiron të jetë vullnetar, praktikojë ose studiojë në ndonjë nga vendet në zhvillim, është shumë e sigurt se atje nuk do të ketë transport të qasur publik. Në atë rast, personat me invaliditet/pengesë/handikap duhet t'i shohin mundësitë e gjetjes së kompanisë private, taksisë ose kombes që do të ishte e qasur për ata. Do të ishte mirë të kontaktohet ndonjë nga organizatat lokale invalidore dhe të merret vesh çfarë lloji të transportit shfrytëzojnë atje personat invalidë dhe çfarë ndihme do të mund të sigurojnë gjatë qëndrimit atje.

Invaliditeti/pengesa dhe sporti[8]

Siç ceket në internet portalin e Disabled world towards tomorrow "... sporti ka rëndësi në jetën e të gjithë njerëzve, ndoshta bile edhe më i rëndësishëm në jetën e personave me invaliditet/pengesa. Për shkak të ndikimit rehabilitues që sporti mund ta ketë jo vetëm për trupin, por edhe për fuqinë e tij për inkuadrimin e serishëm të personave invalidë në shoqëri. Krahas kësaj, sporti na mëson të jemi të pavarur. Sot, njerëz me invaliditet/pengesa/handikap marrin pjesë në shumë sporte – rikrijuese ose si garues".

Siç u përmend disa herë deri tani, të gjithë ne kemi nevoja të ngjashme. Vetëm i plotësojmë në mënyra të ndryshme dhe me ndihmën e ndihmesave të ndryshme asistive dhe teknologjive. Kjo, kuptohet, vlen edhe për sportin. Veçanërisht sot në kohën e zhvillimit teknologjik, në vend që arritjet teknologjike të përdoren në luftëra dhe përleshje, do të kishim dashur ta theksojmë nevojën urgjente nga orientimi i këtij zhvillimi teknologjik në shërbim të personave me invaliditet/pengesë/handikap. Edhe kjo është e drejt! Personat me invaliditet/pengesë/handikap e shfrytëzojnë këtë teknologji që të marrin pjesëmarrje të barabartë në aktivitetet sportive, bile edhe në gara. Vërtetim i vërtetë i kësaj janë arritjet e shumë sportistëve me invaliditet/pengesë/handikap të ndryshëm, duke filluar nga çiklizmi ose njerëz të cilët vrapojnë me protezë në këmbë ose shfrytëzojnë karrocë invalidore vetëm që ta shprehin qëndrimin e tyre lidhur me çështje të caktuar lidhur me të drejtat e barabarta të personave me invaliditet/pengesë/handikap; e deri tek ata sportistë të cilët marrin pjesë në para olimpiadë, gjegjësisht lojërat speciale olimpike. "Në gjithë botën gjithnjë e më shumë rritet numri i njerëzve me invaliditet/pengesë/handikap të cilët merren me sport dhe rikrijim fizik. Ekzistojnë sporte të organizuara në tre kategori themelore të invaliditetit – sporte për të shurdhër, sporte për persona me invaliditet trupor dhe sporte për personat me pengesa intelektuale. Nga fundi i viteve '80, organizatat filluan t'i inkuadrojnë sportistët me invaliditet/pengesë/handikap në ngjarjet sportive, siç janë Lojërat Olimpike dhe Lojërat e Komonueltit. Por, është numër i madh i sporteve që personat me invaliditet i praktikojnë jashtë lëvizjeve zyrtare sportive, p.sh.: basketboll me karroca invalidore, vallëzim në karroca invalidore, peshëngritja, noti dhe shumë aktivitete tjera, ku mund të inkuadrohen nëse kanë invaliditet trupor ose pengesa intelektuale"[9].

Si për shembull, këtu janë zhvendosur ngjarjet kryesore sportive për personat me invaliditet sipas Disabled World [10]:

[8] E përshtatur, por një pjesë është ruajtur në formë dhe tekst origjinal nga http://www.disabled-world.com/sports/ (e shkarkuar më 17 gusht 2012).
[9] ibid.
[10] ibid.

Lojërat para olimpike[11] - Ngjarje ku janë përfshirë më shumë sporte për sportistë me invaliditet trupor, mental dhe sensorik. Këtu janë inkuadruar invaliditeti mobil, amputimet, dëmtimi i të parët, si dhe ata lidhur me paralizën cerebrale.
Deaflympics (Lojëra për të shurdhër)[12] – Lojërat verore dhe dimërore për personat e shurdhër marrin pjesë në ngjarjet me zhvillim më të shpejtë.

Olimpiada speciale[13] - Koncepti i Olimpiadës Spciale paraqitet kur Junis Kenedi Shrajver (Eunice Kennedy Shriver) ka organizuar kamp njëditor për personat me pengesa invalidore në shtëpinë e saj në vitin 1962.

Lojërat e **Komoueltit** (**Disability Commonwealth Games)**[14] – Në vitin 2002 në Mançster, për herë të parë në historinë e Lojërave, para-sportistët ishin inkuadruar në Programin sportiv të përgjithshëm kur 20vende dërguan sportistë të mëdhenj me invaliditet në konkurrencën e meshkujve dhe femrave, të cilët garonin në 10 disiplina në 5 para-sporte të ndryshme: atletikë, bowling në bar, not, ping pong dhe peshëngritje. "Vendet e Komonueltit gjithnjë kanë pohuar se dëshirojnë të kenë rol lideri në sferën sociale", thotë R.D. Stedvard (Dr. Robert D. Steadward), kryetari i parë i Komitetit Olimpik Ndërkombëtar. "A e*kziston mënyrë më e mirë që të bëhet garë sportive e klasës së parë nga ajo që të inkuadrohen sportistë me invaliditet/pengesë/handikap.*"

Për këtë shkak, si pjesë e kampit universitar me rëndësi të madhe është që të punohet në nxitjen dhe mbështetjen e studentëve tuaj/tonë dhe/ose kolegëve me invaliditet/pengesa/handikap, të inkuadrohen në sport dhe si t'u sigurohet qasje e barabartë në objektet dhe aktivitetet sportive. Për ata të cilët do të kishin dashur të dinë më shumë për këtë fushë, i rekomandojmë materialet dhe burimet që vijojnë:

- Sporti dhe personat me invaliditet/pengesa/handikap: Nxitja për inkluzion dhe mirëqenie[15,]
- Sporti për personat me invaliditet në SHBA[16,]
- UN Enable[17]
- Platforma ndërkombëtare për sport dhe zhvillim[18]
- Internet faqja zyrtare e sektorit për sport dhe rikrijim i Australisë Perëndimore[19]
- Federata angleze për sporte invalidore[20]

Si vërtetim i vlerave, qëndrueshmërinë dhe vlerën e sportistëve me invaliditet/pengesa/handikap është arritja e fundit e Para olimpiadës së Maqedonisë znj. Olivera Nakovska Bikova, e cila fitoi medaljen e artë në Lojërat para olimpike 2012 të fundit në Londër dhe solli nder, gëzim dhe mirënjohje të madhe të Maqedonisë se sa pjesëmarrësit e Lojërave Olimpike të rregullta 2012.

Edhe një yll i ndritshëm në qiellin maqedonas është edhe aktivisti i ri Dejan Zafirov dhe organizata joqeveritare që ai e udhëheq - Gaja[21]; ata janë pionierë të vërtetë në përdorimin sportit, artit dhe artizanatit për avancimin dhe luftën për qasje të barabartë të personave me invaliditet/pengesa/handikap në të gjitha sferat e jetës shoqërore.

Ky është edhe një vërtetim se edhe krahas asaj që shkakton vështirësi të madhe, invaliditeti/pengesa/handikapi nuk paraqet pengesë për arritjet e mëdha dhe vlera. PERSONI DHE VENDOSSHMËRI E TIJ/SAJ DHE QËNDRUESHMËRIA JANË AJO QË LË GJURMË!!!

[11] http://www.disabled-world.com/sports/paralympics/.
[12] http://www.disabled-world.com/sports/deaflympics/.
[13] http://www.disabled-world.com/sports/special-olympics/.
[14] http://www.disabled-world.com/sports/commonwealth-games/.
[15] http://www.righttoplay.com/International/news-and-media/Documents/Policy%20Reports%20docs/Harnessing%20the%20Power%20-%20FULL/Chapter5_SportandDisability.pdf.
[16] http://www.dsusa.org/.
[17] http://www.un.org/disabilities/default.asp?id=1563.
[18] http://www.sportanddev.org/en/learnmore/sport_and_disability2/.
[19] http://www.dsr.wa.gov.au/disabilities.
[20] http://www.efds.co.uk/.
[21] http://mkgaia.weebly.com/gaias-team.html

Arti dhe artizanati përballë invaliditetit/pengesës

Siç theksohet në ArtsQueensland[22]

- "Njerëzit me invaliditet/pengesë/handikap më rrallë marrin pjesë në ngjarje kulturore dhe vende se sa popullata e përgjithshme, ndërsa numër i atyre që kanë kufizime në aktivitetet thelbësore është edhe më i vogël.
- Në vitin 2006 vetëm 20.5% të njerëzve me invaliditet/pengesë/handikap dhe kufizimet në aktivitetet thelbësore kanë vizituar galeri arti përkundër 30.0% nga popullata e përgjithshme.
- Gjithashtu është e ulët edhe vizita në muzetë (22.5% vs. 29.2%), teatër (14.4% vs. 24.8%), lojëra (10.8% vs. 17.9%), mjuzikëll (17.9% vs. 25.1%) dhe biblioteka (40.4% vs. 48.0%)."

Ky është tregues i qartë për pengesat me të cilat personat me invaliditet/pengesa/handikap hasen çdo ditë, si dhe nevoja nga mundësimi dhe inicimi i ndryshimit në pikëpamje të qëndrimeve, normave, zakoneve, ligjeve etj.

E drejta të kënaqet në art është e drejta e vetme e garantuar e njeriut. Edhe më e rëndësishme, vetë fakti se ndonjë person ka ndonjë lloj të invaliditeti/pengese/handikap nuk do të thotë edhe se ky person nuk ka nevojë të kënaqet në art. Përkundrazi, p.sh. gjatë realizimit të ndonjë aktiviteti lidhur me artin nevojitet koncentrik dhe kjo u tregua si terapi shumë e dobishme për personat me çrregullime psikike. Nga ana tjetër, është vërtetuar edhe se të dëgjuarit muzikë ose të lush muzikë të çfarëdo lloji në mënyrë të dukshme ndikon në disponimin dhe gjendjen e përgjithshme psikike te njerëzit. Prandaj, nëse e përjashtojmë mundësinë që muzika të shfrytëzohet për qëllime negative, ajo ka veprim rikuperimi ose inkurajimi.

Siç përmendet në Kapitullin 3, ekzistojnë numër i madh i artistëve të llojit të ndryshëm, ndërsa të cilët janë persona me invaliditet/pengesë/handikap të caktuar. Edhe vetë ky fakt vërteton se invaliditeti-pengesa-handikapi nuk mund dhe nuk duhet të llogaritet si pengesë për realizimin dhe/ose kënaqjen në art. Përkundrazi, inkuadrimi dhe angazhimi në art vetëm mund t'u sjell dobi personave me invaliditet/pengesë/handikap.

Prandaj, si pjesë e kampit universitar me rëndësi të madhe është të punohet në nxitjen dhe mbështetjen e studentëve tuaj/tanë dhe/ose kolegëve me invaliditet/pengesë/handikap, të inkuadrohen në krijimin dhe kënaqje e artit dhe shkathtësive si dhe t'u sigurojë qasje të barabartë në muze, teatër, sallat muzikore, punëtoritë etj.

Për ata të cilët dëshirojnë të dinë më shumë për këtë fushë, ua rekomandojmë këto materiale dhe burime:

- Kinder Art;[23],
- Buzzle;[24,]
- SASIX;[25]
- Art and Craft – City of Mitcham;[26]
- Gauteng North Services to People with Disabilities – SPD;[27]
- Business.UN.org;[28]

[22] http://www.arts.qld.gov.au/publications/people-disability.html
[23] http://www.kinderart.com/special/.
[24] http://www.buzzle.com/articles/craft-ideas-for-adults-with-disabilities.html
[25] http://www.sasix.co.za/projects/view/VP-GP-AUG09-0001/
[26] http://www.mitchamcouncil.sa.gov.au/webdata/resources/files/No1_2004___Art_and_Crafts_2.pdf
[27] http://www.disabilitygauteng.org/Artista.htm
[28] http://business.un.org/en/documents/299

- Trade and Investment: Arts of New South Wales;[29]
- Living made easy;[30]

[29] http://www.arts.nsw.gov.au/index.php/news-and-publications/news/new-arts-funding-for-people-with-a-disability-in-nsw/
[30] http://www.livingmadeeasy.org.uk/leisure/arts-and-crafts-3705/.

Kapitulli 8

Përfundime dhe drejtime për aktivitete të mundshme të ardhshme

Autore: Ana M. Llazarevska[1]

Duke e shfletuar këtë Doracak, disa lexues ndoshta do të komentonin se pjesa më e madhe nga informatat e prezantuara këtu janë tashmë të njohura. Megjithatë, siç u përmend nga parathënia e kryeredaktorit, si dhe në Kapitullin 1 nga ky publikim, në bazë të informatës kthyese që e morëm në fazën e planifikimit të projektit, si dhe gjatë punëtorive 1 deri 4, në kuadër të projektit, u përfundua se numër i dukshëm i studentëve dhe arsimtarëve, në të vërtetë asnjëherë nuk kanë pasur rast me të vërtetë të njoftohen me ndonjë person me invaliditet/handikap/pengesë. Ata në të vërtetë nuk kanë as njohuri themelore për lloje të caktuara të handikapit/invaliditetit/pengesës dhe për karakteristikat e tyre kryesore, bile edhe më pak për nevojat dhe kërkesat e ndonjë personi me handikap/pengesë.

Prandaj, ne jemi të mendimit se tani ishte koha dhe vendi i vërtetë për botimin e një Doracaku të këtillë. Në kuadër të këtij Doracaku ne u përpoqëm:

- ta afrojmë "problemin" (çështjen) e pengesës/invaliditetit/handikapit ndaj të ashtuquajturës "main-stream" popullatë që kushtimisht nuk ka handikap,
- t'i prezantojmë karakteristikat themelore të tipave më të shpeshtë të handikapit/pengesës/invaliditetit,
- në pajtim me atë që u përmend paraprakisht, t'u ndihmojmë, para së gjithash, arsimtarëve, të punësuarve në administratë dhe studentëve, por gjithashtu edhe popullatës së gjerë, në kompleksin dhe detyrës që duket e "vështirë" për ta kuptuar më mirë, komunikimi me, inkuadrimin dhe pranimin e bashkëqytetarëve tanë – personat me handikap/pengesë/invaliditet.

Qëllimi i këtij Doracaku ishte/është të sigurojë vështrim më të mirë në mënyrat, mjetet e sjelljes së drejt ndaj personave me handikap/pengesa/invaliditet. **Dedikimi** i tij është t'i motivojë arsimtarët jo vetëm ta zgjerojnë dhe thellojnë imagjinatën e tyre në kërkim të mënyrave dhe metodave të reja mësimore, për edhe të nxisë dhe ndihmojë shfrytëzimin e aktiviteteve të ndryshme jashtë shkollore, përmes të cilave do të mundësojë inkuadrimin e personave me handikap/pengesa/invaliditet, kryesisht në kampin universitar, por edhe afatgjatë, do të facilitojë inkluzion horizontal (përfshirje) të personave me handikap/pengesa/invaliditet në të gjitha sferat e përditshmërisë dhe jetës shoqërore.

Më në fund, **qëllimi i tij lobal** ishte/është t'u ndihmojë arsimtarëve në realizimin e obligimit të tyre punues, e kjo është ndarja dhe ndihma në fitimin e njohurive të reja – si dhe t'i motivojë arsimtarët, administratën dhe studentët në zhvillimin dhe kultivimin e raporteve të tyre njerëzore dhe të drejta – korrektësinë, gatishmërinë për ndihmë, asistencë, empati dhe më në fund, por jo edhe më pak e rëndësishme, HUMANIZMI!

Ky Doracak paraqet një punë të përgjithshme që përfshin aspekte të ndryshme të llojllojshme me rëndësi të madhe për të gjitha palët e kyçura. Të gjithë ko-autorët, anëtarë të ekipit, që janë përgjegjës për përgatitjen e këtij doracaku, dhanë gjithçka nga vetja, në kuadër të njohurive të tyre dhe qasjes deri te resurset, në gjetjen dhe aplikimin e infromatave më të reja, të vërteta, ekzistuese dhe valide. Megjithatë, për shkak të kushteve të cilat vazhdimisht ndryshojnë në shoqërinë tonë lidhur me

[1] Dr. Ana Llazervska, docente pranë Fakultetit të Makinerisë – Shkup, Universiteti "Shën Qirili dhe Metodi", Shkup, Maqedoni. E-mail: ana.lazarevska@gmail.com и ana.lazarevska@mf.edu.mk

rregulloren juridike mësimore, rrethimi shoqëror, ekonomia, vetëdija publike, lejuam që disa nga informatat të cilat janë zhvendosur në këtë Doracak, ndoshta janë tejkaluar dukshëm, ose nuk janë transferuar në tërësi.

Në Kapitujt e mëparshëm, u përpoqëm ta sqarojmë termin handikap/pengesë/invaliditet, ta përcjellim klasifikimin që është në përdorimin praktik, ta prezantojmë si të komunikohet me personin me handikap/pengesë/invaliditet gjatë kontaktit tonë të parë me atë. Kontributi i ko-autorëve tanë me handikap/pengesë/invaliditet kurrsesi nuk guxon të anashkalohet. Pikëpamja e tyre ndaj sendeve, përvoja e tyre personale dhe sfidat me të cilat ata çdo ditë ballafaqohen, dëshira e tyre e pafund për respekt dhe vlerësimi jo për shkak të asaj se si duken, por përkundër, sipas asaj sa ata kontribuojnë ndaj shoqërisë. Më në fund, gatishmëria e tyre absolute për jetë të pavarur, për ruajtjen e pjesëve më private nga jeta e tyre sa është e mundur dhe të jenë qytetarë të vendit të tyre në kuptimin e vërtetë të fjalës. A nuk përpiqemi të gjithë drejt kësaj?

Ky Doracak është menduar si mjet interaktiv i komunikimit të hapur të gjithë palëve të kyçura. Të gjitha sugjerimet/rekomandimet lidhur me pengesën/handikapin/invaliditetin, arsim i qasur/pavarësi dhe privaten e personave me handikap/pengesa/invaliditet janë të mirëseardhura. Mendojmë se vetëm qasja e tillë, për ne është më e drejta në kontributin ndaj:

- "zbulimit"/marrjes parasysh/vështrimin jashtë kornizës së qëndrimeve dhe tabuve tona;
- shmangia e përgjigjeve të gabuara dhe të "vërteta" lidhur me personat me handikap/pengesë/invaliditet;
- forcimi i vetëdijes për atë se të gjithë ne do të duhej t'i bashkojmë forcat tona në luftën për nevojat e përbashkëta dhe për jetë më thelbësore dhe më cilësore, duke e zgjeruar fushën tonë të aktivitetit drejt garancisë, sigurimit, ruajtjes, promovimit dhe luftës për të drejta të barabarta globale të personave me handikap/pengesa/invaliditet.

Prandaj besojmë se pjesë e madhe e popullatës do të ketë dobi nga ky Doracak, për shembull, personat me handikap/pengesa/invaliditet dhe familjet e tyre/asistentët personal, kujdestarët, institucionet edukativo-arsimore, bashkësia dhe shoqëria në tërësi.

Ky publikim do të duhej të përdoret si mjet për ndërtimin e sinergjisë shumëdimensionale mes arsimtarëve, studentëve, institucioneve dhe opinionit më të gjerë, duke i orientuar drejt realizimit të përbashkët të nevojave të ndërsjella dhe drejt forcimit të vetëdijes për jetë më thelbësore dhe më cilësore. Në këtë mënyrë, qëllimi i tij derdhet në përpjekjet për garancinë, sigurimin, ruajtjen,l promovimin dhe luftën për të drejtat globale të personave me handikap/pengesa/invaliditet në të gjitha sferat dhe nivelet e jetës shoqërore.

Duke e pasur parasysh këtë, do të kishim dashur, krijuesit kompetent të politikave në shoqëritë tona, por jo edhe kufizuese në të gjitha sferat e arsimit, puna sociale dhe mundi, t'i ftojmë të sigurojnë tokë të shëndoshë për inkorporimin e përvojave tona të fituara dhe në këtë mënyrë ta ndihmojnë dhe promovojnë participimin e qasjeve tona në arsimin sipëror në Maqedoni dhe Kroaci. Edhe më shumë, përvojat tona dhe njohuritë e fituara – pa marrë parasysh nëse ata kanë pasur rezultatet pozitive ose negative – do të mund të jenë me rëndësi të madhe për disa përpjekje të ardhshme për zgjidhjen e nevojave dhe problemeve të personave me handikap/pengesë/invaliditet, të cilat janë në suaza të projektit tonë.

Për shembull, institucionet relevante në Maqedoni dhe Kroaci, si për shembull Ministritë e Arsimit dhe Shkencës, ose për Punë dhe Politikë Sociale do të mund ta kenë parasysh këtë:

- inkuadrimin e këtij Doracaku në publikimet të cilat duhet t'i posedojë çdo institucion arsimor, dhe në atë mënyrë të ndihmojë në komunikimin e drejtpërdrejtë dhe të papenguar dhe për raport më të mirë mes të gjitha palëve kyçura, por gjithashtu edhe në këshillimin dhe

inkuadrimin e metodologjisë të mësuarit shërbyes në programet mësimore të universiteteve shtetërore dhe/ose private në Maqedoni dhe Kroaci, si dhe

– integrimi i qasjes nga më shumë aspekte dhe nivele që është prezantuar dhe aplikuar në këtë Doracak, në të gjitha nivelet e arsimit në Maqedoni dhe Kroaci, bile edhe më gjerë në disa vende të Evropës Lindore dhe Juglindore, të cilat pretendojnë të jenë kandidatë për anëtarësim në Bashkimin Evropian.

Literatura e shfrytëzuar

Ajdinski, Lj., 1996: "*Didactics of early treatment and pres-school education of children with mental disabilities*", Faculty of Philosophy-Department of Special Education and Rehabilitation, Skopje.

Association of Students and Youth with Disabilities (ASYD), 2011: '*Report for the Center for Institutional Development (CIRa) 2010 – 2011*'.

Bilic, I. (2010), '*Access to Higher Education for Disabled in Croatia*', Book of Abstracts of the Regional JFDP Alumni Conference: '*Enhancing Accessibility of the Higher Education to the disabled*', November 22-24, 2010, Skopje/Ohrid, Macedonia. p. 25.

Corporation for National and Community Service, *Learn and Serve America: Using Service as a Vehicle for Learning—A Most Valuable and Powerful Lesson*, Available from: http://www.nationalservice.gov/about/programs/learnandserve.asp.

Croatian **"Official Gazette"** No. 41/2001 & 55/2001.

Henderson, C. 1995: '*College Freshman with Disabilities A Triennial Statistical Profile*', American Council on Education, HEATH Resource Center: http://www.perceptions4people.org/component/content/article/56-general/134-heath-resource-center.html.

Kis-Glavas, L., urednik. 2012:, Zbirka priručnika *"Studenti s invaliditetom*", Sveučilište u Zagrebu, Zagreb (Kis-Glavas, L., (Ed.), 2012: "A Collection of Guidelines "*Students with disabilities*"", University of Zagreba, Zagreb)

Lazarevska, A., Atanasovski, A. 2010: *Draft Action Plan resulting from the regional JFDP Alumni Conference "Enhancing Accessibility of the Higher Education to the Disabled"*, November 22-24, 2010 in Skopje/ Ohrid, Republic of Macedonia, Skopje, Macedonia: Friedrich Ebert Stiftung. Available at:

National Programme for the Development of Education in R.M. (2015-2015) www.mon.gov.mk, p. 352.

Official Gazette of Republic of Macedonia: "*Assessment of the Specific Needs of Persons with Physical or Intellectual Disability*", no. 30/2000, pp. 1777-1779.

Petrov, R., 1998: Lecture materials, subject "*Professional orientation and training of persons with mental disabilities*", Skopje.

Risteska, J., 2010: '*Inclusive Higher Education*', Book of Abstracts of the Regional JFDP Alumni Conference: '*Enhancing Accessibility of the Higher Education to the disabled*', Novembar 22-24, 2010, Skopje/Ohrid, Macedonia. p. 20.

Ristovska, M., 2012: „*Guidelines for effective introduction and implementation of service-learning in higher education*", A. M. Lazarevska, M. Stankosky, A. Koçi. (Eds.): Macedonian American Alumni Association (MAAA), p. 11-13.

Trajkovski V., 2011: "*Autitzam i pervazivni razvojni narushuvanja*", Filozofski fakultet, Institut za defektologija, Skopje. (Trajkovski V. 2011: "*Autism and Pervasive Developmental Disorders*". Faculty of Philosophy, Institute of Special education and Rehabilitation, Skopje)

Trajkovski V., 2004: "*Autitzam*", Filozofski fakultet, Institut za defektologija, Skopje. (Trajkovski V., 2004: "*Autism*", Faculty of Philosophy, Institute of Special education and Rehabilitation, Skopje)

Petrov, R., Gjurçinovska, L., Stojanovska – Trajkovska, N., 2008: *"Mbrojtja dhe rehabilitimi i personave me invaliditet"*, Shkup, Fakulteti Filozofik – Instutit për defektologji.
(**Petrov, R., Gjurchinovska L., Stanojkovska – Trajkovska N.**, 2008: "*Protection and rehabilitation of the persons with disabilities*", Skopje, Faculty of Philosophy, Institute for Special Education and Rehabilitation).

Lidhja e defektologëve të Republikës së Maqedonisë, 2012: *"Si deri te komuna inkluzive?"* – Doracak për të punësuarit në njësitë e vetëqeverisjes lokale, Shkup.
(**Association of Special Education Teachers of R. Macedonia**, 2012: "*How to achieve an Inclusive Municipality*?" – Guidelines for the employees within the local government, Skopje)

Online resurse

http://www.maaa.com.mk/sites/default/files/Action%20Plan_eng.pdf.
http://www.disabled-world.com/artman/publish/article_2130.shtml
http://www.disabled-world.com/artman/publish/famous-deaf.shtml
http://business.un.org/en/documents/299
http://portale.unipa.it/lettere/
http://web.jhu.edu/disabilities/faculty/types_of_disabilities/adhd.html.
http://web.jhu.edu/disabilities/faculty/types_of_disabilities/deafness.html
http://www.apt.gc.ca/wat/wb12200E.asp?Lt=D.
http://www.arts.nsw.gov.au/index.php/news-and-publications/news/new-arts-funding-for-people-with-a-disability-in-nsw/
http://www.arts.qld.gov.au/publications/people-disability.html
http://www.bg.ac.rs/csrp/clanice/centri/csh.php
http://www.buzzle.com/articles/craft-ideas-for-adults-with-disabilities.html
http://www.cdc.gov/ncbddd/disabilityandhealth/types.html
http://www.cira.org.mk.
http://www.disability.org.
http://www.disabilitygauteng.org/Artista.htm
http://www.disabled-world.com/artman/publish/article_0060.shtml
http://www.disabled-world.com/artman/publish/famous-blind.shtml.
http://www.disabled-world.com/artman/publish/famous-ocd.shtml
http://www.disabled-world.com/disability/types/.
http://www.disabled-world.com/sports/
http://www.disleksija.rs
http://www.dsr.wa.gov.au/disabilities.
http://www.dsusa.org/.
http://www.efds.co.uk/.
http://www.equalaccess4pwds.org/
http://www.equalaccess4pwds.org/sites/default/files/resources/AEIFproposal_MK_CR_finalists_narrative_new.pdf.
http://www.eyecaretyler.com/2020.htm
http://www.iro.hr/hr/javne-politike-visokog-obrazovanja/kolumna/studirati-s-invaliditetom/
http://www.kinderart.com/special/.
http://www.livingmadeeasy.org.uk/leisure/arts-and-crafts-3705/
http://www.maaa.com.mk/jfdp-conference-2010.
http://www.macedonia.usembassy.gov.
http://www.mitchamcouncil.sa.gov.au/webdata/resources/files/No1_2004___Art_and_Crafts_2.pdf
http://www.miusa.org.
http://www.parenting.com/gallery/famous-people-with-add-or-adhd
http://www.poraka.org.mk.
http://www.righttoplay.com/International/news-and-media/Documents/Policy%20Reports%20docs/Harnessing%20the%20Power%20-%20FULL/Chapter5_SportandDisability.pdf.
http://www.rollingrains.com/readings/2010/03/the-number-of-people-with-disabilities-worldwide.html.
http://www.sasix.co.za/projects/view/VP-GP-AUG09-0001/
http://www.seeu.edu.mk
http://www.sportanddev.org/en/learnmore/sport_and_disability2/.
http://www.ukim.edu.mk.
http://www.un.org/disabilities/convention/conventionfull.shtml
http://www.un.org/disabilities/default.asp?id=1563.
http://www.un.org/disabilities/default.asp?id=18.
http://www.youtube.com/watch?v=1iTBu34HtBg&feature=share
http://www.youtube.com/watch?v=fEtwsTfBzLc.
http://www.zsmh.org.mk and www.seen-ysd.org.
https://alumni.state.gov/aeif/funded.
https://www.un.org/disabilities/default.asp?id=150.

ALUMNI ENGAGEMENT INNOVATION FUND

STATE ALUMNI

YOUR GLOBAL COMMUNITY